Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 6 (134). QERSHOR 2017. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Lobimi për Rrugën e Arbërit tani kërkon drejtim të ri

Nga Dr. **Gëzim Alpion**



4

Tre ditë në bjeshkë: nga Ilnica në Radomirë

Nga **Grehans Uka**



12

Shefqet Domi, "Ginesi" i mjekësisë shqiptare

Nga Prof. As. **Nazmi Koçi**




14

REPORTAZH: NJË DITË NË BURIMET E SOPANIKËS

Banorët ishin të shqetësuar për ndërtimin e Hec-it Seta 4, dhe që ishin të gatshëm ta mbronin me jetë. "As turku, as serbi, as italian e gjermani s'na e morën dot këtë vend, jo më të vijnë të na e marrë një tepelenas", thotë Qazim Daci, një burrë pak i thinjur, i cili flet avash, pastër dhe me një tërheqje duke të marrë nën rrëfim. Ndërsa Haxhi Cerri thotë: "Shif, a patë ju rrugës? S'ka asnjë tabelë me tregu çfarë bëhet". Dhe me të vërtetë ne nuk pamë asnjë tabelë që të tregojë projektuesin, kontraktorin, buxhetin, kohën dhe më kryesorja çfarë po bëhet. "7 mullinj dhe një varavejc gjenden në këtë rrjedhë uji", shton më tej Haxhi Cerri, tek tregon brengat që ka për vendin ku lindi dhe u plak.

Nga **ALBAN TUFA**. *Fotot:* **FRANK HOXHA**

FAQE 6-7



Hidroenergjia në Shqipëri

Nga Enver Hoxha tek EBRD-ja

Nga **PETR HLOBIL**

Enver Hoxha, ish-diktatori komunist në Shqipëri, sundonte në një mënyre aq të çuditshme saqë ai e gjeti veten të izoluar nga sunduesit e tjerë komunistë. Midis gjërave të tjera, ai e përmbyti shtetin me 3 milionë njerëz me 750 000 bunkerë betoni, të ndërtuar duke injoruar njerëzit, natyrën por edhe rregullat ushtarake- duke parë se si disa prej tyre ishin ndërtuar përballë njëri-tjetrit.

FAQE 5

EKSKLUZIVE

Seta, lumi që rrezikon të zhduket



ZGJEDHJET 2017:

6 deputetë për 4 parti

Zgjedhjet e përgjithshme parlamentare mbaruan të dielën e fundit të qershorit dhe qarku i Dibrës zgjodhi të dërgonte në parlament 6 deputetë nga 4 parti të ndryshme.

Ilir Beqaj dhe Almira Xhembulla do të përfaqësojnë Partinë Socialiste, Dhurata Cupi (Tyli) dhe Xhemal Gjunkshi për Partinë Demokratike, Përparim Spahiu do të vazhdojë mandatin e dytë radhazi si përfaqësues i LSI, ndërsa Reme Lala do të jetë më e reja e Kuvendit të Shqipërisë si përfaqësuese e PDIU.

Në gjithë qarkun e Dibrës, sipas rezultateve paraprake të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve votuan 73702 votues, ose 56.13% e 131 313 zgjedhësve të regjistruar në votime. Partia Socialistë moti 24795 vota (34,46%), Partia Demokratike 21331 vota (29.65%), Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet 12.705 vota (17,52%) dhe Lëvizja Socialiste për Integrim 12267 vota (17,05%). Katërmbëdhjetë partitë e tjera në garë morën së bashku 948 vota, nga të cilat më shumë mori Libra me 233 vota dhe më pak MEGA e 6 vota.

PDIU doli partia e parë në bashkinë e Dibrës, me 9985 vota të fituara, ndërsa PS arriti 9370 dhe PD 8220. Në bashkinë e Dibrës votuan 32357 votues nga 56904 të regjistruar në listat zgjedhore. Nga 15 njësi administrative të qarkut të Dibrës, 11 prej tyre i fitoi PDIU, përfshirë edhe qytetin e Peshkopisë, PD fitoi vetëm Kalanë e Dodës, ndërsa PS tre njësi administrative, Melanin, Maqellarën dhe Lurën.

FAQE 2-3

NË BRENDËSI: ■ **Rruga e Arbrit**, e vetmja çështje elektorale ■ **Shiu** që të kthen në kohë, në vitet e rinisë ■ **Gruri**, kultura që po mbillet çdo vit e më pak ■ **Eduard Ilnica**: Të rinjve u duhet guximi, iniciativa dhe një profesion ■ **Urime Straka**:Besimi te vetja më ka sjellë suksesin ■ **Duli Dema** nga Amerika dhe gjipset e virgjëra të Dibrës ■ **110 vjet** nga themelimi i klubit "Bashkimi Dibran" ■ **Kahreman Ylli**, nga Franca në Peshkopi, si zëvendësdrejtori i shkollës që nuk u hap kurrë ■ **Berishët e Muhurrit,** si rast unikal në historinë Skënderbegiane ■ **Dibër,** tokë e trandur ■ Çeta e shpresës ■ **Pesha** e Marsit të vrarë ■ **Dasma** ■ **Sulejman Borova**, artisti që i dhuroi vlera këngës dibrane ■ **E mira Mirandë**, ti u dorëzove...■ **Do të** eliminoheshin në kampe shfarosëse...

Rruga e Arbërit - aty ku fjalët nuk i merr era!

Bej "**Like**" dhe "**Share**". Pajtohu dhe qëndro me gazetën #rrugaearberit më pranë #Dibrës!

Rruga e Arbërit rrugaearberit

Për më shumë informacion:
Tel: 00455 68 65 08 441. +355 **68 65 08 441** +355 **69 20 68 603**
Email: rrugaearberit@gmail.com | www.rrugaearberit.com

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Rruga e Arbërit nr. 134

Redaksia i njofton bashkëpunëtorët e saj, se të njëjtat shkrime të botuar në mediumet e tjera nuk do të mund të botohen në faqet e gazetës, përveç rasteve kur çështja mbetet aktuale dhe e nevojshme për riinformim.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 6 (134). Qershor 2017

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Alban TUFA
Hysen LIKDISHA
Samet ZAGRADI
Defrim METHASANI

Kontribuan për këtë numër:
Petr HLOBIL
Gëzim ALPION
Petrit MYFTIU
Musa HOXHA
Nazmi KOÇI
Lutfi HANKU
Xhevat JELLA
Zabit LLESHI
Mehmet KOXHA
Dionis XHAFA
Halil RAMA
Sajmir SHATKU
Grehans UKA
Frank HOXHA
Dedë DOÇI

Fotoreporter: Fehmi LLESHI

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640
Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

ZGJEDHJET 2017:
6 deputetë për 4 parti

Në gjithë qarkun e Dibrës, sipas rezultateve paraprake të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve votuan 73702 votues, ose 56.13% e 131 313 zgjedhësve të regjistruar në votime. Partia Socialistë moti 24795 vota (34,46%), Partia Demokratike 21331 vota (29.65%), Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet 12.705 vota (17,52%) dhe Lëvizja Socialiste për Integrim 12267 vota (17,05%). Katërmbëdhjetë partitë e tjera në garë morën së bashku 948 vota, nga të cilat më shumë mori Libra me 233 vota dhe më pak MEGA e 6 vota.



Ilir Beqja



Almira Zebi Xhembulla

Zgjedhjet e përgjithshme parlamentare mbaruan të dielën e fundit të qershorit dhe qarku i Dibrës zgjodhi të dërgonte në parlament 6 deputetë nga 4 parti të ndryshme.

Partia Socialiste dhe Partia Demokratike do të kenë nga dy përfaqësues të saj në parlament në këtë qark, ndërsa LSI dhe PDIU nga një.

Në gjithë qarkun e Dibrës, sipas rezultateve paraprake të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve votuan 73702 votues, ose 56.13% e 131 313 zgjedhësve të regjistruar në votime. Partia Socialistë moti 24795 vota (34,46%), Partia Demokratike 21331 vota (29.65%), Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet 12.705 vota (17,52%) dhe Lëvizja Socialiste për Integrim 12267 vota (17,05%). Katërmbëdhjetë partitë e tjera në garë morën së bashku 948 vota, nga të cilat më shumë mori Libra me 233 vota dhe më pak MEGA e 6 vota.

Në këtë zgjedhje Partia Demokratike, jo vetëm që humbi një mandat deputeti, por doli edhe e dyta në qark, me 3464 vota më pak së Partia Socialiste. Një rritje të shpejtë dhe surprizuese kishte PDIU, e cila u rendit e treta në qarkun e Dibrës, duke kaluar në vend të katërt LSI.

PDIU doli partia e parë në bashkinë e Dibrës, me 9985 vota të fituara, ndërsa PS arriti 9370 dhe PD 8220. Në bashkinë e Dibrës votuan 32357 votues nga 56904 të regjistruar në listat zgjedhore. Nga 15 njësi administrative të qarkut të Dibrës, 11 prej tyre i fitoi PDIU, përfshirë edhe qytetin e Peshkopisë, PD fitoi vetëm Kalanë e Dodës, ndërsa PS tre njësi administrative, Melanin, Maqellarën dhe Lurën.

Në bashkinë e Matit PS u rendit e para me 6960 vota, PD 4912 vota, LSI 2459 vota dhe PDIU 516. Morën pjesë në zgjedhje 15445 zgjedhës nga 29421 të regjistruarve në listat zgjedhore. Nga tetë njësi administrative, tre i fitoi PD, ndërsa pesë të tjera PS, përfshirë edhe qytetin e Burrelit.

Edhe në bashkinë e Klosit PS u rendit e para me 3312 vota, PD 2770 vota, LSI 1791 vota dhe PDIU 497 vota. Morën pjesë në zgjedhje 8765 zgjedhës nga 15604 të regjistruarve në listat zgjedhore. Nga katër njësi administrative, vetëm në Kraste PS fitoi me 4 vota diferencë, ndërsa në njësitë e tjera diferenca mes PS dhe PD ishte shumë më e madhe.

Në bashkinë e Bulqizës PD u rendit e para me 5429 vota, PS 5153 vota, LSI 4225 vota dhe PDIU 1607 vota. Morën pjesë në zgjedhje 17135 zgjedhës nga 29384 të regjistruarve në listat zgjedhore. Nga tetë njësi administrative, PD fitoi në katër prej tyre: Shupenzë, Fushë Bulqizë, Zerqan dhe Ostren dhe katër të tjerat: Bulqizë, Krastë, Gjoricë dhe Trebisht i fitoi PS.

Përqindja më e lartë e zgjedhësve u regjistrua në bashkinë Bulqizë me 58.31%. Në bashkinë Dibër morën pjesë 56.86%, në bashkinë Klos 56.17% dhe në bashkinë Mat 52.50%.

Nga rezultatet paraprake të KQZ, të publikuara në faqen e saj zyrtare në web, 71 946 vota janë konsideruar të vlefshme, ndërsa 1745 vota kanë rezultuar të pavlefshme.

Zgjedhjet në Qarkun e Dibrës ishin vlerësuar më parë me shkallën më të lartë të problematikës që pritej gjatë ditës së votimit dhe procesit të numërimit, por gjithçka duket se shkoi normalisht dhe 259 kutitë e votimit, aq sa ka pasur qendra votimi, u numëruan brenda ditës së hënë në katër qendrat e numërimit e ngritura në secilën bashki. Vetëm deputeti i rizgjedhur i LSI bëri një denoncim publik në faqen e tij të FB, sipas të cilit, në një qendër votimi me nr.1079 janë futur mbi 40 fletë votimi në kuti, pasi komisionieri i LSI ishte i shitur”. Por deri më tani nuk dihet nëse këtë rast ai e ka referuar në prokurori.

KUSH JANË DEPUTETËT E RINJ TË DIBRËS

Deputetja më e re e Dibrës, por edhe e parlamentit shqiptar është **REME LALA**, e cila solli një fitore surprizë edhe për vetë subjektin që ajo përfaqësonte, Partinë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet. “Logo e kësaj partia së bashku me parullën “Veç një Atdhe” shëtiti në të gjithë qarkun e Dibrës, sidomos në çdo fshat të bashkisë Dibër. Ndërsa slogani i saj elektoral ishte “Për Dibrën, me Krenari dhe Dinjitet”.

(Vijon në faqen 3)



Dhurata Cupi (Tyli)



Xhemal Gjunkshi

Rruga e Arbrit, e vetmja çështje elektorale

Edhe këtë fushatë elektorale, Rruga e Arbërit ishte një ndër çështjet më të debatuara elektorale.

Kryeministri Rama, gjatë gjithë vizitave në këtë fushatë në Dibër, ka theksuar se shumë shpejt "Ministria e Financave do të japë dakortësine për skemën financiare të Rrugës së Arbrit. Kompania që e ka bërë projektin është paraqitur me një propozim, është bërë verifikimi i projektit dhe me të marrë miratimin, hapet gara. Që të mos flas në mënyrë strikte, theksonte ai, pasi procedurat gjithmonë kanë ndonjë vonesë, nga shtatori fillojmë Rrugën e Arbrit dhe i japim fund kësaj historie", u shpreh Kryeministri Rama gjatë një takimi në fund të majit.

"Qeveria e fasadës bën tendera elektoral", shkruante në profilin e saj deputetja e PD, Dhurata Çupi Tyli, duke iu përgjigjur kështu premtimeve të Kryeministrit. "Qeveria e fasadës përmes tenderave elektoral do të mashtrojë sërish dibranët. Katër vjet e la në harresë qëllimisht , sot na kujtohet pikërisht në kulmin e fushatës... Rruga e Arbrit është projekt që do lidhë Tiranën me Dibrën, e këtë do ta bëjë njeriu i veprave Lulzim Basha kryeministër", theksonte deputetja e PD në një nga postimet e saj të shumta në FB në lidhje me këtë çështje.

> **EDI RAMA:** "Rruga e Arbrit, që është një zotim solemn i yni, do të nisë nga puna me të përfunduar kontrata. Procedura është drejtë përfundimit dhe brenda shtatorit ne do të fillojmë punën dhe do t'i japim fund kësaj historie të pafund, që për çerekshekulli ju e keni dëgjuar dhe stërdëgjuar. Por unë ju them se brenda katër viteve të ardhshme, Dibra do të jetë e lidhur me Tiranën".

Deputeti i LSI, Përparim Spahiu nuk ka folur shumë përmes rrjeteve sociale për Rrugën e Arbrit, por me qëndrimet e tij në parlament ka qenë kritik në lidhje me mos mbajtjen e këtij premtimi. Ai kishte vënë në dyshim rikandidimin e tij, pasi është e patolerueshme që dibranëve tu premtohet sërish Rruga e Arbrit. Në fjalën e tij në parlament kur diskutohej buxheti i vitit 2017, Spahiu u tregua shumë në lidhje me mosmbajtjen e premtimit për ndërtimin e Rrugës së Arbrit. Ai e cilësoi hipokrizi përmendjen e saj si premtim, kur ngeleshin vetëm 6 muaj nga mbajtja e zgjedhjeve të vitit 2017.

Deputetja e Dibrës dhe PDIU, Reme Lala, u përfshi në këtë debat kur ajo foli pas fitores së saj në Dibër.

"Unë nuk kam asnjë parti. Partia ime jeni ju, Dibra dhe dibranët e mi, tha ajo gjatë një fjalë përshëndetje për mbështetësit e saj. "Për Dibrën dhe dibranët e mi do t'i bashkëngjitem vullnetit të shqiptarëve për t'i dhënë timonin Edi Ramës dhe ju jap fjalën se bashkë me Edi Ramën do ta bëjmë Rrugën e Arbrit brenda këtij viti. Nëse kjo nuk do të arrihet, unë do ta gris mandatin".

Fjalimi i saj u interpretua nga analistët në televizionet dhe median qendrore si një largim i saj nga PDIU, por një ditë më pas ajo dha një deklaratë publike ku theksoi se "jam deputete e PDIU-së dhe nuk kam kaluar me askënd". në lidhje me Rrugën e Arbrit, ajo theksoi se "Rruga e Arbrit me Edi Ramën bëhet, se Edi Rama e ka timonin! Unë si dibrane, jam e gatshme të bashkëpunoj me këdo që realizon premtimin e Rrugës së Arbrit".

Disa ditë para se fushata të mbarojë, kryeministri Edi Rama foli sërish për këtë çështje.

"Rruga e Arbrit, që është një zotim solemn i yni, do të nisë nga puna me të përfunduar kontrata. Procedura është drejtë përfundimit dhe brenda shtatorit ne do të fillojmë punën dhe do t'i japim fund kësaj historie të pafund, që për çerekshekulli ju e keni dëgjuar dhe stërdëgjuar. Por unë ju them se brenda katër viteve të ardhshme, Dibra do të jetë e lidhur me Tiranën", theksoi ai.

Gjatë mitingut falënderues pas zgjedhjeve në sheshin "Skënderbej", të njëjtin premtim ai e bëri sërish, duke theksuar se "para dimrit do të nisin punimet".

Rruga e Arbrit është futur në procedurat ligjore si një ndër projektet e para të investimeve bazuar në projektin "1 miliardë dollarë", iniciuar nga qeveria në fillim të këtij viti. Për ndërtimin e saj ka një ofertë nga kompania Gjoka Konstruksion, por pavarësisht kësaj një tender publik pritet të hapet nga qeveria. Financimi i saj pritet të jetë në formën e Partneritetit Publik-Privat dhe në qoftë se ndonjë kompani tjetër nuk futet në garë ose ofertat nuk janë të favorshme për qeverinë, punimet pritet të nisin në fund të këtij viti.

Gjithmonë, "nëse nuk na tradhtojnë procedurat", siç thotë edhe kryeministri.

Kujtojmë se procedurat kanë dështuar më parë kur qeveria kishte një propozim nga një kompani kineze.

ZGJEDHJET 2017: 6 deputetë për 4 parti

(Vijon nga faqja 2)

Sipas CV të depozituar pranë KQZ, Reme Lala është lindur në Muhurr të Peshkopisë më 29 shtator 1995. Ditëlindjen e saj të 22-të ajo do ta festojë në sallën e Kuvendit të Shqipërisë. Arsimin e ulët e ka kryer në vitin 2011 në Woodroë Wilson, ndërsa arsimin e mesëm në Gjimnazin Franko-Shqiptar "Ernest Koliqi" në vitin 2014. Aktualisht ndjek studimet e larta për Financë në "University of Neë York Tirana". Që nga viti 2015, ajo është pjesë e forumit rinor të Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet.



Reme Lala


Përparim Spahiu

PËRPARIM SPAHIU merr nga dibranët mandatin e dytë radhazi për të qenë përfaqësues i tyre në Kuvendin e Shqipërisë. Slogani i tij kryesor në këtë fushatë ishte "Për Dibrën që duan dibranët". Gjatë mandatit të parë inicioi ligjin për statusin e Minatorit, status i cili nuk gjeti mbështetjen e mazhorancës. Ka premtuar në këtë fushatë se "Statusi i minatorit" do të jetë akti i parë për të cilin do të lobojë që të miratohet sapo të mblidhet parlamenti i ri. Ishte një ndër deputetët e Dibrës në legjislaturën e kaluar, i cili bënte kritikën më të fortë ndaj qeverisë për mosmbajtjen e premtimeve në këtë qark.

Spahiu ka lindur në Maqellarë më 27 janar 1971. Ka kryer studimet e larta në vitet 1989-1993 në degën Ekonomiks, pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës. Ka punuar Inspektor taksash në degën e tatimeve Bulqizë dhe nga viti 1998-1999, punoi në Drejtorinë e Shërbimit dhe Pagesave pranë Bankës së Bashkuar të Shqipërisë. Më pas ka pasur një karrierë të shkëlqyer në fushën bankare. Në vitet 1999-2001 ka punuar si oficer përgjegjës i këmbimit valutor, Tregun e parasë dhe Investimet financiare pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë, ndërsa në vitet 2001-2005, zv. Drejtor i këtij departamenti, për të vazhduar si Drejtor i Lartë deri në vitin 2010. Në vitet 2010-2012 ka punuar si konsulent financiar dhe investimesh. Që nga viti 2010 është anëtar i partisë Lëvizja Socialiste për Integrim.

ILIR BEQAJ, ish-ministër i shëndetësisë në qeverinë e kaluar, nuk është me origjinë nga Dibra, por do të përfaqësojë dibranët në këtë legjislaturë të Kuvendit të Shqipërisë. Në këtë fushatë elektorale u ndesh me pakënaqësi të elektoratit, jo vetëm për shkakun se nuk ishte me origjinë nga ndonjë bashki e qarkut të Dibrës, por edhe për arsyen se ishte një ndër ministrat e akuzuar më së shumti për korrupsion në qeverinë e kaluar. Konsencionet në fushën e shëndetësisë janë sulmuar shumë nga opozita.

"Kemi bërë shumë. Më shumë akoma mbetet për të bërë", ishte një nga sloganet kryesore që shoqëruan postimet e Beqajt në FB gjatë gjithë fushatës në qarkun e Dibrës. Kudo që shkoi në fshatrat e Matit, Klosit, Bulqizës e Dibrës, të gjitha investimet e pakta të qeverisë në mandatin e kaluar i shoqëronte me këtë slogan.

Ilir Beqaj ka lindur në Tiranë 18 shkurt 1968. Ka mbaruar studimet si Informaticien i Përgjithshëm, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës. Gjatë vitet 2009-2011, Beqaj ishte deputet i Kuvendit të Shqipërisë, por iu hoq mandati nga Gjykata Kushtetuese, për shkak se e gjeti në konflikt interesi në lidhje me përfitimet nga fondet buxhetore. Në tre vitet që pasuan, ishte Këshilltar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste. Në 2013 qe sërisht deputet i Kuvendit të Shqipërisë. Gjatë viteve 2013-2017 mbajti postin e Ministrit të Shëndetësisë.

ALMIRA XHEMBULLA ishte surpriza e kandidaturave të PS në Dibër. "Për Dibrën që duam" ishte slogani i saj kryesor. Prania e saj në fushata i uli shumë tensionet elektorale, së paku publikisht. Ajo u pa më së shumti mes grave, vajzave dhe biznesit të vogël. Gjatë fushatës promovoi shumë resurset turistike dhe potencialet e zhvillimit rajonal.

Ajo është lindur më 6 shkurt 1979 në Dohoshisht të Peshkopisë. Gjatë viteve 1997-2001 kreu studimet për Gjuhë-Letërsi pranë Fakultetit Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës. Studimet master i kreu pranë Universitetit Europian të Tiranës për Marrëdhënie më publikun. Në vitet 2002-2004, punoi si oficere projekti për rininë "Qendra e Edukimit dhe Komunikimit" (projekt danez). Gjatë viteve 2004-2012, punoi si këshilltare për Avokatësi dhe Lobim SNV (Organizata Holandeze për Zhvillim). Pesë vitet e ardhshme punoi si këshilltare për Avokatësi dhe Barazi gjinore, Fondacioni Ndërkombëtar CNVP.

DHURATA CUPI (TYLI) do të jetë deputetja e ardhshme në Kuvendin e Shqipërisë, që do të përfaqësojë opozitën në parlamentin e ardhshëm. E para në listën e PD, ishte po ashtu e para që iu përgjigj gjatë gjithë fushatës kryeministrit në lidhje me mosmbajtjen e premtimeve në Qarkun e Dibrës, veçanërisht për premtimin e bërjes realitet të Rrugës së Arbrit. Ajo bëri fushatë për "Republikën e Re" dhe besonte se "bashkë me Lulzim Bashën kryeministër ne do t'ia dalim". Disa nga sloganet e përdorura gjatë fushatës ishin edhe "Alternativa jonë është alternativa e qytetarit", "Është koha për qytetarët dhe të nesërmen e tyre".

Ajo ka lindur më 21 prill 1973 në Mat. Ka kryer arsimin e lartë për drejtësi. Ka punuar si juriste dhe ka qenë deputete e Kuvendit të Shqipërisë në legjislaturën e kaluar, pas dorëheqjes së Sherefedin Shehut. Ka qenë gjithashtu edhe Drejtore e AITPP.

XHEMAL GJUNKSHI është deputeti tjetër i opozitës që do të përfaqësojë Dibrën në Kuvend. Ai zhvilloi një fushatë pa ndonjë slogan fiks. Ai e bazoi fushatën në premtimet e kryetarit të PD për "Republikën e Re", sipas të cilit brenda dy vitesh do të bëhej e mundur hapja e tunelit në Rrugën e Arbrit, subvencionet e drejtpërdrejta në bujqësi e blegtori, rihapjen e filialit të Universitetit të Dibrës, përmirësimin e infrastrukturës lokale etj. Sulmet kryesore gjatë fushatës i përqendroi ndaj ish-ministrit Ilir Beqja, duke theksuar se "Lulzim Basha kryeministri i ardhshëm dhe Partia Demokratike do të kthejë dinjitetin, shpresën dhe besimin e munguar".

Xhemal Gjunkshi u lind në Peshkopi më 30 janar 1963. Ka kryer Akademinë Ushtarake "Skënderbej" në Tiranë dhe ne vitet 1995-1996 ka kryer Kolegjin e Luftës në Akademinë e Forcave të Armatosura Turke në Stamboll. Ka kryer disa kurse në profilin ushtarak në Holandë dhe Turqi. Ai ka një karrierë të pasur ushtarake duke e nisur në vitin 1986 si specialist stërvitje i Brigadës Peshkopi dhe duke arritur në 2013 si Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me gradën ushtarake Gjeneralmajor.

Përgatiti:
Alban Tufa, Bujar Karoshi.
Fotot janë marrë nga profilet në FB të kandidatëve fitues.


Rruga e Arbërit nr. 134

opinion

Spostimi im do tju jap mundësinë intelektualëve të tjerë të fillojnë pa humbur kohë të mendojnë se ç'duhet bërë që qeveria e re dhe deputetët e rinj të tregojnë konkretisht që në fillim të mandatit se vërtet po e venë ujin në zjarr për të përmbushur premtimet e bujshme elektorale në lidhje me këtë vepër jetike dhe strategjike, dhe jo vetëm.

Lobimi për Rrugën e Arbërit tani kërkon drejtim të ri

Nga Dr. **GËZIM ALPION**



Faqja e parë e peticionit në FB

Zhurma që filluan të bëjnë partitë kryesore në pranverën e vitit 2013 në lidhje me Rrugën e Arbërit më shtyri të konsultohem me disa intelektualë dibranë në Shqipëri dhe jashtë për të gjetur një mënyrë të re për të ngritur zërin në mënyrë të pavaruar për këtë vepër të rëndësishme infrastrukturore për të cilën dibranët janë mashtruar që nga viti 2005, kur u aprovua fizibiliteti i saj megjithëse pa një projekt të plotë i cili mungon edhe sot.

Kjo ishte edhe arsyeja e fillimit të peticionit online për rrugën më 18 mars 2013, peticion që do të qendroj i hapur deri në përfundimin e kësaj vepre sipas standardeve ndërkombëtare. Së bashku me kolegët që përkrahën që në fillim peticionin, e bemë të qartë se iniciativa jonë nuk përbënte një fillim, por një fazë tjetër në përpjekjet lobuese prej tre dekadash të dibranëve për këtë vepër. E veçanta e nismës tonë ishte se ne nuk do të bënim lojën e asnjë force apo kualicioni politik, ashtu siç nuk do të hiqnim dorë nga lobimi, pavarësisht presioneve, sulmeve dhe akuzave, që nuk munguan që në fillim.

Ne i mbajtëm premtimet për më shumë se katër vite, por jo atë të dorëzimit formal të peticionit pranë qeverisë që doli nga zgjedhjet e 23 qershorit 2013. Kjo nuk u realizua jo vetëm sepse kryeministri i saj na i mbylli dyert por edhe sepse ajo qeveri falimentoi dy muaj para përfundimit të mandatit.

Dorëzimi formal i peticionin nuk përbënte qëllim në vetvete. Objektivi ynë kryesor ishte fillimi i një dialogu konstruktiv me qeverinë. Për fat të keq, kjo nuk na e lejua.

Megjithatë, ne e vlerësojmë dialogun konstruktiv që patëm gjatë katër viteve të fundit me një numër politikanësh në Shqipëri dhe Maqedoni, përfshirë Presidentin Bujar Nishani, Kryetarin e Parlamentit Ilir Meta, dhe Kryetarin e Bashkimit Demokratik për Integrim Ali Ahmeti. Këto takime, përfshirë edhe kontaktet e vazhdueshme dhe korrekte me gjashtë deputetët e Dibrës, dëshmojnë se dialogu ndërmjet shoqërisë civile dhe politikës, megjithëse jo gjithmonë i suksesshëm, është i mundshëm dhe i domosdoshëm.

Për mua ishte nder dhe privilegj që gjatë katër viteve të fundit të bashkëpunoj, pothuajse çdo ditë, me disa miq dhe kolegë në Shqipëri dhe jashtë për një çështje kaq të rëndësishme për Dibrën e copëtuar, Shqipërinë veri-lindore dhe disa vende ballkanike. Pa përmendur emra, me këtë rast dua t'i falendroj të gjithë për besimin që patën që në fillim në motivet që më shtynë të filloj peticionin. Po kështu, u jam mirënjohës më shumë se 11,000 nënshkruesve të peticionit (8,500 online dhe 2,500 në formularë) për përkrahjen e tyre. Këta përkrahës janë nga çdo zonë e Shqipërisë, Kosovës, Malit te Zi, Maqedonisë dhe çdo vend i botës ku gjenden bashkëatdhetarët tanë. Mes nënshkruesve ka edhe të huaj që i duan të mirën Shqipërisë dhe kombit tonë.

> E veçanta e nismës tonë ishte se ne nuk do të bënim lojën e asnjë force apo kualicioni politik, ashtu siç nuk do të hiqnim dorë nga lobimi, pavarësisht presioneve, sulmeve dhe akuzave, që nuk munguan që në fillim.

> Dorëzimi formal i peticionin nuk përbënte qëllim në vetvete. Objektivi ynë kryesor ishte fillimi i një dialogu konstruktiv me qeverinë. Për fat të keq, kjo nuk na e lejua.

> Pa përmendur emra, me këtë rast dua t'i falendroj të gjithë për besimin që patën që në fillim në motivet që më shtynë të filloj peticionin. Po kështu, u jam mirënjohës më shumë se 11,000 nënshkruesve të peticionit (8,500 online dhe 2,500 në formularë) për përkrahjen e tyre.

Për mua do të mbesin të pashlyeshme mikpritja dhe përkrahja që gjetëm kudo ku kuvenduam për rrugën në Peshkopi, Maqellarë, Vlorë, Tiranë, Dibër të Madhe, Tetovë, Shkup, dhe Prizren. Bashkë me kolegët e Grupit të Lobimit, u jam mirënjohës të gjitha mediave, editorëve dhe gazetarëve shqiptarë në Ballkan dhe diasporë, si dhe mediave në disa vende të huaja si India, Britania e Madhe dhe Sllovakia, për përkrahjen dhe hapsirën e vazhdueshme që i dhanë lobimit tonë.

E shikoj të rëndësishme të theksoj se në katër vitet e fundit Grupi i Lobimit nuk ka pasur asnjëherë një drejtues në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Nuk kemi rënë dakord për çdo gjë në çdo kohë por asnjë vendim nuk është marrë pa pëlqimin e të gjithëve. Ka pasur momente kur më është dashur të flas në emër të Grupit të Lobimit. Megjithatë, edhe në këta raste unë kurrë nuk kam qënë drejtues.

Sot në Shqipëri po zhvillohen zgjedhjet parlamentare dhe së shpejti do të mësojmë kush do ta qeverisë vendin gjatë katër viteve të ardhshme. Kushdo që të fitojë zgjedhjet, ne urojmë që të mos ndjekin shembullin e paraardhësve në shumë gjëra, por veçanërisht në mungesën e vëmendjes ndaj Shqipërisë së 'largët' për të cilën Dibra ka kohë që është bërë sinomim.

Duke patur parasysh realitetin e ri politik, mendoj se është në të mirën e lobimit për Rrugën e Arbërit që unë të spostohem, ndërkohë që do të vazhdoj të jap kontributin tim modest për zhvillimin e Dibrës dhe Shqipërisë. Spostimi im do tju jap mundësinë intelektualëve të tjerë të fillojnë pa humbur kohë të mendojnë se ç'duhet bërë që qeveria e re dhe deputetët e rinj të tregojnë konkretisht që në fillim të mandatit se vërtet po e venë ujin në zjarr për të përmbushur premtimet e bujshme elektorale në lidhje me këtë vepër jetike dhe strategjike, dhe jo vetëm.

25 qershor 2017



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit ose ndiq linkun: https://tinyurl.com/lcc3e2f

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT!

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit.
Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

printime dixhitale
me ngjyra dhe bardh e zi
shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.
duke filluar nga 1 kopje e vetme
për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

aktualitet

Hidroenergjia në Shqipëri

Nga Enver Hoxha tek EBRD-ja



Një nga 750 000 bunkerë në Shqipëri, e ndërtuar gjatë regjimit të Enver Hoxhës.

Nga **PETR HLOBIL**

Enver Hoxha, ish-diktatori komunist në Shqipëri, sundonte në një mënyre aq të çuditshme saqë ai e gjeti veten të izoluar nga sunduesit e tjerë komunistë. Midis gjërave të tjera, ai e përmbyti shtetin me 3 milionë njerëz me 750 000 bunkerë betoni, të ndërtuar duke injoruar njerëzit, natyrën por edhe rregullat ushtarake- duke parë se si disa prej tyre ishin ndërtuar përballë njëri-tjetrit.

Ndërkohë që shumica e bunkerëve po çmontohet për skrap, qeveria shqiptare, e inkurajuar nga kontribuesit ndërkombëtarë si Banka Europiane për Rindërtimin dhe Zhvillimin (BERZH/EBRD), Banka Botërore ose Banka Gjermane e Zhvillimit KfW, i ka hedhur sytë nga një marrëzi tjetër e betonuar. Mbi 300 hidrocentrale në faza të ndryshme planifikimi ose përgatitjeje duken sikur do të zënë vendin e bunkerëve në këtë vend kryesisht malor.

Këtë javë Bankwatch vizitoi HEC-in e Tërnovës (8.4 MW), të zhvilluar nga Canadian Hydro Investment dhe kompania shqiptare Theodori pranë qytetit të Bulqizës ne Shqipërinë qendrore. Centrali, i financuar nga EBRD dhe Societe Generale filloi punën vitin e kaluar. Kanale të tjera që sjellin më shumë ujë janë ende nën konstruksion. Projekti na është sjellë në vëmendje pasi banorët në disa fshatra kanë protestuar për disa vite kundër centralit, ndaj frikës se mund të ketë një ndikim në ujitje, rrjedhimisht duke ndikuar jetesën e tyre, duke qenë se të ardhurat e tyre vijnë kryesisht nga agrikultura.

Hidrocentrali i Tërnovës merr ujë nga Liqeni i Zi, një liqen akullnajor që është një monument natyre i njohur nga shteti, duke e lidhur atë me rrjedha ujore dhe liqene të tjerë akullnajorë me anë të tuneleve dhe kanaleve.

Me këtë projekt, EBRD-ja, krenare me standardet e saj mjedisore, duket sikur do të bëjë Enver Hoxhën krenar, duke shtyrë natyrën jashtë rrugës e duke ecur drejt një "të ardhmje të ndritur". Si rrjedhim, nuk ka rëndësi qe projekti nuk ka masa anti-erozionit, duke e kthyer të tërë kodrën në një rrjetë të çarash me rrezik të lartë shkarjesh dheu dhe erozioni. Banorët e zonës kanë frikë se kjo do të dëmtojë rrugët që ata përshkojnë për të shkuar tek kullotat dhe pylli.

Kanalet që lidhin liqenet dhe rrjedhat e ndryshme sjellin shumë sedimente që kanë ndryshuar hidrologjinë e Liqenit të Zi.



Një kodër me një tub uji të projektit hidroenergjit Ternove. Kjo tregon se ndërtimi është plotësisht i pamjaftueshëm për të shmangur rrëshqitjet e tokës.

Gjithashtu, fakti që Inspektorati i Pyjeve e ka gjobitur kompaninë disa herë për gërmime në pyje pa lejet e duhura vetëm na jep përshtypjen se, për sa i përket zbatimit të rregullave mjedisore, EBRD-ja nuk e ka monitoruar këtë projekt nga afër aq sa duhet.

BANORËT I DRUHEN MUNGESËS SË UJIT

Në disa fshatra njerëzit protestuan, me frikën se hidrocentrali do t'jua marrë ujin që përdorin për vaditje. Protestat ndodhën pasi nuk pati konsultime me banorët mbi projektin dhe pasojat e tij. Është e vështirë të maten pasojat e projektit, pasi nuk varet vetëm nga disponueshmëria e ujit por edhe nga infrastruktura e vaditjes.

Fshati i Strikçanit, rreth 22 km në lindje të Bulqizës, është i varur nga vaditja nga Korrik deri në Shtator. Fshatarët mbledhin nga 20 000 Lekë (afësisht 150 EURO) çdo vit për të paguar një punëtor të zonës për të pastruar kanalin e vaditjes me kazmë dhe lopatë.

Kohët e fundit, fshati mori disa qindra metra tub plastik nga administrata e zonës për të pakësuar humbjet në disa pjesë të kanalit, por

> Me këtë projekt, EBRD-ja, krenare me standardet e saj mjedisore, duket sikur do të bëjë Enver Hoxhën krenar, duke shtyrë natyrën jashtë rrugës e duke ecur drejt një "të ardhmje të ndritur".

një pjesë e tij kalon përmes shpateve malore të prirura ndaj rrëshqitjeve të dheut. Fshatit do t'i duhej një investim më të madh për ta përforcuar kanalin. Kryeplaku i fshatit thotë se punime të tilla do të kushtonin nga 10 mijë deri në 25 000 Euro, shumë më shumë se ç'mund të mbledhin fshatarët.

Nuk është surprizuese kur fshatarët irritohen kur shikojnë që qeveria i jep investuesve përjashtime nga taksat ose edhe akses ndaj ujit që ju duhet dëshpërimisht fshatarëve.

EBRD-ja nuk duhet të përsërisë gabimet e Hoxhës: Investimi masiv dhe i paarsyeshëm në bunkerë betoni i dha një goditje të fortë ekonomisë shqiptare. Shqipërisë nuk duhet t'ia mbushim tokat, lumenjtë dhe liqenet me beton. EBRD-ja do ta mësonte këtë nëse do të uleshin për 5 minuta me njerëzit e mençur të Bulqizës dhe fshatrave përreth.

Klara Sikorova (Kërkuese) dhe Igor Vejnovic (oficer policie ujore) kontribuan në shkrimin e këtij artikulli.

Faleminderit Olsi Nikës, EcoAlbania dhe aktivistëve dhe komuniteteve lokale për kontribuimin e tyre.

Shih shkrimin në origjinal në linkun: https://bankwatch.org/news-media/blog/enver-hoxha-ebrd-and-back-hydropower-albania

---

Përktheu nga anglishtja:
KLOVIS KAROSHI



Rrjeti disa kilometra i kanaleve konkrete vështirë se do të nxisë potencialin turistik të rajonit.



Tubat e ujit janë të shtrirë nën kodra të pjerrëta që janë të prirura për rrëshqitjet e tokës.

Rruga e Arbërit nr. 134

Një ditë në burimet e Sopanikës

reportazh

Seta, lumi që rrezikon

Nga **ALBAN TUFA**

Fotot: **FRANK HOXHA**



Nuk është një takim elektoral. Është një takim i zakonshëm ku burrat e fshatit flasin për fatin e ujërave të Sopanikës.

Rruga për Peshkopi është rraskapitëse deri në kocka dhe pikërisht për këtë fakt tashmë të provuar, me zor arrita t'i bind disa nga shokët e kursit tim në fakultet. Pas disa tentativash bashkë me një shoqe (dhe ajo dibrane), ia arritëm qëllimit gjithsesi. U bëmë 10 veta nga të gjithë cepat e Shqipërisë dhe u gjendëm pikërisht mu në mes të bulevardit. Një miku im nga Kavaja, mbajti gjithë kohës nga fillimi deri në fund të bulevardit një qese me mbeturina në dorë sepse s'po gjente një kosh. Normal që u vetëmbrojta duke shfajësuar qytetin tim me arsyetimin se bulevardi është rikonstruktim e sipër, gjë që e dëshmonin edhe paletat e pllakave në mes të tij. Megjithatë e dija që ky arsyetim i imi nuk qe fort i logjikshëm. E hodhi qesen në një nga koshat e Bar-Restorant Korabit (Turizmit), ku pimë edhe kafen e pushimit. Pas kafesë morëm rrugën për në Çidhën, pikërisht në lumin e Setës.

FUSHATË DHE PREMTIME, POR NË RRUGË PUNOHET

Deri tek shkolla e Kastrioti arrin rehat, edhe pse lodhja sigurisht që bën të vetën, mandej sapo lë asfaltin dhe drejtohesh teposhtë Drinit, furgoni zë pahitet sa në një anë në tjetrën, sinkron me të dhe kokat e pasagjerëve. Shoferi mundohet të ec sa më ngadalë.

"Edhe pak e shpëtuam, po shtrojnë me asfalt"- thotë njëri nga dy burrat e moshuar të zonës që gjendeshin me ne në furgon.

"Për fushatë"- ia pret tjetri. Pastaj kapen me muhabete politike, dhe të japin përshtypjen sikur janë analistë të thekur politikë.

Përgjatë rrugës, deri buzë fshatit Përgjegje punohej vërtet dhe punimet e ekskavatorëve ngrini shtëlluga pluhuri sa të bëhej sikur po ndodhnin shpërthime.

MONUMENTI QË KUJTON MASAKRËN

Pak para te kalonim lumin Drin, u ndalëm dhe vizituam një Monument përkujtimor të luftërave dhe betejave më të mëdha të zonës së Çidhnës dhe Kastriotit. I ngritur në një kodër relativisht të dukshme dhe me pllaka të gdhendura me data betejash, ku ndër to bie më shumë në sy: "BETEJA E TORVIOLLIT më 26.09.1444 u zhvillua në fushën e Dibrës Poshtme, ku 15000 arbër të Lidhjes së Lezhës të komanduar nga Skënderbeu, mundën 25000 kalorës Osmanë. (M.Barleti)" dhe "MASAKRA E ÇIDHNËS, gusht 1466... në viset e Skënderbeut që quheshin KIDNA... Mehmeti II...shkoi në thikë 8000 burra, veç grave dhe fëmijëve. (M.Barleti).

Sapo i ktheva shpinën këtij monumenti, mu dha e fortë ndjesia se përpara kemi një zonë historike, bujare, trime dhe plot tradita dhe që sigurisht duhet t'i ruajnë akoma.

DREJT ÇIDHNËS, NË GJURMËT E SKWNDERBEUT

Kaluam mbi urën e re, e ndërtuar vitin e kaluar. Kjo urë e ka shkurtuar rrugën dhe kohën për të shkuar në Çidhën. Fill pas urës, ngjitemi një rruge njëkalimshe, me gropa dhe plot kthesa të forta. Përpara na shfaqet fshati Arras, edhe ky një fshat i shquar për tradita. Lëmë pas Arrasin dhe ngjitemi sipër për në Çidhën.

Zhurma e furgonit që çan përsipër kodrinës, më sjell imazhe të vjetra: zhurmën që nxjerrin hundësh kuajt kur vrapojnë. Ndërsa unë këtë rast nuk po mendoj për kuajt e garave që shohim nëpër televizione por, ata kuaj që vrapuan në beteja, shërbyen për këto zona malore dhe të strukura pas shpatesh. Ngjitja nuk ka të sosur dhe të duket si kur po shkon në një botë të pashkelur nga askush më parë. Nuk ka asnjë gjurmë të asaj që quhet urbane, e megjithatë, duket që shokët e mi po e shijojnë këtë pamje dhe unë ndjehem vërtet i kënaqur dhe tepër krenar.

Porta e Parë është hyrja për në Çidhën. Aty gjendet një masiv guri i quajtur Kepi i Skënderbeut ose Kepi i Qytetit. Ky terren i përthyer rrëfen shumë si për të tashmen dhe



Lumi Seta

për të shkuarën. Këto zona, na rrëfejnë dy burrat që gjenden në furgon, rrallë kanë rënë në duar të pushtuesit. Nga njëra anë sepse ishte terreni i përthyer dhe shumë shkëmbor e për pasojë zor që të njihej nga pushtuesit dhe nga ana tjetër qëndresa dhe bashkimi që kishin këta njerëz. Në anën tjetër gjendet Muzeu i Skënderbeut, tregojnë burrat, tek në sfond për të disatën herë është një këngë me motive patriotike dibrane.

Sapo u ngjitëm në majë të kodrës u gjendëm tek Fusha e Kalorësve, 200 m gjerësi dhe 800 gjatësi. Në këtë fushë, kryheshin përgatitjet për luftëra. Ndërsa sot toka është e ndarë në parcela dhe mbjellë kryesish me misër me fasule dhe jonxhë.

Pasi lëmë Fushën, zbresim poshtë për në lumin e Setës. Tashmë edhe furgoni sikur shfryn. Zbresim gati buzë lumit, të lodhur e të rraskapitur nga pesë orë e gjysmë rrugë. Takojmë një valle burrash të ulur në një livadh nën hijen e një dushku të madh, i takojmë dhe na e dinë fort për nder që kemi ardhë me pa bukuritë e vendit ku ata kanë lindur, janë rritur e plakur dhe ku kanë vendos të mbyllin jetën e tyre. Ulemi një copë herë disa na shpjegojnë për ndërtimet e Hec-eve. Tregojnë se askush nuk i ka marrë parasysh mendimet e tyre, dhe që ata e kanë çuar në gjykatë çështjen e ndërtimit të Hec-it Seta 4.

SOPANIKA, UJI QË E DUAN TË GJITHË

Çohemi sepse qëllimi ynë është të jemi në hyrjen e shpellës së Sopanikës. Zbresim në lumë dhe kalojmë nëpër një urë druri ndërtuar nga banorët e zonës, por që është një bukuri e shtuar kësaj rrjedhe. Nga ana tjetër e lumit, në një shpat mali, zbret uji i ftohtë nga Burimi i Sopanikës. Mu në pikën ku bashkohet me lumin, formon një ujëvarë ku uji i së cilës, përplaset me hov në pellgun fundor dhe krijon shkumëzime duke marrë trajta bardhë-e-blu. Të gjithë vrapojnë e bëjnë fotografi, ndërsa unë përkulem e pi ujë në pellg. Ata që janë rritur në qytet u habitën, ndërsa të tjerët që vijnë nga fshatra, ulen e pinë me mua. Uji kristal, akull i ftohtë, dhe bashkë me ftohtësinë e tij, sjell duhmën e tij të freskët duke ta bërë gjithçka si parajsë.

Ngjitemi sipër duke na udhëhequr një pjesë e banorëve që deshën të na shoqëronin. Duket se këta njerëz kanë nevojë për njerëz të rinj, ata duan që bukuritë e vendit të tyre të duken, të shihen nga të gjithë. Uji në pjerrtësinë vet dhe në përplasje me gurët e mbuluar me myshqe, dhe që marrin trajta ajri, gurgullon me një tingull që të bën të harrosh gjithçka dhe t'i dorëzohesh kësaj vepre të Hyjnores.


Na duhet të kalojmë në një masiv guri, që të ngjan sikur futesh në një çadër, ndërsa një pjesë e shokëve mbeten pas, gjatë gjithë kohës më aparate fotografik dhe me celularë në duar. Ndërsa disa të tjerë janë përkulur buzë shkurreve të shkozave dhe mbledhin luleshtrydhe (dredhëza). Lodhja as që ndjehet dhe ne ngjitemi në hyrjen e shpellës. E gjithë gryka e shpellës të ngjan sikur është në tubë kroi pa rubinetë që nxjerr ujë gjatë gjithë kohës. Kur afrohesh afër ndjen që bashkë me ujin aty buron edhe ajër i ftohtë.

Buzë saj nga ana e sipërme, rrjedha e ujit del nga një shkëmb në formën e hinkës dhe bie me një forcë rëndese dhe krijon tinguj që të marrin me vete. Ngjitur me hinkën e natyrës, gjendet një pusetë përthithëse uji, duke marrë kështu një pjesë nga uji që buron dhe që shkon deri në Kastriot për të furnizuar banorët me ujë të pijshëm.

Shpella dhe ujëvara e Sopanikës u shpall Monument Natyre dhe gëzon status mbrojtjeje me Vendim të Këshillit të Ministrave nr 676, datë 20.12.2002, ndërsa në vitin 2015,

mjedisi

të zhduket



"Shif, a patë ju rrugës? S'ka asnjë tabelë me tregu çfarë bëhet". Dhe me të vërtetë ne nuk pamë asnjë tabelë që të tregojë projektuesin, kontraktorin, buxhetin, kohën dhe më kryesorja çfarë po bëhet. "7 mullinj dhe një varavejc gjenden në këtë rrjedhë uji", shton më tej Haxhi Cerri, tek tregon brengat që ka për vendin ku lindi dhe u plak.

Këshilli Kombëtar i Territorit, jep leje për ndërtimin e Hec-eve Seta 1,2,3 dhe Seta 4. Ky i fundit parashikon të fus në tuba gjithë rrjedhën e Sopanikës dhe të Setës. Shpella e Sopanikës mendohet të ketë një gjatësi prej 5 kilometër (sipas banorëve), ndërsa 3 kilometër janë eksploruar nga gjeologë (profesorë dhe studentë) bullgarë.

ÇIDHNA, FSHATI QË NUK DËGJOHET

Duke parë nga shpella, ballë saj, duket fshati Çidhën, me shtëpi të vjetra dhe një pjesë e mirë prej tyre janë braktisur. Këtu mban dimër i ftohtë por edhe verë e nxehtë. Vetë përbërjet shkëmbore përthithin rreze dielli dhe temperatura kalon 5 gradë më shumë se në një vend tjetër në Dibër. Ndërsa burimet që janë në këtë rrjedhë dhe zona përreth, bëjë që temperaturat mos jenë aq të larta duke u ndikuar thelbësisht nga freskia dhe temperaturat që ujërat kanë.

Pasi rrimë një copë herë në grykën e shpellës, aq kohë sa u lodhëm duke fotografuar gjithçka dhe duke u larë e shpërlarë në atë ujë të ftohtë dhe mandej nisemi të zbresim poshtë. Tek zbrisnim poshtë, një rrëshqitje mbi dhé dhe mbi copëza gurësh, më kujton fëmijërinë time. Gurët përreth janë të një ngjyre të errët. Rrotull ka drurë shkoze, arre, pal dhe plot lloje të tjera.

Zbresim poshtë në një kanal vaditës, i cili para shumë kohësh kishte shërbyer për të vaditur të gjithë fushën e Kastriotit, ndërsa sot shërben vetëm për dy-tre fshatra përreth. Tek ecim në kanal, gjendet një shpellë e vogël ku uji kalon nën të dhe masivi shkëmbor është me vrima të vogla dhe të ngjan si një sfungjer. Nga ana jonë e majtë shkëmbi është i prerë si me thikë duke formuar diçka si pasqyrë, ndërsa nga ana jonë e djathë në rrjedhën e Setës gjendet Rasades, vendi ku bëhet rrahja e peshkut (më e madhja në të gjithë Dibrën).

Ajri këtu është shumë i pastër. Freskia e bimëve dhe e ujit bën të vetën. Madje nga prezenca e lartë e oksigjenit, një shoqe e imja pati probleme me frymëmarrjen, ama gjithçka kaloi shpejt dhe e mori veten.

Pasi i dolëm kanalit aty ku fillonte, nga shpati i djathtë, rrjedhës i shtohej një tjetër burim. Burimi, edhe ky në shpellë quhej Klloxhnesha. Edhe kjo një shpellë e eksploruar nga gjeologët bullgarë, me pretendimin se gjatësia e saj shkon deri të 3 kilometër. Sipas gojëdhënave që rrëfejnë banorët, fshati Çidhën e Poshtme, nuk kishte ujë për të vaditur dhe mbyllën shpellën e Klloxhneshës me qëllimin dhe shpresën që uji të dilte në majë të kodrës. Shkëputjet teknokike e shkatërruan murin dhe uji mori përpara Sofrën e Bajraktarit në Arras. E megjithëkëtë, mendohet që maja e kodrës të shpohet sërisht, po me shpresën që uji i cili buron në fund të kodrës, të burojë në majën e saj.

Ecim në të kundërt të rrjedhës së ujit, dhe më andej gjendet Shehu i Thatë ose Hala e Zezë (llojë pishe). Ky ishte një vendstrehim historik në të gjitha luftrat me pushtuesit duke nisur nga pushtuesit osmanë, serbët, italianët dhe në fund gjermanët (edhe pse lufta e madhe e çidhnakëve qe me komunistët). Ky vendstrehim qe një pikë strategjike që s'u mor kurrë nga okupatorët përveç të vetmes herë nga Sulltan Mehmeti II në verë 1466.

Të gjitha kryengritjet dhe organizimet luftarake u bënë nga ky vend. Pikërisht në këtë rrjedhë gjenden 17 shpella me emra dhe katër të tjera pa emra.

Banorët ishin të shqetësuar për ndërtimin e Hec-it Seta 4, dhe që ishin të gatshëm ta mbronin me jetë. "As turku, as serbi, as italian e gjermani s'na e morën dot këtë vend, jo më të vijnë të na e marrë një tepelenas", thotë Qazim Daci, një burrë pak i thinjur, i cili flet avash, pastër dhe me një tërheqje duke të marrë nën rrëfim.

TURIZMI, NJË SHPRESË E LARGËT

Rruga duhet bërë në kthim tashmë sepse koha nuk premton. Zona nuk ka hotel dhe një pjesë do kthehen në Peshkopi ndërsa pjesa tjetër do kthehet në Tiranë. Mos pasja e hoteleve dhe bujtinave kthehet edhe njëherë në problem madhor për turizmin në vendet tona. Por megjithatë, kush do natyrën i gjen mënyrat. Në kthim për në fshatin Çidhën, ashtu me atletet e lagura e të bëra qullë nga kalimi i vàve të lumit dhe nga dëshira për freski, sytë nuk shohin tjetër veç dy shpatet anësore. Në njërin shpat janë ca zig-zage dhiaresh, dhe më tej disa rrasa gurësh me nuanca të kuqërremta. Vërtet që nuk dua të ndahem me këtë bukuri që ka ndërkallur Perëndia me dorën dhe madhështinë e vet, tek ndërkohë më vjen turp me veten që jam rritur në Fushën e Kastriotit dhe nuk kam qenë kurrë në këto zona duke e bërë jetën time ngushtësisht të vogël.

Kthyem dhe disa nga burrat e Çidhnës i gjetëm sërish nën hijen e dushkut të madh. Siç dukej kishin diçka të na thonin: diç mes lamtumirës, përshëndoshjes dhe premtimit, kërkesës. Sikur donin të na thoni "Ju i patë bukuritë tona, tashi mos i harroni, mos i lejoni të shkatërrohen!". U ulëm apet në vendi ku ishim ulur në kohën kur erdhëm. Unë në me bllok në dorë duke mbajtur shënime për këtë reportazh, një shok imi me kamera, të tjerët me celularë, po merrnin copëza imazhesh pos kujtimeve që zor të zhbëhen.



Studentë e degës së Shkencës së Komunikmit të Universitetit Beder gjatë një vizite në shpellën e Sopanikës në Çidhën.

HEC-ET QË KËRCËNOJNË

Banorët ishin të shqetësuar për ndërtimin e Hec-it Seta 4, dhe që ishin të gatshëm ta mbronin me jetë. "As turku, as serbi, as italian e gjermani s'na e morën dot këtë vend, jo më të vijnë të na e marrë një tepelenas", thotë Qazim Daci, një burrë pak i thinjur, i cili flet avash, pastër dhe me një tërheqje duke të marrë nën rrëfim. Ai flet e flet për historinë, të shkuarën dhe të tashmen duke bërë bilance, derisa në përfundim revoltohet duke thënë: "nuk bëhet Hec këtu, pa u shtyp koka njerëzish.". Me na tharë ujin na kanë tharë shpirtin shpjegon Qazim Daci, duke thënë se vetëm ky ujë i zbut temperaturat se përndryshe aty nuk do jetohet ma pa ujë, ngaqë vapa do jetë e tmerrshme.

Ndërsa Haxhi Cerri thotë: "Shif, a patë ju rrugës? S'ka asnjë tabelë me tregu çfarë bëhet". Dhe me të vërtetë ne nuk pamë asnjë tabelë që të tregojë projektuesin, kontraktorin, buxhetin, kohën dhe më kryesorja çfarë po bëhet. "7 mullinj dhe një varavejc gjenden në këtë rrjedhë uji", shton më tej Haxhi Cerri, tek tregon brengat që ka për vendin ku lindi dhe u plak.

Askush nga ne nuk e donte një mbyllje të kësaj dite, por, megjithatë, me aq sa pamë dhe shijuam dhe duke marrë parasysh se ç'bukuri mund të zhduket, u bëmë sado pak palë me brengat dhe shqetësimet e tyre. U ndamë me ta dhe hipëm në furgon, i cii nisi ulërimën e vet për malores deri sa u ngjitë në kodër dhe mandej morëm teposht. Rrapa-dumja e furgonit ja nisi nëpër gropa.

Gjithsesi, të kalosh nëpër Arrash dhe të mos ndalesh të hash peshk është një e drejtë që nuk mund t'i mohohet vetes. Sërisht po më vinte turp që po haja për së pari herë peshk në Dibër me shokët dhe shoqet e mia nga të katër cepat e Shqipërisë.

"NJË UJ' QË EC, PIHET"

Ne, e gjithë rinia shqiptare, dhe më shumti ajo dibrane, kemi rënë pre e një jete klishe dhe pasive plot e plot herë, duke mos parë ç'bukuri mund të kemi rreth vetes dhe vendit ku jetojmë, të cilat jo pak herë na humbasin ose na i shkatërrojnë akoma pa i parë. Unë i pari kam qenë dhe sërish jam deri diku dembel, sepse akoma nuk njoh Dibrën edhe pse kam qenë në disa vende të Europës. Nuk di të ketë një formulë të posaçme për të dalë nga këto klishe, por edhe këtu si çdo herë tjetër, fjalët e të parëve gjejnë vend kur thonin: "Një uj' që ec, pihet".

Prandaj le të mos rrimë duke shtyrë kohën dhe qarë hallet, por le të ecim e të çlirojmë gjithë ç'na gjendet në trup negative.

Rruga e Arbërit nr. 134



Shiu që të kthen në kohë, në vitet e rinisë

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Nuk do të hyjë në pentagramin e vargjeve “Shi bie në Tiranë”.

Shi bie edhe në Athinë ashtu siç bie në të gjithë botën. Me pika. Me litarë. Me rrebeshe...

Si çdo mesditë vere edhe sot u ula në verandë. Me një gotë raki thane Kurbini që Albani, nipi i gruas, ma fut me dashamirësi mes rrobave në ikje. Nuk ia them rakisë, madje vonë, shumë vonë, e kam vënë në gojë. Se prindërit, fshati, tërë krahina e Maleve të Poshtme të Dibrës e të Topalltisë luginës së Drinit të Zi, jo nuk e pinte por as e fuste në shtëpi. Kështu ishte zakoni, kështu e kështillonte feja. Unë nuk e pija jo për hatër të besimit fetar sepse unë nuk besoj, por sikur nuk ma pranonte organizmi, më digjte sa e vija në gojë.

Vonë filloi të hyjë rakia në odat e Dibrës së Poshtme. Në dasma shokët e punës mblidheshin në një dhomë dhe ngrinin dolli. Dolli u thënçin se asnjëra nuk ishte vendase. Të gjitha i kishin marrë e sjellë djemtë e rinj kur kryenin shërbimin ushtarak në Jug të Shqipërisë. Kështu kishte “dolli labçe”, me urime tërkuzë për të pranishmit dhe të munguarit, dolli që gjithnjë përfundonin me “shëndet për Partinë e për Komandantin”, “dolli Korçare”, “Përmetare”, “Myzeqare”, “Skrapare”...

Aq të larmishme ishin dollitë sa të dukej se je në një sofër të madhe shqiptare.

Nejse, u vdora dhe harrova shiun...

Sa herë shtrohem për drekë në verandë më është bërë zakon të rrotulloj burmat e radios dhe të fiksohem në “muzikë dhome”. Kur gjej ndonjë muzikë operistike, veçanërisht të atyre operave që në rininë time studentore nuk kam lënë asnjë pa e parë, ndalem dhe shoqëroj përtypjen.

Sot e fika radion. Në perden (kështu po e quaj sepse si perde varet) dimërore prej plastmasi kapeshin dhe rridhnin çurg pikat e shiut. Nuk e kisha hequr perden dimërore ndonëse gjuhët e varura të tendës prej bezeje më përqeshnin çdo ditë me diell të nxehtë. Sot nuk po e bëjnë. Mbase e kanë kuptuar se ky shi pikërisht atë perde donë.

E fika radion. Melodia e shiut shoqëruar me gjëmimet e bubullimat që vinin nga larg, më hynë në shpirt, ma plotësuan më mirë se çdo gjë kërkesën muzikore të shpirtit.

Thonë që shiu të fut në trishtim. E kundërshtoj. Shiu të fut në meditim. Të kthen mbrapa në kohë, të merr e të çon larg, në vite të vegjëlisë e të rinisë. Mua nuk e di pse sot më çoi në Prat të Selishtës për tu ndalë tek Pusi i Kurt Bodinit, për të zbrit thellë kovën e drunjtë prej pishe arneni e për të nxjerrë ujin e ftohtë. Nuk e di pse Kurti në një vend ku kishte kaq burime uji (një burim poshtë shtëpisë së tij, anës rrugës thuhej se është më i miri për kurimin e veshkave), kishte hap pus dhe e përdorte për të gjitha nevojat e shtëpisë. E kishte pikë të dobët Kurti pusin. Dhe po t’ia lavdëroje bëheshe mik për kokë me të, therte “dashin e Shënkollit”.



Sikur Kurti ta piqte e shërbente rakinë me manaferra dhe mjedrat që mbulojnë pyjet e Pratit, mbase pusi do të harrohej.

Mua nuk më harrohet sepse uji i atij pusi ishte dollia më e bukur e atyre bjeshkëve ku më ka qëlluar të udhëtoj verës e dimrit, ndër të tjera, dimrit të egër 1985.

Nga Prati fluturova në bjeshkët e Korabit, siç kisha “fluturuar” në këmbë një ditë vere me vapë përvëluese, pjesë e një marshimi zboristësh...

U ngjita në Bjeshkën e Preshit dhe mbusha grushtin me ujin e pastër të burimit të Korabit në virgjërinë e tij të paprekur nga kazma e kërkuesve të ujit të pijshëm për qytetin e Peshkopisë.

U ngjita në Rrafsha të Korabit e pas një nate në çadër me mikun tim të gazetarisë, fotoreporterin Gani Xhengo të ATSH-së, udhëtuam nëpër një peizazh të mrekullueshëm për të përfunduar në pamjen më të mrekullueshme të jetës sime, Bjeshkën e Ponairit. Një fotografi e miku tim të mirë ma ka bukuruar serinë e librave të mi “Njerëz që i dua”.

Më pas mbi dy kuaj në shoqëri të Shuaip Methasanit, do të udhëtoja të përpjetës së thepisur të Livadhit të Gjatë ku Kalaja e Dodës të vjen e të ulet në gjunjë, Bjeshkës së Shehut ku burimet e ftohta dalin pas çdo shkëmbi për të udhëtuar në një kanal e sifon me trungje pishe drejt Sllovës e Sllatinës e për të thithur në tokën e zhuritur nga vapa. Më tej do të ndaleshim midis gjelbërimit e luleve të fillim korrikut në Bjeshkën e Zonjave...

Këtu u ndala. Bukuria e bjeshkëve sa të hante poshtë e lart syu, liqeni artificial me peshk që hidheshin si në një vallëzim hyjnor, shëllinasi siç quhen masivet e gipsit, pamje që zbret e ta jep për të pirë në gotë kristali bukurinë e Luginës së Drinit të Zi, dhe tutje e tutje, atje ku Mali i Muhurrit dhe Mali i Çidhnës mbështeten pas Malit të Bukurisë Dibrane dhe Shqiptare, malit që mban në gjoks Liqenet e Lurës...

Shiu pushoi...

Edhe unë e boshatisa gotën e rakisë...

Mbi perde pikat si margaritarë morën rrezet e diellit që çeli sytë pas reve e po zbret drejt detit të Pireut...

U ngrita.

Më duhet që meditimin tim, atyre çasteve me muzikë pikash shiu mbi pentagramin e kujtesës, ta mbillja në kujtesën e meditimeve dhe shënimeve të mija për të mbirë e çelë lule ndonjëherë tjetër.

Mbase në ndonjë ditë kur qielli mbushet me flokë të bardha dëbore. Muzikaliteti jetësorë i të cilave është në kufi të bukurisë së bukurive.

Athinë, 4 qershor 2017

Titulli në origjinal: “Shi bie në Athinë...

skicë

Mua nuk e di pse sot më çoi në Prat të Selishtës për tu ndalë tek Pusi i Kurt Bodinit, për të zbrit thellë kovën e drunjtë prej pishe arneni e për të nxjerrë ujin e ftohtë. Nuk e di pse Kurti në një vend ku kishte kaq burime uji (një burim poshtë shtëpisë së tij, anës rrugës thuhej se është më i miri për kurimin e veshkave), kishte hap pus dhe e përdorte për të gjitha nevojat e shtëpisë. E kishte pikë të dobët Kurti pusin. Dhe po t’ia lavdëroje bëheshe mik për kokë me të, therte “dashin e Shënkollit”.

Bukuria e bjeshkëve sa të hante poshtë e lart syu, liqeni artificial me peshk që hidheshin si në një vallëzim hyjnor, shëllinasi siç quhen masivet e gipsit, pamje që zbret e ta jep për të pirë në gotë kristali bukurinë e Luginës së Drinit të Zi, dhe tutje e tutje, atje ku Mali i Muhurrit dhe Mali i Çidhnës mbështeten pas Malit të Bukurisë Dibrane dhe Shqiptare, malit që mban në gjoks Liqenet e Lurës...



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit ose ndiq linkun: https://tinyurl.com/lcc3e2f

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com

bujqësi

Gruri, kultura që po mbillet çdo vit e më pak



Nga **OSMAN XHILI**

Ivjetër, sa dhe vetë njerëzimi, gruri i ka shërbyer njeriut si një nga kulturat bazë, krahas misrit dhe orizit. Mendohet të jetë shfaqur në Mesapotaminë e lashtë, ne Kinë, e më pas duke u përhapur kudo në botë, për tu bërë aq popullor sa e njohim sot.

Qarku i Dibrës mbjell zakonisht një sipërfaqe prej rreth 3000 hektarësh. Të dhënat tregojnë se në vitet në vazhdim, sipërfaqja e mbjellë me këtë kulturë, po vjen në ulje të vazhdueshme, duke bërë një zbritje drastike me gati 1000 hektarë, në vitin aktual. Arsyet për këtë janë të shumta.

Të mbjellësh grurë sot duket si një sipërmarrje e madhe. Në këtë rrugë të gjatë 8 – 9 mujore, fermeri ndesh pengesa dhe vështirësi të panumërta, që i zënë rrugën, dhe jo pak herë e bëjne atw pesimist, aq sa ai mendohet gjatë për vitin tjetër. "Të mbjellësh apo të mos mbjellësh", kjo është dilema e sotme. Janë kaq shumë faktorët që ndikojnë pozitivisht apo negativisht në këtë drejtim, saqë ia vlen të merresh me secilin veç e veç, dhe të gjithë së bashku.

Një nga specialistët e vjetër të agronomisë në Dibër, Qerim Kadriu, thotë, se që të zbatosh teknologjinë, duhet të njohësh mirë fiziologjinë e kësaj kulture. Gruri kalon fazën e jarovizimit në temperatura nën 15 gradë celsius, që quhet dhe stadi i temperaturave të ulta.

Qarkullimi bujqësor është shumë i rëndësishëm për të marrë rendimente të larta. Pas kulturave prashitëse si misër, patate, fasule, mund të shtohet prodhimi me 30 përqind, kur kushtet e tjera nuk ndryshojnë. Po nëse vazhdojmë të mbjellim grurë pas gruri, rendimenti do të ulet respektivisht me 15, 20 dhe 30 përqind, në vitin e tretë. Kjo ndodh, pasi kjo kulturë e shfrytëzon sipërfaqen aktive deri në 30 centimetra, duke e "lodhur " tokën. Mbjellja e përsëritur bën që të shfaqet ndryshku i grurit e një sërë sëmundjesh të tjera që ulin akoma më shumë rendimentin, e rrisin akoma më shumë koston e prodhimit, duke i luftuar ato. Do të ishte mirë që vetëm pas tre katër vjetësh, kjo kulturë të rimbillej në të njëjtën sipërfaqe toke.

Kullimi dhe vaditja janë dy faktorë që duhen marrë në konsideratë, por që në jo pak raste ata neglizhohen. Sidomos, në situata të nxehta, si vera e vitit të kaluar, vaditja ka qenë shumë e kërkuar. Ismail Karaj, Riza Balliu, Petrit Kryemadhi, Hazis Fisniku, Agron Sallai dhe ndonjë tjetër, arritën të marrin mbi 70 kuintalë për hektarë dhe padyshim, një efekt të mirë ka pasur realizimi i këtij procesi. Nevojat për ujë janë në të gjitha fazat, por pak më të mëdha do të ishin në kallëzim e formim kokrre. Por jo më pak i rëndësishëm është dhe kullimi. Hapja e vijave kryesore apo siç thirren krenare, në krye të parcelës, bëjnë një rritje të shëndetshme, shmangin asfiksinë, zverdhjen e bimës dhe për pasojë dhe pakësimin e barërave të këqia. Në një hektarë të mbjellë me grurë mund të hapim rreth 700 m linear vija kullimi. I përmendim këto, pasi të merr malli të shohësh ngastra të mbjella dhe fermeri të ketë hequr qoftë dhe një vijë të vetme kullimi apo vaditje.

Në qarkun e Dibrës, ka fshatra të thellë, malorë me rrugë të ngushta, dhe pamundësi për të shkuar kombajna për korrje, apo makineri të tjera. Kjo e vështirëson mjaft mekanizimin e proceseve, duke ndikuar për keq te rendimenti. Në dy ish komunat Qendër dhe Melan, rreth 35 përqind e sipërfaqes së mbjellë, korret me dorë e pastaj bëhet shirja me makinë. Kjo gjë, jo vetëm ka shtuar koston e prodhimit, ka shtuar firot nga shkërmoqja e grurit, por dhe e degjeneron gjithë procedurën në një rraskapitje totale. Në të tilla kushte, mbjellja e mëtejshme në vitet e tjera, mund të shikohet pa interes. Një pjesë fermerësh, sidomos të moshave të vjetra, mbjelljen e grurit, më shumë do ta bënin për forcë zakoni, apo thjeshtë për të siguruar kashtën e grurit, aq të nevojshme për blektorinë.

Qarku i Dibrës mbjell zakonisht një sipërfaqe prej rreth 3000 hektarësh. Të dhënat tregojnë se në vitet në vazhdim, sipërfaqja e mbjellë me këtë kulturë, po vjen në ulje të vazhdueshme, duke bërë një zbritje drastike me gati 1000 hektarë, në vitin aktual. Arsyet për këtë janë të shumta.

Po të bënim një analizë të thjeshtë ekonomike, apo konto të kësaj kulture, siç e quajnë specialistët në gjuhën teknike, rezulton se bilancet nuk janë shumë pozitive. Procese të tilla si plugimi, frezimi, mbjellja, korrja, shtuar këtu farën e grurit, nitratin e shpenzime të tjera, e çojnë në gati 25 lekë koston e një kilogrami grurë të prodhuar. Po të mendosh që mund të ketë vite me thatësirë dhe ujitja është e pamundur, bilanci i shpenzimit dhe fitimit, përmbyset në favor të grupit të parë.

Në mbjelljen e kësaj kulture, ashtu si dhe për shumë të tjera, respektimi i afateve, është vërtet shumë i rëndësishëm. Fillimi i tetorit, deri në mesin e muajit nëntor, do të ishte afati më ideal. Populli, shpesh përdor termin "struga", si të thuash pak a shumë afate. Struga të para, të dyta dhe struga të treta. Mbjellja para këtyre afateve do ta zhvillonte tepër bimën, me prirje për tu rrëzuar e për tu kalbur gjatë dimrit. Mbjellja më pas, pra pas fundit të nëntorit, do ta bënte bimën të paaftë për të kapur ritmin, e të futet e shëndetshme në temperatura të ulëta. Në dy komunat që përmendëm më sipër, Melan dhe Qendër, rreth 23 përqind e sipërfaqes u mboll në muajin dhjetor. Kjo do të ishte një goditje akoma pa u nisur, sikur gjithë vazhdimi të ishte perfekt.

Nuk do të ishte luks, por nevojë, deri në domosdoshmëri studimi i përmbajtes së tokës. Kjo do të vlente jo vetëm për grurin, por dhe për shumë kultura të tjera, mos themi për të gjitha. Duke ditur përqindjet dhe raportet e elementëve bazë, azot, fosfor, kalium, si dhe mikroelementet, ne do të dinim si të operojmë më tej, ç'farë duhet shtuar dhe sa. Sot analiza toke mund të bësh vetëm në laboratorin e Fushë Krujës, pra shumë larg mundësisë praktike të fermerit, duke e rënduar procesin në kohë, në para e plot pengesa të tjera burokratike. Bota e zhvilluar i mban në çanta dore, instrumenta të thjeshta që bëjnë analiza të tilla. Të vjen turp për shumë gjëra, ku kemi rënë shumë më poshtë se në kohën e komunizmit. E kishim laboratorin e tokave, nuk e kemi, e kishim laboratorin veterinar, nuk funksionon, e kishim sistemin e prognozës, nuk e kemi, e kishim me ujë fushën e begatë të Maqëllarës, është bërë shkretëtirë. Flasim për bujqësi intensive, kur në disa gjëra ecim në drejtim të kundërt. Irlanda e shumë shtete të tjerë marrin 10 kuintalë grurë për dynym, pra më shumë se dyfishin tonë, pikërisht se i vlerësojnë fort të gjitha hallkat agroteknike të kësaj kulture. Ata duan të punojnë, duan të ndërtojnë shtetin e jo të bëjnë retorika boshe siç bëjmë rëndom ne shqiptarët.

Mendoj se ka ardhur koha që të mblidhet një forum i qendrave të teknologjisë në shkallë kombëtare, i specialistëve më të mirë në shkallë vendi dhe të hartojnë një program i posaçëm për këtë kulturë. Të gjykojnë në ja vlen të mbillet në të ardhmen dhe të mbështetet me të gjitha mënyrat e mundshme, deri dhe me subvencione nga shteti, apo të lihet e të braktiset fare. Nëse ndodh kjo e dyta, fëmijët tanë do ta njohin këtë kulturë vetëm nga fotot e së kaluarës, duke thënë na ishte njëherë një kulturë që quhej grurë dhe dikur mbillej dhe në vendin tonë.



Në qarkun e Dibrës, ka fshatra të thellë, malorë me rrugë të ngushta, dhe pamundësi për të shkuar kombajna për korrje, apo makineri të tjera. Kjo e vështirëson mjaft mekanizimin e proceseve, duke ndikuar për keq te rendimenti. Në dy ish komunat Qendër dhe Melan, rreth 35 përqind e sipërfaqes së mbjellë, korret me dorë e pastaj bëhet shirja me makinë. Kjo gjë, jo vetëm ka shtuar koston e prodhimit, ka shtuar firot nga shkërmoqja e grurit, por dhe e degjeneron gjithë procedurën në një rraskapitje totale.

Rruga e Arbërit nr. 134

intervista

Intervistë, Eduard Ilnica fletë për karrierën e gjatë në gazetarinë sportive

Në Shqipëri gazetaria është një profesion i vështirë, të çfarëdo profili qofshin gazetarët, madje edhe për mua si gazetar sportiv. Por ndërkohë, të jep kënaqësi, kur publiku të dëgjon, të lexon apo të klikon. Ky është matësi për një gazetar. Natyrisht, shpesh ndeshemi edhe me kritika, pse jo, ka edhe fyerje apo edhe kërcënime, por këtu qëndron bukuria e këtij profesioni, duhet të dalësh mbi të gjitha dhe të vazhdosh të informosh publikun pa devijime.



Të rinjve u duhet guximi, iniciativa dhe një profesion

Nga **SAMET ZAGRADI**

- Për një publik më të gjerë, na fol pak kush është Eduard Ilnica?

Lindur dhe rritur në fshatin Burim të Maqellarës, nga dy prindër arsimtarë. Fëmijëria ishte si shumë bashkëmoshatarë, ku gjithçka lidhej me shkollën, për të mësuar shumë. Dhe mbaj mend që 8-vjeçaren e kam mbyllur me notën mesatare 10. Më doli një bursë asokohe (tekstil-trikotazh), por e refuzova dhe për pasojë, fillova gjimnazin në Maqellarë, një nga shkollat më të mira të Dibrës, ku kanë dalë shumë personalitete. Si shumë të rinj, jam marrë shumë me sport, futboll dhe volejboll, duke konkurruar në spartakiadat e asaj kohe. Kam qenë koleksionist i gazetës së sportit në atë kohë, ndërsa vetë bëja kalendarët e evenimenteve të rëndësishme sportive. Këtu si duket ka nisur edhe dëshira për t'u marrë me gazetari sportive. Pasi mbarova gjimnazin, konkurrova në Fakultetin e Histori Filologjisë, dega Gjeografi, ku zura vendin e tretë në rang kombëtar. Mbarova Universitetin në vitin e vështirë 1997 dhe m'u desh të emigroja si shumë të tjerë, që për mua ishte një shkollë më vete, pasi mësova edhe dy gjuhë të huaja, italisht dhe gjermanisht. Kthehem nga emigracioni në vitin 2000, më vonë krijoj familje, jam baba i dy fëmijëve.

- Si nisi karriera juaj dhe cilët ishin vështirësitë që ke hasur?

Në vitin 2001, së bashku me motrën time (edhe ajo gazetare), botojmë një libër, "Guida e Durrësit", e aty nis dëshira për të shkruar. Një shok i imi më thotë se është hapur një vend vakant te gazeta "Gazeta Shqiptare" në rubrikën e sportit, që ishte gazeta më cilësore në treg asokohe, një shkollë për shumë të rinj e të reja, pasi tregu mediatik kishte nisur shpërthimin, teksa ata që mbaronin shkollën nuk plotësonin dot nevojat. Muaji i pari ka qenë i vështirë, kisha tre gazetarë të njohur mbi kokë, duke filluar nga Carlo Bollino, Arjan Çani dhe Andi Tela, që publiku i njeh mirë tashmë. Mos harroni, nuk kishte internet si sot dhe as paketa sportive që mund t'i ndiqje ndeshjet në TV, kështu që bridhja në stadiume, në institucione dhe në mbrëmje duhet të bëja minimalisht 2 faqe gazetë. Njohja e gjuhës gjermane më dha shumë avantazh, sepse shumica e futbollistëve të Kombëtares shqiptare në atë kohë luanin

Pavarësisht ndryshimeve demografike, dibranët sërish mbeten punëtorë, patriotë dhe alegorikë. Fatkeqësisht, shumë pak të rinj sot e shohin jetën në vendin e tyre, shumica duan të largohen ose minimalisht të ikin nga Dibra dhe të jetojnë në Tiranë, jo për faj të tyre. Mesazhi im është i thjeshtë: Guxoni sa jeni të rinj, merrni iniciativa edhe në vendin tuaj, shfaqni ambicien për atë që keni dëshirë të bëheni, mundoheni patjetër të merrni një profesion, nuk ka rëndësi se çfarë, mjafton të ndiheni mirë në atë që bëni.

atje. Në vitin 2004 marr një ofertë nga "Sporti Shqiptar" dhe kaloj direkt redaktor përgjegjës. Në vitin 2009 kaloj në rolin e zv.kryeredaktorit, ndërsa vitin e fundit, para se të mbyllej kjo gazetë, isha kryeredaktor, që është edhe kulmi për një gazetar. Në 2013 nis një eksperiencë të re, kaloj në TV "News 24", por ndërkohë shkruaja sërish te "Gazeta Shqiptare" dhe nuk mungonin shkrimet edhe në "Balkanweb", portali i parë i hapur dhe një nga më të lexuarit në rajon. Rikthehem në gazetë në rolin e zv.kryeredaktorit (Sport Plus), por pa u shkëputur nga TV, kësaj here "Telesport", ku në fund isha drejtor informacioni. Tani kam nisur një projekt të ri dhe shkruaj për "Konica.al". Nisur nga eksperienca, shumë TV më ftojnë për të folur për sportin, duke analizuar dhe dhënë mendime.

- Si e përshkruani profesionin e gazetarit në Shqipëri? A jetohet me të?

Në Shqipëri gazetaria është një profesion i vështirë, të çfarëdo profili qofshin gazetarët, madje edhe për mua si gazetar sportiv. Por ndërkohë, të jep kënaqësi, kur publiku të dëgjon, të lexon apo të klikon. Ky është matësi për një gazetar. Natyrisht, shpesh ndeshemi edhe me kritika, pse jo, ka edhe fyerje apo edhe kërcënime, por këtu qëndron bukuria e këtij profesioni, duhet të dalësh mbi të gjitha dhe të vazhdosh të informosh publikun pa devijime. A jetohet me gazetari? Jetohet nëse punon mirë, bëhesh gazetar i mirë, në mënyrë që të të vlerësojnë punën, pra të shesësh emrin tënd në treg. Nëse bëhesh gazetar thjesht për të marrë një rrogë, atëherë natyrisht që si shumë shtresa të tjera të popullsisë do ta kesh të vështirë të kalosh muajin.

- Mendimi juaj për të rinjtë dibranë? Mesazhi juaj për ta?

Jam krenar që jam dibran dhe të rinjtë e sotëm duhet të jenë të tillë. Pavarësisht ndryshimeve demografike, dibranët sërish mbeten punëtorë, patriotë dhe alegorikë. Fatkeqësisht, shumë pak të rinj sot e shohin jetën në vendin e tyre, shumica duan të largohen ose minimalisht të ikin nga Dibra dhe të jetojnë në Tiranë, jo për faj të tyre. Mesazhi im është i thjeshtë: Guxoni sa jeni të rinj, merrni iniciativa edhe në vendin tuaj, shfaqni ambicien për atë që keni dëshirë të bëheni, mundoheni patjetër të merrni një profesion, nuk ka rëndësi se çfarë, mjafton të ndiheni mirë në atë që bëni. Dhe si dashamirës i sportit, mbështeteni Korabin, jo vetëm të futbollit, por edhe të volejbollit dhe disiplinave të tjera. Vetëm me mbështetjen tuaj sërish Korabi mund të jetë në elitë, pavarësisht vështirësive.

- Cila është lidhja juaj me Dibrën?

Me Dibrën me lidhin shumë gjëra. Unë kam ende shtëpinë në fshat, me një bahçe që shpresoj ta rindërtoj pas mbarimit të "Rrugës së Arbrit". Kam shumë shokë, kushërinj, të afërm, njëkohësisht edhe dy "mixha" në Peshkopi, Bajramin dhe Nazifin. Por lidhja më e fortë janë kujtimet e fëmijërisë, që sa herë shkoj, ndjej nostalgji. Së fundmi, besoj ju e dini që kam qenë i lidhur fort me ekipin e Korabit dhe kam dhënë kontributin tim për ta ringritur, do ta bëja sërish nëse do të ma kërkonin, ashtu si gjithnjë këto vite: falas.

- Si ndihesh të intervistohesh nga një gazetë e Dibrës dhe si i ri i suksesshëm?

Natyrisht që ndihem mirë. Një ide shumë e mirë, për të promovuar sa më shumë njerëz që kanë lidhje me Dibrën, në mënyrë që edhe ata të ndihen të detyruar të bëjnë diçka për vendlindjen tonë. Vetë kam shkruar disa herë te "Rruga e Arbërit", por emocion më vete të të intervistojnë dhe jo të intervistosh. I uroj suksese gazetës "Rruga e Arbërit" dhe ty Samet, por edhe gjithë dibranëve pa përjashtim. Zoti e bekoftë Dibrën time!



URIME STRAKA:

Besimi te vetja më ka sjellë suksesin

- Urime, ju jeni një nga zërat më të rinj të penës dibrane. Na fol pak për veten për një publik më të gjerë?

- Unë jam Urime Straka. Lindur më 8 prill 1995 në fshatin Cetush. Vij nga një familje e thjeshtë dhe që ka brenda një dashuri të madhe. Aktualisht po ndjek studimet e larta në degën e Psikologji-Sociologji. Pasioni im për librat dhe letërsinë lindi që në moshë fare të vogël ku u pikasa nga mësuesit më pas nga persona të tjerë të cilët më ndihmuan në konkretizoja në librin tim të parë krijimet dhe poezitë e mia. Libri i me titull "Qetësisht" ishte libri parë duke u pasuar më pas me dy libra të tjerë "Përtej ëndrrës" dhe "Trokas".

- Ti vjen nga një fshat i Dibrës. Sa e vështirë është që një vajzë nga fshati të ketë sukses?

- Është me të vërtetë e vështirë të thyesh tabutë dhe mentalitetin kaq të egër sidomos në qytetin e Dibrës. Pasi të kesh arritur të largohesh nga idetë e provincës është më e thjeshtë të ecësh përpara. Asgjë nuk është e thjeshtë në qoftë se nuk përpiqesh. Të gjithë duhet të dimë që ndryshimi vjen nga vetja.

- Kujt i je falënderuese për suksesin tënd Urime?

- Padyshim që familja është gjëja e parë që më ka ardhur në mendje. Ato kanë qenë dhe janë shtysa ime për çdo gjë. Të shumtë janë personat që më kanë qëndruar afër dhe që më kanë dhënë kurajo.

- Keni ju një mesazh për të rinjtë Dibranë?

- Unë jam pjesë e të rinjve dibranë dhe mendoj që ne kemi një fuqi të jashtëzakonshme. E pranoj që jetojmë në një mentalitet të egër por besimi në vetvete është arma kryesore e një suksesi. Besimi në vetvete është besimi më sublime i njeriut. Çdo lloj besimi tjetër është varësi dëshpëruese.

- Cilat janë planet e tua për të ardhmen?

- Aktualisht po punoj fort për një libër me terma psikologjik. Një libër që flet për motivimin dhe ngritjen shpirtërore. Mendoj që pas përfundimit të shkollimit tim të jem në fushën e biznesit, normalisht, pa u shkëputur nga letërsia dhe nga librat

Bisedoi: Samet Zagradi

shënime

Me Duli Demën në një bisedë në hapësirën e 26 viteve larg

Duli Dema nga Amerika dhe gjipset e virgjëra të Dibrës

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Për një çast ai emër në faqet e face-book-ut do të më kthente 26 vjet pas, në vitin 1991 kur në Shqipëri çdo gjë shkatërrohej kurse ai kërkonte të ngrinte një fabrikë për shfrytëzimin e një ndër pasurive më të mëdha në Dibër, gipset e alabastrat që shtrihen nga Kalaja e Dodës e përfundojnë tej kufirit shqiptaro-shqiptar, në Dibër të Madhe.

Kur pashë fytyrën e tij u befasove dhe në mëdyshje, pasi e bëra "shok" i shkrova:

Përshëndetje Duli. Në vitin 1991 kam takuar dhe biseduar me një person që ka emrin tuaj. E kam takuar tek turizmi i Peshkopisë ku më paraqiti një projekt për shfrytëzimin e gipseve dhe alabastrave të Dibrës. Asokohe bëra një shkrim për këtë, shkrim që e kam botuar dhe e kam edhe në arkivin tim. Unë jam Abdurahim Ashiku nga Brezhdani, gazetar që tash 21 vjet banoj në Athinë. Po qe se jeni ju do të desha të këmbejmë kujtimet, mbase ta ripërtërijmë bisedën e asaj kohe. Sidoqoftë ju uroj shën-det dhe gëzime.

E menjëhershme ishte përgjigja:

Shumë të faleminderit. Unë jam ai dhe momentalisht gjendem në Tiranë. Jam në disponimin e juej me u takue në çdo kohë

Të fala tëpërzemërta. Duli Dema.

U gëzova. U ndjeva mirë për kulturën e tij të komunikimit, kulturë e fisit të tij larguar (siç më shkruan më poshtë) para pesëdhjetë vjetësh dhe kulturën që kishte marrë në një vend demokratik si Amerika.

Kishte moshën time, një vit më i vogël. E shkruante gjuhën shqipe si të kishte mbaruar universitet në Shqipëri e si të kishte qenë gjithnjë në Dibër.

Vazhduam komunikimin atë ditë dhe në ditët e ardhshme...

A. Ashiku: Gëzohem jashtëzakonisht shumë. E kam ëndërr të takohem edhe një herë me ju. Unë ndodhem në Athinë dhe e kam të vështirë të vij para muajit gusht në Shqipëri. Po kërkoj shkrimin që kam bërë atëherë kur u takuam bashkë dhe do tua dërgoj.

D. Dema: Unë siguristë do te jem deri me 23 gusht. Po ta dish se ajo puna e Gipsit ne anën e Peshkopisë kërkon mjaft dollarë për tu ndertue...

Të fala të përzemërta.

A. Ashiku: E di i nderuar por mua më ka pëlqyer dashuria, gatishmëria juaj për të bërë diçka për Dibrën. Do të komunikojmë dhe shpresoj të takohemi.

D. Dema: Po ty nuk je i lirëpërkëtë se kjo asht nji projekt nobel dhe shumë i komplikuem dhe donëshumë para: Arapet thuejn "ishalla" eh me ate fjalëvetëm nji i dogmatizuem nuk han bukë në realitet. Unë jam i lirë me u takue sa ma shpejt.

A. Ashiku: Edhe unë dëshiroj të takohem sa më shpejt por jam larg dhe nuk më le puna. Megjithatë them se mund të takohemi kur të vij në fillim të gushtit.

Duli Dema: Në dashtë perëndia.

A. Ashiku: Pa tjetër që do të dojë. Respekt të lartë për ju. Kur të takohemi do të jap 6 librat e mi, njeri prej të cilëve ka titullin "PO DIBRËS ! JO SKAVICËS" ku kundërshtoj ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës që shuan përgjithmonë luginën e bukur të Drinit



Duli Dema

të Zi duke e mbytur atë në ujë.

D. Dema: Çfarë me ba. Kjo jetë asht me hile, ku dominojnëkriminelët sidomos ne vendin tonë.

A. Ashiku: Natën e mirë i nderuar. Do të komunikojmë vazhdimisht.

D. Dema: Natën e mirë.

A. Ashiku: Përshëndetje Duli Dema. E gjeta në arkiv dhe po jua dërgoj shkrimin tim rrjedhë e takimit me ju 26 vjet më parë...

DULI DEMA NGA AMERIKA DHE GIPSET E VIRGJËRA TË DIBRËS

Një pasuri e madhe që pret të shfrytëzohet.

E takova përpara turizmit, ulur në një karrige tek gjerbte kafe ekspres me një shokun tim. Fliste një dibrançe të pastër, të hareshme, me një theks paksa të dallueshëm amerikan.

Më tha se është nga fisi i Demeve të Shupenzës dhe quhej Duli.

Ishte vjeshtë e vitit 1992, fund shtatori...

Rrahëm kohën, tranzicionin, politikën. Unë i rezervuar, Ai pa dorashka. I kishte hedhur dorashkat tutje dhe me prakticitetin karakteristik amerikan më dilte në shtigjet e mija, në ato shtigje ku unë kisha kaluar duke "bërtitur", duke thirrur për të mos shkatërruar, për të mos mbyllur minierat e prerë pemëtoret, për të mos shembur fabrikat e mbyllur shkollat, për të parë përpara dhe jo prapa.

I fola për pasuritë e Dibrës, për të njohurat në shfrytëzim dhe të njohurat në potencë, për të nëntokës dhe të mbi tokës, për njerëzit e saj punë dashur.

Nuk e di por më duket se i kisha gjetur zemrën ndaj e pashë të ngrihej, të më kapte krahun e të më merrte në dhomën e tij në hotel. Më uli në kolltuk dhe në tavolinën e vogël më shprazi një çantë me disa dosje të vogla. Kapi njërën dhe e hapi me të shpejtë.

- Këtu, më tha ke projektin e një fabrike për përpunimin në cikël të mbyllur të gipseve. Edhe gazi që del nga djegia e gipsit nuk humbet por në një cikël të mbyllur kthehet në vlera materiale tepër të nevojshme.

I thashë se gipse-alabastrat në Dibër janë në rezerva të pambarueshme. I thashë se sikur tërë teknika moderne e shfrytëzimit të inerteve të Amerikës e të botës të vihej në shfrytëzimin e alabastrave të Dibrës edhe për njëmijë vjet nuk i mbaronte dot. I thashë se vetëm "maja e bishtit" të tyre (duke e përshkruar si një "kalë" 40 kilometra të gjatë me kokën në Kala të Dodës, trupin në Vranjt e majën e bishtit në Radikë të Dibrës së Madhe (në anën tjetër të kufirit zyrtar) është në shfrytëzim. Kombinati "Radika" i Dibrës së Madhe prej më se 30 vjetësh shfrytëzon këtë "bisht" pa arritur ti shkulë një "qime".

Ulur mbi projekt, midis vizash që flisnin për një dëshirë të madhe për t'iu qepur një pasurie të madhe, ndenjëm deri vonë.

U ndamë për tu takuar pas disa ditësh.

Më tha se kishte ndërmend të shkonte në Tiranë dhe të takohej me ministrin e ndërtimit. I thashë se kur të vinte do ta takoja me një mikun tim inxhinier specialist për gipse-alabastrat, aktualisht i papunë, i cili do ti jepte hollësi për gjithçka që i duhej...

Nuk u takuam më. Më thanë se pas takimit me ministrin ka ikur në Amerikë. Mendova se do të kthehej...

Nuk u kthye. Për katër vjet sa kanë kaluar që kur u njohëm, edhe sikur në këmbë të ishte nisur nga Amerika do të kishte arritur.

Megjithëse e marr me mend skenën me ministrin e ndërtimit përsëri pyes: Pse nuk erdhi Duli Dema në Peshkopi? Çfarë mali më të lartë se Korabi i ka vënë ministri që nuk e kaloi dot?

Pse nuk erdhe Duli Dema?

24.9.'96, Athinë

Duli Dema ka ardhur përsëri në Shqipëri. Ka ardhur me të njëjtën dashuri për Dibrën, për shfrytëzimin e burimeve të mëdha në nëntokës e mbitokës së saj, për ti dhënë asaj frymë nga fryma e tij dhe e të gjithë dibranëve larg tej Atlantikut.

Duli Dema erdhi në atdhe në kohë të vështira. Dje dhe sot...

Mundësia për ta përqafuar dhe për ta vënë në krye të një bisede të gjatë sa udhëtimi "Kala e Dodës-Dibër e Madhe" për një burim të madh pune e të ardhurash për Dibrën dhe Shqipërinë, u takon pushtetarëve.

Duli Dema: Zoti Ashiku, letrën e juej historike sa e lexova.Tëfaleminderit, por duhet ta dish se ato tëTiranës nuk deshën me dijt përprojekte Dibrane....

Kjo ishte arsyejaqëunë u solla në atëmënyrë, asht njësoj si puna e Rrugës së Arbrit. Në kohën tonë asht zorqë tëndërtohet...

Të fala te përzemërta.

Duli Dema ka ardhur përsëri në Shqipëri. Ka ardhur me të njëjtën dashuri për Dibrën, për shfrytëzimin e burimeve të mëdha në nëntokës e mbitokës së saj, për ti dhënë asaj frymë nga fryma e tij dhe e të gjithë dibranëve larg tej Atlantikut.

Duli Dema erdhi në atdhe në kohë të vështira. Dje dhe sot...

Do të doja ta pi një kafe me të, thjesht "kafe dibrane" me zemër në dorë. Kaq më mjafton se vetëm kaq mund të bëj.

Mundësia për ta përqafuar dhe për ta vënë në krye të një bisede të gjatë sa udhëtimi "Kala e Dodës-Dibër e Madhe" për një burim të madh pune e të ardhurash për Dibrën dhe Shqipërinë, u takon pushtetarëve.

Duli Dema ka ardhur në një kohë të vështirë, kohë zgjedhjesh, kohë riformime pushteti e shteti, kohë me porta zyrtarësh të lartë të mbyllura...

Duli Dema duhet takuar. Ka kohë deri më 23 gusht...

1991-2017

guidë

Tre ditë në bjeshkë: nga Ilnica në Radomirë



Teksti dhe fotot: **GREHANS UKA**

Endrit Shima nga kompania Zbulo. org më njofton për një tur katër ditor nëpër vargmalin Korab- Koritnik në data 17-20 qeshor. Piknisja do të ishte në Fshatin Pupinarë në zonën e Maqellarës dhe pika finale e mbërritjes që do të shoqëroja grupin ishte Fshati Radomirë. Gjithashtu, më informuan për përbërjen e grupit ishte Ervin Lani, guidë turistike nga Shkodra, Jim dhe Joe çifti nga Anglia si dhe Camel një studente nga Australia. Unë do isha në rolin e guidës lokale në Dibër ndërsa Ervini do t'i shoqëronte deri në Valbonë. Me të marr kontaktet e nevojshme, fillova përgatitjen e bazës material për ditët e turit.

Më datën 17 qershor në orën 8:30 të mëngjesit, në rrugën hyrëse të fshatit Obok, Pocest dhe Kërçisht takohem me grupin që vinte nga Fushë Bulqiza ku kishin kaluar natën. fillojmë rrugëtimin me makina drejt fshatit Pupinarë. Pasi lamë fshatin Obok u përballëm me një rrugë të ngushtë e të lodhshme, të cilën vështirësonte akoma më shumë mungesa asfaltit. Në fshatin Pupinar, si pika fillestare e turit, lartësia ishte 1100m metra mbi nivelin e detit. Në orën 09:00 fillojmë ngjitjen me këmbë drejt bjeshkëve të zonës me drejtim nga bjeshkët e fshatit Ilnicë.

Ngjitja filloi të dukej e lehtë sepse gjatë rrugës, përveç burimeve të shumta të ujit dhe pyjeve që krijonin një pyll të mahnitshëm, prapa krahëve tanë kishim edhe një pamje të mrekullueshme. Në horizont kishim malet që shërbejnë si kufij natyral për zonën e Dibrës, pastaj ishte fusha e Maqellarës që gjithmonë është përmendur për si një ndër zonat kryesore të bujqësisë. Në horizont dukej Dibra e Madhe dhe Radika që mbartin historinë dhe janë atraksione turistike interesante për tu vizituar.

E gjitha kjo pamje ishte shumë e qartë në lartësinë 1700 metra mbi nivelin e detit, që është mbi Gurin e Erebarës. Pasi ngjitemi në nivelin 1950 metra mbi nivelin e detit, për ne mbeteshin 2 opsione si ngjitja drejt majës së Velivarit (lartësia 2400 metra) ose të vazhdonim në atë lartësi me një kalim rrëzë majës Velivarit. Por preferuam ngjitjen drejt majës që të ndiheshim më të frymëzuar për arritjen tonë. Rreth orës 13:00 bëjmë pushimin e drekës pranë majës, ku diskutonim me miqtë dhe shijonim ndërkohë natyrën dhe peisazhin. Pamja që kishim para, na dukej akoma më qartë dhe më e bukur në atë lartësi ku ishim. Aty ishin bjeshkët e Erebarës, Herebelit dhe Grazhdanit.

Si një zonë kufitare, përveç staneve dukeshin qartë edhe gjurmët e postës verore të ushtrisë. Pasi lëmë këto Bjeshkë dhe duke kaluar tek Livadhet e thata takohemi dhe me një nga çobanët e zonës, Dirlon Gjonin. Ai na shoqëron deri në Kurrizoren e Trepçes (bjeshka e Trepçes) që shërben si pjesë ndarëse e bjeshkës së fshatit Ilnicë me bjeshkët që lamë pas. Çdo gjë aty dukej si në ballkon ku në horizont dukej Peshkopia por dhe fshatrat si Ilnica e Melani.

Dalëngadalë pas 8 orë rrugëtim zbresim tek stanet e Adi Fidës. Aty gjetëm mikëpritjen dhe dashamirësinë e të zotit të shtëpisë që na bëri të ndjehemi mirë. Madje për miqtë e huaj ishte me të vërtet kënaqësi, sepse përveç mikëpritjes dhe produkteve të zonës e kushteve të mira, u pëlqeu edhe bashkëpunimi im dhe i Ervint me të zotin e shtëpisë që gjithçka të ishte në mënyrën e duhur.

Data 18 qeshor ishte dita e dytë të turit. Nisjes e grupit u bë nga stanet në bjeshkës Ilnicës në lartësinë 1710 metra mbi nivelin e detit. Pasi hëngrëm mëngjesin dhe përshëndetëm të zotët e shtëpisë, nisëm ecjen në drejtim të fshatit Zagrad, që ishte destinacioni ynë i radhës.

Gradualisht ne fillojmë ngjitjen drejt pikës ndarëse mes bjeshkës së Ilnicës dhe Bjeshkëve të Randishtit dhe Zagradid. Në lartësinë 2078 metra mbi nivelin e Detit ishte pika kufitare me Rep. e Maqedonisë, njëkohësisht shërbente si rrugë drejt majës Velivarit, në të majtë ishte qyteti i Peshkopisë, fshtrat Rabdisht, Bellovë dhe Cerjan e në horizont dukej Lugina e Drinit të Zi.

Në krahun e djathtë të kësaj pike dukeshin bjeshkët në Maqedoni, dhe në horizont majat e maleve dhe kreshtat të mbuluara me pisha. Pra, kjo në një rrotullim 360 gradë të ofronte pamje të ndryshme dhe të frymëzonte maksimalisht. Duke vazhduar drejt vijës kufitare mes 2 shteteve kaluam në bjeshkën e Zagradid.

Të rrethuar nga një pyll dushku dhe pishe pas 4 orë ecje dhe 9 kilometrave të përshkuara bëjmë një ndalesë të shkurtër për tu frymëzuar nga mjedisi që na rrethonte. Pasi u mbushëm me energji pozitive akoma më





turizëm



Joe, çifti nga Anglia si dhe Camel një studente nga Australia shijuan për tre ditë me radhë bukuritë e bjeshkëve në Dibër. Ata u mahnitën jo vetëm nga natyra, por edhe nga takimet me banorët dhe shërbimet në shtëpitë pritëse në Ilnicë, Cerjan e Radomirë

shumë nga panorama rreth nesh, nisemi drejt fshatit Zagrad, tek shtëpia e Xhavit Fetës. Po ashtu edhe aty gjetëm një mikpritjen dhe ngrohtësinë e familjes duke treguar respekt për mikun sipas traditës dhe kulturës së zonës. Pas një pushimi të shkurtër në shtëpi bëjmë një vizitë të shkurtër në fshat ku grupit u bëri përshtypje arkitektura e shtëpive dhe historia që po u tregoja.

Gjithashtu, intersimi i banorëve dhe veçanërisht kureshtja e fëmijëve iu bëri përshtypje dhe në disa momente grupi u ndalua për të diskutuar me banorët, ku më interesant dhe gazmor ishte plaku Hajrulla Sefa me batutat e tij. Gjatë darkës patëm biseda të ngrohta me pjesëtarët e familjes, sidomos me të zotin e shtëpisë Xhavitin.

Me datën 19 lëmë fashtin Zagrad, ku na shoqëruan deri në dalje të fshatit djemtë e Xhavitit, Besmiri dhe Sajmiri. Nga niveli 1200 m ku ishte fshati ne marrim drejtimin për në bjeshkën e Zagradid që na zgjati rreth 40 minuta.

Në pjesën mbi stane drejtohemi drejt kufirit ndarës mes bjeshkës së Zagradit me atë të Cerjanit, ku ndodhej një qafë e pjerrët që për një pjesë të grupit e vështirësoi pak ecjen. Kjo gjë u favorizua nga një erë e fortë që na shoqëronte gjatë gjithë kohës. Megjithatë, ne arritëm që të ngjiteshim me sukses pas asnjë lloj problemi, duke kalaur në krahun tjetër të qafës. Me të vërtetë përjetuam në emocion të madh nga fakti që gjithë grupi kaloi me sukses dhe që arritëm të sfidonim pjerrësinë e qafës dhe erën pa menduar opsion tjetër. Dalëngadalë afrohemi drejt Gurit të Kuq, një pikë referimi për të gjithë banorët e asaj ane, dhe që shërbente si pikë kalimi për tu drejtuar drejt bjeshkës së Gramës. Pasi realizuam ngjitjen e kësaj pjesë bëjmë një pushim të shkurtër dreke për të rimarrë edhe pak energji. Na duheshin edhe gati 2 orë që të arrinim në bjeshkën e Derzës tek stanet e Xhemal Kaloshit.

Deri në destinacionin final të asaj dite pika më lartë e ngjitjes ishte 2334 m, ku dukej qartë në horizont maja Korabit bjeshka e Gramës, Derzës dhe e Zonjave ndërsa në të djathë dukeshin Peshkopia dhe fshatrat e Bellovës e Cerjanit si dhe Qyteza e Bellovës.

Gjatë rrugës për tek stanet takojmë Xhemali, personi që menaxhonte stacionin e qëndrimit për turistë. Pasi u rehatuam tek shtëpizat prej druri të përshtatura për turistë dhe pushimit të shkurtër shijuam kafen turke në natyrë nën blegërimat e deleve dhe fishkëllimat e çobanëve. Por akoma më bukur e bënte këtë kohë edhe freskia e ajri pastër i bjeshkës dhe lulet rreth e rrotull. Deri në përgatitjen e darkës shijuam peizazhin e mrekullueshëm, ndërthurjen e zhurmës së ujit pranë me blegërimat, ajri dhe freska, si dhe qetësia që mbizotëronte. Diskutonim me njëri-tjetrin dhe Xhemalin, bënim fotografi dhe mundoheshim të përfitojmë sa më shumë nga mjedisi sidomos në kohën e perëndimit të diellit. Edhe darka e përgatitur nga Xhemali, sipas mënyrës që përgatitej për çobanët, na pëlqeu nga thjeshtësia dhe afrimiteti që krijonte me grupin nën çatinë e çobanëve dhe rreth zjarrit.

Të nesërmen, 20 pas përgatitjes së çantave, rreth orës 09:00 lëmë stane dhe vazhdojmë rrugën drejt destinacionit të rradhës që ishte lagja Tez në fshatin Radomirë. Bëhej fjalë për rreth 14 kilometra larg nga pika nisjes, por na gëzonte fakti që nuk do kishim shumë ngjitje gjatë rrugës duke pasur një udhëtim më komod. Nisjen e filluam në nivelin 1860 m mbi det. Gjatë rrugës shikonim barinjtë e shumtë, një mjedis të mahnitshëm rreth e rrotull dhe gjithçka ishte e mbuluar nga ngjyrat e shumta luleve. Iu afruam edhe liqenit të Gramës që është rezervuari më i madh i ujit për këtë bjeshkë.

Aty bëmë një pushim të shkurtër ku Camel, vajza nga Australi preferoi të notonte aty. Në lartësinë 2051 m fillojmë duke lënë pas bjeshkën e Gramë (200 ha- sip.) dhe afrohemi drejtë bjeshkës së Shehit që është në pjesë e territorit të Radomirës.

Përveç postës verore që përdorej dikur nga ushtria dhe staneve ishte edhe rruga e makinave përdorur nga ushtria shqiptare. Ky element historik lidhet edhe me bunkierët e ndërtuar nga populli shqiptar por në këtë zonë disa kishin mbetur pa u dëmtuar. Duke iu afruar lagjes Stordok, që mbi të fillonte shtrirja e pishave, u ulëm të drekonim me ushqimet e marra me vete. Peisazhi me pisha mbi shkëmbinjtë gëlqeror e bënte më interesant këtë qëndrim. Në horizont dukej rruga Peshkopi- Kukës, lugina Drinit të Zi si dhe shumë fshatra rrëzë maleve.

Dalëngadalë afrohemi në lagjen Tez ku grupi do të qëndronte një natë. Tek Bujtina e Haxhi Himës na del përpara i biri Agroni që na mirëpret. Pasi grupi sistemohet nëpër dhoma, ulemi në lokalin e fshati dhe pimë kafenë e fundit, pasi misioni im i shoqërimit u mbyll aty dhe pjesa tjetër do të vazhdonte për me tej drejt Çajit dhe Shishtavecit të Kukësit.

Shkëmbyem kontaktet dhe mbresat për njëri tjetri. Grupi më shprehu dhe mbresat më pozitive për Dibrën, njerëzit dhe mjedisin.





Për një guidë turistike në Dibër kontakto me Gresin në email: udhëtomegresin@gmail.com. Telefon: (+355) 67 36 25 835 (What's App & Viber)

Laboratori klinik-biokimik i unifikuar pranë spitalit Peshkopi, falë kontributit të Shefqet Domit, u bë një nga laboratorët më të kualifikuar në Shqipëri. Tashmë ai mban emrin e Dr. Shefqet Domi. Është vendosur paanësisht emri i duhur në vendin e duhur. Dr. Shefqet Domi punoi në shërbim të njerëzve plot 70 vjet, ai jetoi një jetë si njeri, por si mjek jetoi dy jetë.

Shefqet Domi, "Ginesi" i mjekësisë shqiptare

Nga **Prof. As. NAZMI KOÇI**

Ideja e këtij shkrimi më kishte ardhur ditë më parë, kur një i njohuri im po më ankohej se vetëm për disa muaj mungesë vjetërsie pune në librezën e tij të punës, ai nuk kishte arritur të merrte pension të plotë pleqërie. Kisha dëgjuar më parë edhe të tjerë që ankohen se për pak muaj apo shumë pak vite pune nuk kishin arritur të sigurojnë pension të plotë apo qoftë edhe të pjesshëm pleqërie. Sigurisht ata janë në të drejtën e tyre dhe ankesën e tyre unë e konsideroj të drejtë. Por duke qenë se kam mil-ituar një kohë të gjatë në punë në shërbim ndaj njerëzve, herë si mjek i thjeshtë e herë drejtues në hallka të veçanta të shërbimit shëndetësor e të arsimit, më ka takuar të njoh dhjetëra raste edhe për të kundërtën e këtij fenomeni.

Mendja më shkoi menjëherë te një miku im i vjetër, Mjeku i nderuar Shefqet Domi, që u rrit e plak në sistemin e shëndetësisë dhe ishte në shërbim të njerëzve deri në javët e fundit të jetës së tij. Vendosa të shkruaja disa radhë për të, jo thjesht si mik, por si një margaritar që ishte mes nesh dhe jo të gjithë e vinin re. Kjo se ai vetëm punonte dhe nuk donte të dukej asnjëherë. Ka dhe shume arsye të tjera perse duhet folur për këtë njeri e profesionist shembullor. Ai që si një flori i hedhur në shesh dhe kalimtarët që shkojnë në punët e tyre as që e vënë re. Ndokush mund të përkulet dhe të marrë aty rrotull ndonjë copë gazetë pa vlerë e ta kundrojë me kuriozitet, por floriri mbetet aty në shesh. Kjo deri sa të dalë dielli dhe rrezet e tij të bien mbi të, pastaj ai bëhet i dukshëm, shkëlqen e u verbon sytë indiferenteve që kalojnë pranë tij. Sulen ta marrin , por ai u rrëshqet dhe tanimë bëhet njësh me baltën përjetësisht. Por shkëlqimi dhe vezullimi i tij mbeten aty përderisa dielli vazhdon të ndriçojë e të vezullojë mbi planet.

KUSH ISHTE DR. SHEFQET DOMI?

Shefqet Domi lindi me 5 Prill 1929, në Ceren, Kala e Dodës. Është djali i arsimdashësit Harun Domi, i cili pas viteve të emigracionit në Rumani, në vitin 1923 solli me vete abetare të gjuhës shqipe, me të cilat mësonin shkollat e para shqipe, të hapura në Kalis e në Ploshtan, të dy fshatra të Kalasë së Dodës, ku ai jepte vetë mësim.

Në vitin 1946, Shefqeti ka mbaruar kursin e parë të mikroskopistëve, për luftën kundër malaries dhe emërohet në Kukës me detyrë Përgjegjës i Dinspanserisë Antimalarike të qarkut Kukës që hapet e re. Aty krijon bërthamën e parë laboratorike të shëndetësisë për qarkun Kukës.

Në vitin 1947 mbaron kursin e dytë për laborant mikroskopist e transferohet në Tropojë. Në Tropojë hap dispanserinë antimalarike që ishte e dyta në Qarkun e Kukësit si dhe hap laboratorin e parë të spitalit Tropojë.

Në vitin 1949 transferohet në Peshkopi. Që nga ky vit deri në vitin 1995 shërbeu në Dibër. Në Peshkopi emërohet në dispanserinë anti-malarike ku punon deri në vitin 1954, duke dhënë kontributin e tij në luftën kundër malarjes edhe në këtë rreth, deri në zhdukjen e plotë të kësaj sëmundjeje..

Në vitin 1954 kryen kursin e plotë për analiza laboratorike e klinike dhe sëmundjet e gjakut dhe pas këtij kualifikimi, emërohet në spitalin e Peshkopisë. Me fillimin e punës në spital ai krijon laboratorin e spitalit dhe analizat



nuk dërgoheshin më jashtë rrethit (kryesisht në Tiranë) si më parë dhe gama e tyre u rrit në mënyrë të ndjeshme.

Me vullnetin që e karakterizonte ai kompletoi studimet, në fillim në Politeknikumin Mjekësor të Tiranës të cilin e përfundoi në vitin 1962 e u titullua N/ Mjek. Më pas studioi në Fakultetin e Mjekësisë dhe në vitin 1967 merr diplomën e mjekut, titullohet Mjek dhe kryen specializimin pasuniversitar për laboratorin klinik biokimik e bëhet specialist në këtë fushë. Tanimë Dr. Shefqeti emërohet mjek specialist në spitalin e Peshkopisë dhe shef i shërbimit laboratorik të spital-poliklinikës të rrethit Dibër. Punoi aty deri sa doli në pension. Ai i ngjiti shkallët në mënyrë të guximshme pa u lodhur e pa u ndalur, deri sa u ngjit deri në majën e piramidës së sistemit të shëndetësisë. Gjatë kësaj periudhe të gjatë punoi me të gjitha forcat në ruajtje të shëndetit të popullit. Dr. Shefqeti karakterizohej nga saktësia e lartë në analizat që kryente dhe nga profesionalizmi gjithashtu i lartë në interpretimin e tyre e në zgjidhjen e situatave të ndërlikuara klinike. Si mjek kontribuoi jo vetëm në spitalin e Peshkopisë por në periudha të ndryshme shërbeu me devotshmëri në zonat më të thella të rrethit Dibër.

Laboratori klinik-biokimik i unifikuar pranë spitalit Peshkopi, falë kontributit të tij, u bë një nga laboratorët më të kualifikuar në Shqipëri.

Dr. Shefqet Domi ishte nga të paktët, që në atë kohë porositi e solli nga jashtë, nëpërmjet bibliotekës së Peshkopisë, revista të huaja periodike shkencore mbi analizat dhe laboratorin, revista që gjenden edhe sot në fondin e bibliotekës Peshkopi. Ai shfrytëzonte literaturën në gjuhën ruse dhe angleze.

Gjatë gjithë kohës që punoi si mjek dhe drejtues në laboratorin e spitalit Peshkopi Ai organizonte e drejtonte rregullisht kurse periodike trajnimi e kualifikimi me punonjësit e laboratorit ku Ai vetë shpjegonte e praktikonte metodat e reja që jepte literatura botërore. Në saj të kualifikimit të Tij, trajnimeve që ai vetë kryente me personelin vartës, u bë e mundur që të aplikoheshin metoda të reja analizash që jo vetëm kishin saktësi më të lartë por edhe ishin më pak të kushtueshme. Puna e Tij krijuese shkencore e modernizimi i vazhdueshëm i laboratorit bënë të mundur të rritej ndjeshëm lloji i analizave që mund të bëheshin në laboratorin e spitalit. Kjo ishte një ndihmë e madhe për banorët e rrethit Dibër pasi u bë e mundur që pjesa më e madhe e analizave të bëhej në Peshkopi, duke ulur ndjeshëm numrin e pacientëve që dërgoheshin në Tiranë për ekzaminime laboratorike.

Dr. Shefqeti ngriti nga fillimi laboratorë në gjithë spitalet zonale të rrethit Dibër, për t'u ardhur në ndihmë mjekëve të zonave. Ai u kujdes e drejtoi vetë trajnimin e vazhdueshëm të personelit të tyre.

Ndërkohë që punonte, ai edhe eksploronte e studionte dhe kreu disa studime me vlere. Është autor i studimeve shkencore në fushën e mjekësisë, studime të prezantuara në konferenca të ndryshme kombëtare, një pjesë e të cilave janë botuar në revistat periodike mjekësore të kohës.

Përmendim studimin mbi "Ushqyerja e popullatës në Lurë e Dohoshisht", studim i bërë me vëzhgime direkte në terren, vizita, analiza e kontrolle të ndryshme mjekësore të banorëve; studimin mbi "Sëmundshmëria në çerdhe, kopshte e shkollat e qytetit Peshkopi"; studimin mbi "Normat kliniko-biokimike të popullatës të rrethit Dibër".

Për 15 vjet ka dhënë mësim në shkollën e mesme mjekësore të infermieri - mamive në Peshkopi, duke kontribuar në përgatitjen e gjeneratave të tëra të infermierëve dhe mamive në rrethin e Dibrës.

Në vitet 1991–1993 ka qenë Kryetar i Kryqit të Kuq të rrethit Dibër dhe anëtar i Këshillit Qendror të Kryqit të Kuq Shqiptar (krahas detyrës që kishte në spital), ku kryetar ishte i nderuari Dr. Ciril Pistoli, njëri nga figurat më të spikatura të mjekësisë shqiptare.

Në vitin 1995 pas daljes në pension vendoset me banim në Tiranë. Në vitet 1995 - 1996 punoi si mjek në klinikën mjekësore private "Jeta", në Tiranë. Në vitin 1997, ngriti qendrën e Tij mjekësore laboratorike "Domi". Laboratori i Tij u bë shumë shpejt i njohur e i kërkuar nga banorët e Tiranës dhe veçanërisht prej Dibranëve me banim në Tiranë. Këtu shërbeu deri sa u nda nga jeta në vitin 2016, duke mbushur 70 vjet me bluzë të bardhë në ruajtje të shëndetit të popullatës. Ai e mbajti bluzën e bardhë vërtetë të bardhë.

Arritjet e Tij shkencore, kontributi i Tij në ruajtjen e shëndetit, meritat e Tij në ngritjen e nivelit shkencor e modernizimin e shërbimit laboratorik, vlerat e Tij si njeri i thjeshtë, i palodhur e i përkushtuar në shërbimin ndaj të sëmurit janë vënë re e vlerësuar nga shoqëria, pushteti dhe media.

Dr. Shefqet Domi është dekoruar dy herë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të Shqipërisë. Në vitin 1955 dhe në vitin 1967,



Mjekët e shërbimit laboratorik "Dr. Shefqet Domi" në spitalit rajonal të Peshkopisë



Dr. Shefqet Domi

me motivacionin: "Punëtor i palodhur dhe i ndërgjegjshëm në kryerjen e detyrës. Ka treguar kujdes për t'i shërbyer sa më mirë popullit dhe të sëmurëve. Është treguar i gatshëm në çdo rast duke ndihmuar për mbrojtjen dhe forcimin e shëndetit të popullit".

Në vitin 1995 dekorohet nga presidenti i Republikës me urdhrin "Për shërbim të mirë popullit".

Gazeta e rrethit Dibër "Ushtima e Maleve" i ka kushtuar artikullin me titull "Mjeku me vite pune sa mosha e laboratorit".

Kinostudio "Shqipëria e Re" i ka kushtuar kinoditarin nr. 4, në vitin 1982, film dokumentar që është shfaqur në të gjitha kinematë e Shqipërisë. Ky dokumentar evidentonte punën e pakursyer, kualifikimin e lartë shkencor dhe arritjet e Tij në futjen e metodave të reja për kryerjen e analizave, metoda që jo vetëm ishin moderne, më të sakta e më ekonomike, por në to kishte dhe anën krijuese të Dr. Shefqet Domi për t'i përshtatur ato metoda me bazën materiale dhe instrumentale që dispononte laboratori.

Dr. Shefqet Domin kam patur rastin ta njoh që në shtatorin e largët të vitit 1960 në Politeknikumin Mjekësor të Tiranës ku unë vajta për të studiuar në mjekësi. Unë isha thuajse fëmijë, vetëm 13 vjeç, ndërsa ai burrë i pjekur e i formuar. Vinim nga maje malesh, ai nga rrëza e Korabit e unë pranë malit të Kaptinës, por të dy ishim dibranë e nuk na bashkonte vetëm origjina. Na bashkonte më shumë dëshira për të studiuar sa më mirë e thellësisht mjekësinë së cilës do t'i kushtonim jetën. Kishim edhe shumë dibranë të tjerë aty si Qemal Cadri, Xhavit Myftari, Kadri Puca, Selami Nazifi , Arif Hasani e plot të tjerë.

Dr Shefqet Domi I kishte marrë kontaktet e para me shërbimin shëndetësor që në vitin 1946, kishte kryer disa kurse kualifikimi dhe po ashtu shërbimin detyrueshëm ushtarak gjatë të cilit pat ushtruar detyrën e infermierit. Në fillimet e kësaj njohjeje me impresionoi jo vetëm serioziteti e përkushtimi për detyrën që na priste, por dhe qëndrimi i tij i prerë për të mos pranuar asnjë lëshim apo favor që si rregull u bëhej atyre që vinin nga terreni në atë kohë. Unë kam ardhur të studioj dhe nuk pranoj asnjë favor, ky ishte qëndrimi i tij i prerë që e bëri të njohur e të respektuar nga të gjithë në. Bashkë ishim në shkollën e mesme dhe në atë të lartë, ai gjithmonë dy vite përpara dhe shembull pozitiv për ne që vinim pas. Ishim bashkë në Lurë dhe zona të tjera në përbërje të ekipeve mjekësore, bashkë në aksione, bashkë kur u ndërtua Kameni, kur u inaugurua spitali i Peshkopisë, po ishim bashkë. Unë u largova jo pak vite nga Peshkopia, por kur u ktheva ne

(Vijon në faqen 15)

veprimtari



110 vjet nga themelimi i klubit **“Bashkimi Dibran”**

Me rastin e 110 vjetorit të krijimit të klubit patriotik: “Bashkimi Dibran”, në qytetin e Dibrës së Madhe, në vitin 1907, u realizua në Tiranë një aktivitet jubilar, mes shoqatës “Bashkësia Dibrane” në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave në Tiranë.

Krahas të ftuarve, ishin të pranishëm përfaqësues nga komuniteti dibran në Tiranë, përfaqësues nga jeta akademike dhe universitare, studiues, gazetarë dhe intelektualë. Nderonte me pjesëmarrjen e tij, në aktivitet Presidenti i Republikës, shk. Tij., z. Bujar Nishani;

Pas fjalës së hapjes së konferencës shkencore dhe himnit të flamurit, fjalën e mori kryetari i Shoqatës “Bashkësia Dibrane”, z. Bujar Kapexhiu, i cili në fjalën e tij evidentoi aktivitetet më të suksesshme të shoqatës, objektivat dhe programin e veprimtarive të saj në vazhdim.

Më pas për të pranishmit u shfaq një dokumentar insert, i cili tregonte për rrugëtimin historik nga klubi patriotik, bashkimi dibrane, tek djelmënia dibrane, e deri me sot tek shoqata “Bashkësia Dibrane”; Dokumentari insert, tregonte sesi lindi kjo shoqatë, kush ishin figurat kombëtare që e përbënin atë, vlerat dhe program i saj.

U evidentuan grupet intelektuale që e përbënin atë. U kujtuan figurat e para të këtij, klubi si, Hafëz Sherif Langu, Said Najdeni, Josif Bageri, Jashar Erebara, Izet Shatku etj, Ibrahim Jegeni.

Më pas u bë përshëndetje nga përfaqësuesi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, nga studiuesi dhe historiani prof. dr. Beqir Meta, i cili mbajti kumtesën me temë: Kontributi i personaliteteve dibranë për shtetndërtim kombëtar Shqiptar, në vitet 1920-1930; Ai në fjalën e tij, vlerësoi rolin dhe filozofinë e personaliteti të Vehbi Dibrës, si kryetar i senatit, Jashar Erebarës, Fiqiri Dines, Hafiz Xhemal Mullahit, dhe të dy ministrave të sukseshëm dibrane të Abdurrahman Dibrës, si ministër i Arsimit dhe të Faik Shatkut, si zv/kryeministër dhe Ministër i Drejtësisë; më pas foli prof. dr. Bajram Xhafa;

Me pas u fol për vlerat dhe fitoren mbi lumin Radika:

Studiuesit Inxh. Tofik Jegeni, Prof. Dr. Molnar Kolaneci, Dr. Saimir Shatku, gjatë vizitave në Dibrën e Madhe për Rrugën e Arbërit në vitin 2012 u njohën gjatë bisedave me kryetarin e Bashkisë Argëtim Fidën dhe Ruzhdi Latës me projektet e Lukovo-Poles dhe Bosko Mostit e sidomos me atë të parin që planifikonte të merrte edhe më shumë ujë nga Radika për ta dërguar drejt sistemit energjetik të Mavrovës dhe më pas në Lumin e Vardar për t’u derdhur në detin Egje. Dibrës po i bëhej me hile duke i marrë ujin dhe duke e derdhur gjetiu duke rrezikuar liqenin e Dibrës dhe sasinë e ujit që u duhet bujqve për vaditje, në kundërshtim të plotë me aktet ndërkombëtare dhe konventat në fuqi;

Pala Maqedonase pretendonte se nuk e kemi marre sasinë e ujin sipas marrëveshjes (Shqiptaro Jugosllave për ujërat kufitare) prej 9 m3/sek por kemi marrë vetëm 4.5 m3/sek. Ndërsa e vërteta qëndronte krejt ndryshe, pasi ata e kishin marrë 9 m3/sek që në vitin 1948 kur kanë ndërtuar kaskadën e hidrocentralit të Mavrovës.

Nga fundi i vitit 2013 dhe 2014 opinioni publik Shqiptar u njoftua për këtë problem ndërsa në Maqedoni kishte kohë që protestohej nga trupa të ndryshme ambientalistësh.

Pozicioni tona si inxhinier ujërash dhe jurist për të drejtat ndërkombëtare për ujërat kufitar luajti një rol të rëndësishëm në debatin që në mes Shqiptarëve njihet si “Çështja Radika”.

Si ekspert bazuar në të dhënat hidrologjike të cilat i siguruan dhe Instituti Hidrometereologjik i Beogradit në Serbi dhe në bazë të materialit arkivuar të Ministrisë së Jashtme Shqiptare pala Maqedonase ka marrë 9 m3 /sek.

Më 9 qershor 2015, BERZH vendosi të pranojë rekomandimin e Komitetit Drejtues të Konventës së Bernës për të mos financuar projektet hidrologjike në parkun e Mavrovës për rreziqet ekologjike që paraqesin.

Rekomandimet e Komiteti të Konventës së Bernës janë konfirmim i plotë i kauzës së drejtë të organizatave ambientalistëve të Maqedonisë dhe Shqipërisë si dhe Ndërkombetar i banorëve të komunave të prekura nga projektet si dhe rekomandimi i tre autorëve të studimit z. Jegeni, z. Kolaneci, z. Shatku, ku gjatë gjithë kohës kanë argumentuar efektet negative mbi faunën, florën dhe biodiversitetin kundër këtyre projekteve;

Nuk duhet harruar roli dhe kontributi i sa e sa dibranë, brenda dhe jashtë vendit, e sidomos në diasporë, që kanë lobuar dhe vazhdojnë të lobojnë për dy aspekte mjaft të rëndësishme të dibranëve; ruajtjen e traditave të tyre, si dhe kërkesa që kanë ndaj çdo qeverie për ndërtimin me procedura të përshpejtuara të Rrugës së Arbërit, e cila lidh Tiranën me qytetin e Dibrës së Madhe, për jo më shumë se 73 kilometra, apo 50 minuta;

Më pas foli kryetari i shtetit, Presidenti i Republikës, i cili falënderoj organizatorët për ftesën në konferencë; ai në fjalën e tij theksoi vlerat e Dibrës dhe dibraneve, si ruajtës të zakoneve, traditave, dhe faktor unifikues dhe pranues të të tjerëve. Më pas Presidenti i Republikës, dekoroi një sërë figurash dhe personalitetesh të klubit “Bashkimi Dibran”, e të komunitetit dibran në Tiranë;

U dekretuan nga Presidenti Bujar Nishani, me urdhrin: “Nderi i Kombit” këto figura:

1. JOSIF BAGERI
2. SAID NAJDENI (HOXHE VOKRRI/ VOKA)
3. HAFËS SHERIF LANGU
4. JASHAR EREBARA
5. IZET SHATKU DIBRA;

U dekoruan nga Presidenti i Republikës me Urdhrin “Mjeshtër i Madh” këta personalitete:

ADIVIJE SHAROFI (ALIBALI)
TOFIK JEGENI
ARIAN KADIU
MUKADES EREBARA (SHAQIRI)
SAIMIR SHATKU

Si dhe znj. Ermira Pirdeni, me urdhrin: “Për Merita të Veçanta Civile”; si kontributore prej mëse 20 vitesh, në aktivitetet e shoqërisë civile, dhe të Lëvizjes së Gruas në Shoqëri dhe të Moshimit Aktiv;

Ndërsa në mbrëmje aktiviteti i shoqatës në bashkëpunim me komunitetin dibran në Tiranë, varjoi me organizimin e darkën, iftarin tradicional nga ana e organizatorëve ku ishin shumë të ftuar dhe pjesëmarrës.

Përgatiti: **SAJMIR SHATKU**

Shefqet Domi,“Ginesi” i mjekësisë shqiptare

(Vijon nga faqja 14)

ishim përsëri bashkë. Ishte nga ata që më uroi me atë sinqeritetin që e karakterizonte dhe vazhduam përsëri të punonim bashkë. Kur Dr. Ciril Pistoli më kërkoi një njeri të mirë që ta bënte Kryetar të Kryqit të Kuq, pa u menduar fare i rekomandova Dr. Shefqet Domin, shoqëria e tyre e mëparshme u forcua më shumë përmes punës, ishin prerje të një kallëpi.

Bashkë punuam edhe në Tirane, ai u orientua shumë shpejt me ndryshimet që ndodhën, u organizua përsëri edhe pse doli në pension dhe vazhdoi t’u shërbente njerëzve deri në ditët e fundit të jetës së tij. U bë i njohur , i respektuar siç e meritonte dhe e kaloi me mjaft sukses testin e Tiranës, në mënyrën më të mirë të mundshme (mjerisht nuk ka ndodhur me të gjithë kështu).

Do të isha jo i plotë në vlerësimin e tij nëse nuk prek pak edhe aspektin e tij si njeri, si qytetar, si familjar. Dr. Shefqeti krijoi një familje për t’u marrë shembull. Së bashku me bashkëshorten e tij, Zemriten, rritën e edukuan tre djem njëri më i mirë se tjetri, nga ata që populli dikur thoshte se këta nuk vriten as për gjak. Naimi, Nuriu dhe Përparimi u rritën dhe studiuan shumë mirë, si i ati. Për një rast si ky Gjergj Fishta pat shkruar: Bajm babë se të ngjas (ngjasoj) / Dhe nji pllambë ta përshqas (kaloj).

I pari, Naimi, është një inxhinier i zoti, punonjës në një nga institucionet më të rëndësishme të profilit të tij në Tirane, pedagog në Fakultetin e inxhinierisë të Universitetit Politeknik, i dyti, Nuriu, një diplomat karriere, përfaqësues i Republikës së Shqipërisë në Egjipt, tani së fundi në Brazil dhe i treti, Përparimi, ekonomist i lartë, aktualisht një biznesmen i suksesshëm në Tirane. Në mos me këtë kut me çfarë tjetër mund të matet jeta dhe kontributi i një njeriu. Me vjen ndërmend në këtë rast dedikimi i dikujt që shkruante: Në këtë jetë jetojmë, punojmë, / vetëm sa hedhim ca hapa / por puna është si na kujtojnë / dhe ç’farë emri lëmë nga prapa.

Ai njeri aq korrekt e skrupuloz ishte njëherazi i dashur, i ngrohtë dhe i dhimbshëm. Ai priste, përcillte, strehonte ,vizitonte e mjekonte ata njerëz që kishin nevoje, veçanërisht për shërbim shëndetësor. Në shtëpinë e tij hahej buka e pihej kafeja me lezet si në Kalanë e Dodës nga vinte. E donte me shpirt vendlindjen e tij, Kalanë. Ka shkruar libra e artikuj dhe ka afirmuar si rrallë kush vlerat e Kalasë së Dodës. Pati meritën që më bëri dhe mua mik të Kalasë ku shkova disa herë dhe mund të deklaroj i bindur se në mos më e mira është një nga krahinat me kulturë jetese më të mirë në të gjithë Dibrën. Me njohu me vëllezërit e tij, njëri prej të cilëve, mësuesi veteran Xhemal Domi, i ka lënë një testament të shkruar në tre vëllime arsimit dibran. Xhemali ka shkruar për arsimtarët e Dibrës, por unë nuk e di sa të tjerët kanë shkruar për të. Më njohu dhe me Tajarin, Resulin dhe shumë të tjerë. Këto konstatime e vlerësime pozitive për të i kisha thënë herët që vitet e largëta 80 të shekullit të kaluar kur punonim bashkë në Dibër, bile në mjaft raste në mungesë të tij. Ja pse ai e gëzonte dhe gëzon respektin dhe vlerësimin tim të pa diskutueshëm.

Këto ditë në Peshkopi u zhvillua një ceremoni jo e zakonte në spitalin e Peshkopisë. Autoritet përkatëse kishin vendosur që laboratorit klinik biokimik të spitalit t’i vendosej emri i themeluesit të tij, Dr. Shefqet Domi. Më ftuan dhe mua të flas në atë aktivitet. I pa përgatitur, por gjithmonë i gatshëm, u thashë të pranishmëve se është vendosur paanësisht emri i duhur në vendin e duhur. U thashë se kjo i bën nder shërbimit në fjalë, se ne kolegët dhe familjarët e tij duhet të krenohemi me të, ndërsa personeli duhet ta mbajë lart emrin e nderuar qe i kanë vendosur institucionit të tyre. Ai punoi në shërbim të njerëzve plot 70 vjet, ai jetoi një jetë si njeri, por si mjek jetoi dy jetë. Kjo ishte arsyeja pse i rekomandova djalit të tij, Nuriut, i cili na ka lënë një libër autoritar mbi nobelistët e shekullit, që të shqyrtonte dhe rekordet Gines në shëndetësi dhe atëherë me siguri ne do të kemi Ginesin tonë të mjekësisë shqiptare me një rekord të pa konkurrueshëm. Portreti dhe emri i tij janë tani të skalitura në mermer dhe qëndrojnë në hyrje të laboratorit që ai krijoi e drejtoi për 70 vjet. Po, atij nuk i mjaftuan 70 vjet. Ai do të qëndrojë aty duke pritur e përcjellë nevojtarët përjetësisht, ndërsa ne do të na udhëheqë shembulli i tij i mirë, kujtimi i tij. Njerëz të tillë nuk vdesin kurrë sepse rron emri dhe vepra e tyre. Shefqet Domi është aty.

Rruga e Arbërit nr. 134

arsim

Kahreman Ylli, nga Franca në Peshkopi, si zëvendësdrejtori i shkollës që nuk u hap kurrë

Nga **PETRIT MYFTIU**

FILLIMI I PUNËS NË ARSIM ZËVENDËSDREJTOR NË PESHKOPI

Me përfundimin e studimeve në Lion të Francës, Kahremanin e emërojnë zëvendësdrejtor të Shkollës së Punës, në Peshkopi.

"Kthehem në Shqipëri në verën e vitit 1938, - shkruan Kahremani në autobiografinë e tij, në korrik të vitit 1945. – Nuk kam kontakte, veçse me shokë të njohur më parë, nuk njoh grupet, njerëzit e këtyre grupeve dhe punën e tyre. Nga Lioni nuk m'u dha ndonjë lidhje dhe as që m'u ngarkua gjë. Mbas dy muajsh më dërguan në Peshkopi, si zëvendësdrejtor i Shkollës së Punës. Atje isha mjaft i izoluar dhe bisedat politike bëheshin me grupe të vegjël shokësh, por pa nxjerrë gjë në shesh. Më 7 prill marr pjesë në manifestimin antifashist dhe së bashku me disa elemente të tjerë bëjmë presion mbi Prefektin për të na dhënë armë, por pa rezultat... Si gjithë nëpunësit e tjerë kam nënshkruar formularin ose lutjen për në Partinë Fashiste, por nuk më është dhënë dhe nuk kam mbajtur ndonjëherë distiktive...".

Djaloshit iu duk shumë i largët qyteti i Peshkopisë.

"Megjithëse zura miq e bëra përpjekje që të mos më degdisnin larg, - shkruan në kujtimet e veta Kahremani, - nuk qe e mundur. Në tetor të vitit 1938, më dërguan në Peshkopi, si zëvendësdrejtor të një shkolle 2-vjeçare të punës, që s'kishte as ndërtesë, as nxënës. Kur u nisa, nga Ministria e Arsimit, më dhanë një regjistër për nxënësit dhe një libër protokolli për shkresat. Ajo që më vlejti më shumë, - bën humor Kahremani, - ishte një shishe me solucion për të prishur fjalët e shkruara gabim. Të tërë shishen e harxhova se nuk dija të regjistroja shkresat, që hynin e dilnin për në ministri...".


... DREJT HAPJES SË KONVIKTIT

Kishte disa muaj që Kahremani jetonte në Peshkopi. E patën dërguar ata të Ministrisë së Arsimit që të bënte çmos për të hapur shkollën e Punës. Urdhri i kësaj ministrie u kishte shkuar më parë organeve drejtuese të pushtetit lokal. Por për zbatimin e tij, për hapjen e shkollës, deri ato ditë nuk ishte bërë asgjë. Duke qenë se në atë shkollë do të vinin djem e vajza nga fshatrat e Perfekturës, domosdo fillimisht, duhej të caktohej konvikti, ku nxënësit do të banonin.

Pikërisht që këndej filloi punën Kahreman Ylli. Po atij iu desh të rropatej me ditë e muaj të tërë. Halli ishte të gjendej një ndërtesë dykatëshe, e përshtatshme për konvikt, por si i bëhej me drejtuesit e Prefekturës që nuk ishin darkod për një shkollë të Punës. Ngado, dhe në zyrat e Prefekturës, flitej se ç'u thoshte mendja atyre të ministrisë, mos vallë djemtë e vajzat tona, për t'u bërë bujq e bujkesha, u dashka të bëjnë shkollë?! Hajde, hajde, ç'u pjell mendja! Po vallë, gjyshërit e baballarët tanë, që janë me nam në punët e bujqësisë e të blegtorisë, kanë mbaruar shkolla? Jo, more, jo! Këto zanate s'mësohen me libra, por atje në ara, duke lëruar tokën e duke mbjellë, si dhe në stane, duke kullotur kopenë e deleve e të dhive, duke mjelur qumështin e duke siguruar djathin e gjalpin... U dashka shkolla, hëm, humbje kohe!

Me këto mundësi iu desh të përplasej Kahrem Ylli, i ardhur nga Franca. Siguroi vetëm konviktin, dhe këtë, jo në qytet, por në një fshat pranë. Ndërtesa u ble nga Prefektura. Kahremani çoi teshat e fjetjes në konvikt, ku zuri një dhomë.

Për të ardhur nxënës nga fshatrat dhe nga qyteti, ishte krejt e pamundur. Kuadrot e Prefekturës, te fshatarët që vinin për Pazar në qytetin e Peshkopisë, kishin ngulitur bindjet e tyre, se për çdo të ri e të re ishte më mirë të rrinte i paarsimuar, se sa të shkonte në shkollë bujqësore.



Kopertina e librit

Kahreman Ylli mori rrugën i vetëm në këmbë, në fshatrat më të afërm, për t'u njohur me njerëzit e për të biseduar me prindërit. E vërteta ishte se midis prindërve kishte nga ata që ishin gati t'i dërgonin fëmijët në shkollën bujqësore, por ndjeheshin të rezervuar. "Fëmijët le të vijnë në shkollë, le t'u hapen sytë, pa dhe le të njihen, se punët e bujqësisë sot i kemi mbi supe ne të rriturit, ka kohë për të rinjtë!"

Vajtjet-ardhjet nga njëri fshat në tjetrin, afrimi e kuvendimi me njëri-tjetrin, e bënë Kahreman Yllin një intelektual të dashur e të respektuar. Shpesh ata merrnin rrugën për në qytet e shkonin drejt e në konvikt, uleshin e qanin hallet me profesorin e ardhur nga Franca, që ishte i thjeshtë e zemërbardhë.

NJOHJA ME ASIM GJERGJIN

Në kafenenë e qytetit, Kahremani ulej shpesh me Asim Gjergjin. Ish një burrë rreth të shtatëdhjetave. Kishte afri me nja dy nëpunës të Prefekturës. Asimi kishte qenë emigrant në Turqi e në Itali. Ishte kthyer, për të mos shkuar më, pas një aksidenti automobilistik. Ecte me një shkop dhe çalonte nga këmba e djathtë.

Kishte mësuar se kahremani vinte nga Franca, për të çelur shkollën Bujqësore dhe si antizogist që ishte, iu afrua profesorit dhe shpejt u miqësuan. E ftoi për darkë në shtëpi, ku kish gruan, djalin e martuar, Samiun, nusen e tij dhe tre vajza të vogla.

- Profesor, - iu drejtua Arsimi, Kahremanit, atë natë të ftohtë marsi.

- Urdhëro, dajë Asimi – ia ktheu ai.

- Dje mbrëma dëgjova Italinë në radio. Që kur ka ardhur në krye Viktor Emanueli, vendi po rrezikon paqen. Fjala "luftë" bubullon në zyra e në sheshe. Ne e kemi mbretin, kemi ushtri, po unë s'i besoj as njërit, as tjetrës...

- Besimin duhet ta kemi vetëm tek populli, o dajë Asimi.

Biseda rrodhi shtruar, megjithëse që të dy e ndjenin rrezikun e një agresioni. I zoti i shtëpisë, atë ditë e kishte porositur të birin, Samiun, të nxirrte nga hatllat të dy pushkët e t'i pastronte.

- Populli e do dikë në krye, o profesor. Kush do ta prijë popullin?

Kahremani mendonte se i moshuari shqetësimin e kishte të drejtë, po si të mos e lëndonte? I foli për Ismail Qemalin, për Isa Buletinin e për Bajram Currin, vetëm e vetëm që shpirti i atdhetarisë të ringjallej tek patrioti Asim Gjergji.

- E, dajë Asimi? Asnjërin nga këta të tre, ne nuk i patëm njohur më parë, por këta ishin që u bashkuan, dolën në krye të forcave popullore dhe si dihet bënë historinë, nderuan Atdheun!

- Ashtu qoftë! – foli Asimi dhe mori frymë thellë.

I biri, Samiu, kur vonë në mesnatë miku u ngrit për të ikur, me porosinë e të atit, e përcolli Kahremanin deri në Konvikt.

DREJT DEMONSTRIMIT MË 7 PRILL 1939

Çuditërisht atë natë atë nuk po e zinte gjumi. Ku nuk i shkonte mendja? Nga Leshnja në Vërzhezhë, nga Normalja në Lyon... Iu kujtuan me radhë shokët e Lyonit: Ymeri, Kozmai, Gogua. Për kthimin në Shqipëri Kahremani kishte biseduar me të gjithë këta, asnjë vërtetim për anëtarësinë në celulë, asnjë letër rekomandimi për ndonjë shok, kur të kthehej...

Në këto e sipër iu bë se dëgjoi një zë, njëlloj si zëri i Hamit Alisë. Përgjoi në heshtje disa minuta. Jo, nuk kishte folu njeri. Po përse erdhën këto të ngjethura sapo kujtoi emrin e Hamitit? Përse ky shok e mik i tij kishte zgjatur atë tabak letre, për të hedhur dhe Kahremani një firmë? Një firmë pas firmës së vetë Hamitit?

Oh – u u u u! E lodhën këto mendime. Po ajo firmë u hodh kot, vetëm pse ish edhe emri i Hamitit. Po cili tjetër është burri më i ndershëm këtu në Peshkopi? Ku ka tjetër familje të nderuar si familja e mikut tim, Hamitit?

- Flij, o mendje turbulluar, - i tha vetes Kahreman Ylli dhe mbuloi kryet me jorgan, nga që bënte ftohtë.

E vërteta ishte se ajo firmë ishte hedhur kur po mblidheshin lekët për një ekskursion me nëpunësit, për te Liqejtë e Lurës. Në tabakun e letrës shënoheshin emrat e hidhnin firmat secili, që do të shkonte në ekskursion. Këtë kishin bërë dhe Hamiti me Kahremanin.

Kish trokitur muaji Prill. Erërat ishin qetësuar, kishin nisur të vrundullonin lajme ogurzeza. Mbrëmjen e 6 prillit 1939, në Konviktin ku jetonte Kahreman Ylli, bujtën 4-5 burra, miq të Asim Gjergjit e Hamitit. Asimi në fillim e më pas dhe të tjerët kishin dëgjuar lajmet e radiostacioneve të huaja dhe kishin mësues se Flota Ushtarake italiane ishte nisur drejt brigjeve shqiptare.

Kahremani, sa hapi derën dhe i pa burrat të murrëtuar në fytyra, me sytë si të çakërdisur, u frikësua pa e ditur ç'kish ndodhur.

Miqtë hynë brenda, zunë me ngut vendet në dhomë dhe filluan të flasin sikur për hesap të vet, pa dëgjuar tjetrin, a thua ishin grindur e përleshur bashkarisht.

- Të pata thënë, profesor: Viktor Emanueli është rrezikzi. Anijet e tij u janë turrur brigjeve tona...

Folën dhe të tjerët. Treguan ç'patën dëgjuar nga radiot serbe, greke e ato italiane.

Dhomën përsëri e mbuloi heshtja.

- Çudi, po qeveritarët tanë përse heshtin? Pse s'ngrenë në këmbë ushtrinë? – gati sa nu klithi një malësor shtatëlart.

- Po mbreti, mbreti ku është, pse s'ia dëgjojmë zërin? – kërceu një malësor tjetër.

Ora po shkonte 22.00, data 6 prill 1939.

- Dëgjoni burra. Duhet shkuar fshat më fshat e shtëpi më shtëpi. Të thirren i madh e i vogël, që në të gdhirë, sa të zbardhë, të zaptojmë sheshin e qytetit. Si një trup i vetëm të protestojmë kundër Italisë fashiste, por të protestojmë dhe kundër mbretit Zog dhe kundër qeverisë!

- Qohuni, burra – u dëgjua zëri i Asimit. – Në fillim, të marrim dhe shokë të tjerë dhe në kuaj të fluturojmë në çdo fshat.

Të gjithë u ngritën në këmbë, gati të nisen shin.

- Të lutem, dajë Asimi, ti na duhesh këtu, kemi dhe punë të tjera...

Asimi hodhi vështrimin nga malësorët, pa Hamitin, ia bëri me kokë dhe foli:

- Ti Hamit, merri burrat dhe nisuni. Merrni kalorësit tek ledhet e dushkut!

Ata ikën përpara nëpër errësirë dhe këta mbetën vetëm:

- Sonte eja në shtëpinë time, kemi dhe radion...

- Domosdo, na duhen dhe flamuj, po dhe ca parrulla. Sonte as djali yt, Samiu, s'ka gjumë...

Dhe të dy dalëngadalë u nisën drejt shtëpisë së tij në qytet.

Pushtimi fashist i vendit për Kahremanin i preu krejt shpresat se mund të hapej shkolla e Punës në Peshkopi. Në qytet kishte plot atdhetarë që ëndërronin e përpiqeshin që fëmijët e të rinjtë të arsimoheshin. Kuadrot e Prefekturës s'donin që s'donin të çelej shkolla me profil bujqësor.

Kahreman Ylli trokiti disa herë dhe në Ministrinë e Arsimit. Të paktën të ndërrohej profili i shkollës, nga bujqësore, në një gjimnaz spese atë prereferonin më shumë prindërit e të rinjve në qytet. Kuadrot halldupe të Ministrisë në vend që të ndihmonin Kahreman Yllin, nxorën një vendim dhe atë, në fillim të vitit 1940, e transferojnë nga Peshkopia, në shkollën Ushtrimore të Elbasanit.

U gëzua se kishte studiuar në Normalen e Elbasanit, Kahremani shpirtvrarë mori rrugën për në Elbasan. Në Peshkopi kishte jetuar pak, akoma s'i kishte mbushur dy vjet. kishin qenë vite të vështira, por pati dhe mbresa të pashlyeshme. Banorët e qytetarët e kësaj krahine tashmë i njihte mirë. Shumë nga ata i kishte miq për kokë, patriotë të flaktë dhe arsimdashës dhe me virtytet.

Ndarja e Kahremanit me familjen e Asim Gjergjit, emigrantit të dikurshëm, patriotit të kulluar, plakut me një bastun në dorë ishte prekëse. Profesori i ardhur nga Franca, komunisti nuk arriti ta dëgjonte pyetjen gjëmintare të mikut malësor, Asimit:

- Po tani, çdo të bëjmë?!

Të dy shqiptarë, kishin jetuar në shtete të mëdha. I kishin hapur zemrat njëri-tjetrit, këmbyer ëndërrimet, folur për komunizmin, thjesht për një ëndërr të largët. Në Peshkopi, në ato mote as nuk kishte një celulë komuniste dhe ata të dy kishin vetëm njëri-tjetrin.

Tani duhej të ndaheshin me pikëllim e lot në sy. Miqësia e tyre do ruhej, do lulëzonte me Samiun, i cili do të bëhej jo vetëm komunist, por dhe një kuadër partizan trim, që të çonte deri në fund amanetin e Asimit, të atit, për çlirimin e plotë të Shqipërisë.

Zbarkimi i trupave fashiste më 7 prill 1939 ishte goditje e rëndë për pavarësinë e shtetit shqiptar dhe të gjithë kombin. Në mbarë Shqipërinë, si dhe në Çorovodë zbritën qindra fshatarë me armë në dorë, në qendër të nënprefekturës. Aty u organizua një miting antifashist, ku populli protestoi kundër pushtimit fashist e tradhtisë të qeverisë së Ahmet Zogut.

Mbas mbarimit të Luftës Italo-Greke, e gjithë jeta u rifut në situatën e vazhdimit të pushtimit fashist italian të vendit. Pushtuesit italianë, të ndihmuar nga nacionalistët e vendit, nisën nga zbatimi i masave emergjente për sigurimin e jetës së forcave ushtarake italiane në të gjithë zonën e Skraparit. Veç kësaj, propaganda e okupatorëve fashistë iu bënte jehonë të madhe fitoreve të boshtit fashist në të gjithë frontet e luftës dhe fitoren e tyre përfundimtare e paraqisnin të shpejtë e të sigurtë. Bandat e kriminelëve ordinerë vazhdonin të kryenin krime të rënda në tërë krahinën e Skraparit, duke krijuar një situatë të zymtë e të pasigurtë për popullin. Vetëm nga fundi i vitit 1941 dhe në fillim të vitit 1942, u dhanë sinjalet e shpresës së madhe për organizimin e një rezistence të përgjithshme mbarëpopullore. Ishte krijuar partia Komuniste e Shqipërisë, e cila mori përsipër të udhëhiqte popullin, "pa dallim krahine, ideje dhe feje", në luftë kundër okupatorit fashist.

(Shkëputur nga libri "Kahreman Ylli" i autorit Petrit Myftiu. Titulli i lësaj pjese është i redaksisë)

botime

Romani i Naim Berishës "Të jetosh në paqe", me bazë historike të vërtetë, është sa tërheqës dhe intrigues

Berishët e Muhurrit, si rast unikal në historinë Skënderbegiane

Nga Halil RAMA

Barleti, Franku, Sokoloski, Pall, Stort, Stojanovski dhe shumë të tjerë biografë dhe studiues vendas dhe të huaj të Skënderbeut, evidentojnë Berishët e Muhurrit të Dibrës, si një rast unikal në historinë skënderbegiane. Madje Marin Barleti te *"Histori e Skënderbeut"* - (faqe: 314, 315, ...) *shkruan se "Ndër fisnikët më të mirë të atij vendi (në Dibër) ka qenë familja e lashtë e Berishëve. Dy vëllezërit, gjeneralë të Skënderbeut dhe, njëherësh, kryetrima të rinisë dibrane, Dhimitri dhe Nikolla, ndihmën e të cilëve Skënderbeu e kishte të dendur dhe të shënuar, kur dëgjuan për fatkeqësinë e ushtrisë sonë dhe për përfundimin e rrethimit të Beratit, kur morën pastaj vesh për rebelimin dhe pabesinë e Moisiut, nuk u vonuan aspak, por vrapuan fluturimthi për tek roja dhe kryeporta e mbretërisë, të trembur se mos roja atje shpërndahej nga frika apo ngaqë s'kishte kush e frenonte dhe se mos vendi mbetej pa mbrojtës, sidomos kur vinin lajmet se Sebalia ndodhej, ende, në Epir. Dhe kështu Dhimitër dhe Nikollë Berisha me plot arsye, u kujdesuan, së pari, për të kërkuar ushtarë dhe, kështu, e rritën rojën, u dhanë zemër burrave me fjalë dhe me vepra, duke ua shtuar, me çdo mënyrë, dashurinë për Skënderbeun, si dhe duke shfaqur simpatinë e tyre për fatin e tij dhe urrejtjen për pabesinë e Moisiut ..."*. Duke shkruar për këtë familje, (ftilloj:"Familja e Lashtë të Berishëve" sepse në gjithë librin voluminoz të tij për Skënderbeun, Barleti, çuditërisht, vetëm këtë familje, në ndryshim nga gjithë të tjerat, e specifikon kështu: "të lashtë") është e pamundur të mos përmendësh Kastriotët dhe Skënderbeun. Kjo sepse, këto dy familje, u ngjizën në të njëjtën trevë të origjinës, në Masrekat e Dibrës së Poshtme, për të cilën kanë shkruar jo pak historianë vendas dhe të huaj. Edhe nga burimet arkivore, edhe nga ato gojore vërtetohet se këto dy familje qenë jo vetëm bashkëkohës dhe bashkëfshatarë, por, njëkohësisht, dhe bashkëluftëtare. Qyshse Kastriotët u shfaqën për herë të parë në skenën politike të kohës, Berishët bëjnë krushqi me ta dhe që nga ajo kohë, familja e lashtë e Berishëve, do të mbetet në historinë skënderbegiane si njëra nga familjet bashkëluftëtare më besnike e kauzës së Kastriotëve.

MASREKAT DHE GARDHI, TREVA NË TË CILAT, EKSKLUZIVISHT, IDENTIFIKOHET MUHURRI

Të shkruash për Berishët, më së pari, do të thotë të shkruash për Masrekat, të Epërmet dhe të Poshtmet, si dhe për Gardhin e Poshtëm (të Dibrës së Poshtme), treva në të cilat, ekskluzivisht, identifikohet Muhurri, ky shtrat i rralle shtrëngatë i origjinës së lashtë të Kastriotëve.Të shkruash për Berishët e kohës së Kastriotëve do të thotë të hedhësh një dritë të re mbi qytezën e lashtë ilirike të Hurdhë-Muhurrit dhe Mazrekave të Epërme vend ku u ngjizen dhe u formuan në shekuj Kastriotët, të cilët i dhanë kombit tonë të shqiponjave pavdekësinë. Të shkruash për Berishët e Skënderbeut do të thotë të farkëtosh dhe një të vërtetë më shumë se Gardhi i Poshtëm, (vendlindja e dy gjeneralëve të Skënderbeut, Dhimitër dhe Nikollë Berisha), ishte ashtu siç pohon Gjon Muzaka, njeri prej dy katundeve që pati në zotërim Pal Kastrioti, gjyshi i Skënderbeut. Dhe, më në fund, të shkruash për Berishët e Skënderbeut do të thotë të shkruash për një rast unikal në historinë skënderbegiane dhe jo vetëm. Do të thotë të shkruash për dy vëllezër, secili më i zoti se tjetri, që të dy gjeneralë të Skënderbeut, luftëtarë të ekselencës, njerëz të elitës sunduese skënderbegiane, nënkomandantë nga më të rreptët e Skënderbeut dhe, njëherësh, nga më të besuarit e tij, personazhe historike të veprës së madhërishme të Skënderbeut shkruar nga Barleti, vepër e përkthyer në shumë gjuhë evropiane dhe që qarkullon prej më shumë se 500 vitesh në gjithë botën. Kur shkruhet dhe flitet për Berishët e kohës skënderbegiane, s'do mend që flitet e shkruhet për Berishët e Muhurrit të Dibrës së Poshtme. Asnjë historian apo kronikan, asnjë burim arkival apo gojor nuk na bën të njohur ekzistencën e ndonjë fisi a familjeje tjetër "Berisha" në gjithë trevën autentike arbërishte të epokës së Kastriotëve. Në se ka sot familje Berishësh, gjithkund, në hapësirat etnike shqiptare, ato, dihet, kanë divergjuar përgjatë harkut kohor të këtyre pesë shekujve të fundit, pra, fill pas MOTIT TË MADH nga e vetmja pikë: Familja e Lashtë e Berishëve të Masrekave dhe Gardhit të Poshtëm, përndryshe, nga Muhurri i sotëm i Dibrës së Poshtme, pikërisht, aty ku e kanë gjenezën, aty kanë dhe trojet e tyre të vjetra e të pakontestueshme Kastriotët tanë të madhërishëm.

Referuar këtyre kolosëve të historisë sonë kombëtare, por dhe në të dhëna arkivore e gojore, poeti, romancieri, përkthyesi dhe, njëherësh, kantautori muhurrak Naim Berisha, autori i më shumë se 30 librave artistikë, (vetëm në këta 23 vitet e fundit), ka botuar së fundmi romanin e tij të gjashtë, të cilit i ka vënë titullin e bukur dhe kuptimplotë, "TË JETOSH NË PAQE". Ndryshe nga pesë të parët, ky i fundit i përket zhanrit historik.

Në këtë libër, ai trajton temën e qëndresës së popullit të arbërit në kohën e Skënderbeut. Duke glorifikuar familjen e lashtë të Berishëve të Mazrekave në Gardh të Poshtëm, dmth, në Muhurrin e sotëm të Dibrës së Poshtme dhe të dy gjeneralëve të Skënderbeut, vëllezërve Dhimitër dhe Nikollë Berisha, djem të Gjergj Berishë Mazrekës dhe Majra Kastriotit) ai, në të njëjtën kohë, glorifikon gjithë qëndresën heroike të Arbërisë nën udhëheqjen e Skënderbeut kundër tiranisë së pashembullt turke.

FRYMA POLEMIZUESE E AUTORIT DHE BESUESHMËRIA NË PËRSHKRIMIN E PERSONAZHEVE

Duke vazhduar me vlerat e romanit, nuk mund të mos nënvizoj frymën polemizuese të autorit me ata që u përpoqën të anashkalojnë qëllimisht Muhurrin dhe Berishët, edhe pas mbledhjes së dëshmive të pleqve të urtë muhurrakë Lam Mziu e Fali Rama. Ndërkohë që ka edhe të tjerë që ndonëse botuan libra rreth gjurmëve të kastriotëve në Sinë e Muhurr, megjithe kontributin studimor nuk arritën të orientohen nga figurat e kryetrimave Nikollë e Dhimitër Berisha, siç bëjnë H.Koltraka, S.Mziu e F.Daci. Romani historik i N.Berishës bëhet më i besueshëm kur iu referohet studjuesve të mirëfilltë të Historisë së Muhurrit, Hilmi Sadikut e Ilvi Shehut, apo edhe Hysni Bruçit e Hysni Milloshit si promovues të vjershë së tij të parë dhe të studimit për Berishët e Muhurrit të botuar në revistën "10 korriku".

Botime të tjera nga i njëjti autor

"Vjershë e ndaluar"
"Pengu i nëndheshëm"
"Shpirt i heshtur"
"Sagë e vjedhur kohe"
"Hiri i frymës"
"Lejlekët e lumit tim"
"Grindja e skeleteve"
"E drejta, e padrejta dhe kadiu"
"Kur grinden skeletet"
"Gjindja kishte ngrënë egjër"
"Dashurinë ta lë në shpirt"
"Sythi i paçelur"
"Vdekja e deles"
"Zëri i malit të Shënmërisë"
"Shpresa"
"Të jetosh në paqe"
"Sonete 1, 2" William Shakespeare
"154 sonetet e Shekspirit"
"Kashta e Kumtrit"
"Kaleidoskop" (mozaik)
"Luleçelur në degë të mollës"

Të gjitha këto botime i gjeni pranë librarisë M&B në Tiranë, Fleta XXI në Peshkopi ose mund ti porosisni pranë rrjetit të librarive Adrion në Tiranë

Një figurë interesante është dhe ajo e Liman Berishës, për bëmat e të cilit në betejat kundra turqve e serbëve, deri në kryengritjet e viteve '20-21 unë kam shkruar që para 30 vitesh reportazhin "Muhurri në breg të Drinit", botuar në gazetën "Ushtima e Maleve", dhe ku ndoshta për herë të parë sjell referenca nga Barleti e Noli për gjeneralët trima të Skënderbeut, Dhimitër e Nikollë Berisha

Tërheqës janë edhe profilet e Xhemalit, Osmanit e hallë Miles, që Gjorgu, mjeshterisht i viziton, qoftë dhe vetem si inkurajues të krijimtarisë së tij. Po në këtë këndveshtrim përfshihen në romanin historik "Të jetosh në paqe" dhe xhaxhallarë e autorit, Ramazani, Haliti e Lika sidhe kushurinjtë, Arbeni, Limani e Bardhyli, si pasardhës të denjë të Dhimitrit e Nikollës. Pikërisht edhe për hedhjen dritë rreth këtyre figurave e personaliteteve të shquara, ky roman i N.Berishës zë vend të veçantë ne analet e historisë sonë kombëtare.

"TË JETOSH NË PAQE" NJË ROMAN I ZHANRIT HISTORIK

Duke u mbështetur në mendimet e konsulentevë dhe të recenzentëve, emrat e të cilëve janë të shkruar në faqen e parë të librit, kemi mbërritur në një akord se ky libër i veçantë i Naimit, më shumë se një libër monografik për familjen a fisin, është një roman i zhanrit historik, sepse i gjithë libri është nën ndikimin e parimit artistik dhe estetik të historisë.

Ky parim, siç dihet, e sheh historinë edhe si art, njëherësh, i përcakton asaj edhe qëllime të tjera, veç tregimit objektiv



të ngjarjeve. Romani "Të jetosh në paqe" mendoj se e prek lexuesin dhe, në të njëjtën kohë, e kënaq atë përmes rrëfimit interesant dhe stilit konciz, të trajtave të larmishme të tregimeve impresionuese, të vrullshme e plot ngjyra.

Natyrisht, parimet dhe tiparet e mësipërme letraro-artistike bien disi në kundërshtim me karakterin e rreptë shkencor të historisë, por ato, në roman, kombinohen aq bukur dhe aq bindshëm ashtu siç shkrihet, në një të vetme, forma artistike me përmbajtjen e romanit.

Edhe fakti se në libër janë përdorur mjaft mjete stilistikore, si digresionet, retrospektiva, harmonizimi i kujdesshëm i kësaj të fundit me realitetin e sotëm, ruajtja dhe sigurimi i vazhdimësisë së amaneteve, i kumtit të tejçuar oral nëpër brezat pasardhës të Berishëve të vjetër, në të njëjtat troje (të Muhurrit) deri në ditët tona, kombinimi i të vërtetave historike që përcjell Barleti dhe të tjerë biografë të Skënderbeut me gojëdhënat që janë shumë të njohura në Muhurr edhe sot e kësaj dite për fisin e Berishëve dhe lidhjet e tij shumë të afërta dhe tejet besnike me Skënderbeun, gërshetimi i linjave themelore të ngjarjeve historike me detajet konkrete të luftës dhe të jetës së dy vëllezërve gjenerala, Dhimitër dhe Nikollë Berisha, ingranimi me këto linja, që mbajnë në këmbë librin, i tregimeve të Babës së Madh, i cili jetoi aq gjatë si për të treguar ..., "Rrnoj për me tregue" dhe që, çuditërisht, na kujton plakun Balë të De Radës tek "Këngët e Milosaos", dhe, më në fund, rrëfimet në vetën e parë të Gjorgut, (që është vetë autori i librit) të cilat shfaqen, mjeshtërisht, në trajtën e kujtimeve, e të tjera, e bëjnë këtë libër që të anojë më shumë si një roman, sesa një libër, thjesht, jetëshkrimor.

Gjithëçfarë thamë më lart, mendojmë se justifikohet edhe me atë që pohon autori, se letërsia, për të, është e pandarë nga historia.

Ky roman historik, shprehim bindjen se i bën nder sa historiografisë skënderbegiane, aq dhe letërsise artistike që evokon atë epokë të lavdishme.

"Të jetosh në paqe" që i dedikohet familjes së lashtë, të vjetër dhe të re të Berishëve të Muhurrit dhe jo vetëm, është një kontribut i ri si në thesarin e historiografisë skënderbegiane, ashtu dhe për letërsinë që i korrespondon asaj periode legjendare e të papërsëritshme.

Ky roman me bazë historike të vërtetë është sa tërheqës dhe intrigues, aq dhe me interes e domethënës. Si i tillë, ai lexohet me një frymë. Dhe ne besojmë se do lexohet kështu për shumë e shumë kohë, si brenda, edhe jashtë kufijve të atdheut dhe se do zërë vend të merituar në mjaft biblioteka personale të shqiptarëve.

Për shkrimtarin, poetin, përkthyesin, hajkistin, romancierin dhe kantautorin, bashkëfshatarin tonë të dashur muhurrak Naim Berisha, urojmë nga zemra veç të mira në jetë dhe suksese të mëtejshme në krijimtarinë e tij të bukur artistike.

Rruga e Arbërit nr. 134

Dibër, tokë e trandur



Nga **DIONIS XHAFA**

Kisha një javë pushime dhe u nisa për në Dibër, vendlindja ime. Që kur rrotat e automjetit nisën të lëvizin drejt një krahine disi të fjetur, menjëherë sikur në mjegullnajë më erdhi ndërmend libri i Albert Kamy: "Njeriu i parë". Kamy në këtë libër dëshmon në një mënyrë të qetë dhe natyrale për vitet e para të jetës së tij, për vendlindjen Mondovi në Algjeri, pasi atdhe kulturor i ishte bërë Franca. Ja kështu më ngjante pak a shumë vetja. Po kthehesha në një vend që e njoh shumë mirë, deri në qelizën e vet më të humbur, por se nga ana tjetër më duket shpesh i ftohtë, i shkretë, një shkretëtirë që ashtu çuditërisht natyralisht nuk e ka shkretëtirën.

Për në Dibër thua se je drejtuar menjëherë pasi fillon dhe merr udhën përtej Milotit e Mamurrasit.

E pashë sërish këtë rrugë kthese, që duket e veçantë nga të gjitha udhët e kësaj republike paçavure, që gropën e vet më të madhe, zullumin e vet më madhor e ka ngritur në pietestal në rrethin e vendlindjes sime. Në udhën që merr kthesën fillon e hyn në atë që unë e konsiderova shkretëtirë, vendin ku dhe lulet kanë frikë të mbijnë. Përballë të shfaqet një shtëpi e vjetër, si tip kulle, që nuk është shkatërruar, edhe pse në fakt aty duket se nuk ka njeri, nuk është as biznes, por qëndron ndërtesa stoike nga kohët, a thua se është ndonjë thesar për këtë zonë, kur në fakt arsyeja mund të jetë bajate, se atë mund ta ketë ndonjë i fuqishëm, që s'ka pushtet që e rrëzon një shtëpi të përçunduar në atë mënyrë, sikur të jetë kuçedër me shtatë gjuhë. Kjo është përshtypja e parë që kam dhe e dyta që më vjen ndërmend është se shumë kohë ka kaluar, qysh kur isha fëmijë dhe rrallë i merrja këto udhëtime të gjata, njerëzia ka evoluar, kohët kanë ecur dhe kulla famoze në sytë e mi, ka ngelur ashtu, apoteozë e mjerimit të djeshëm e të sotëm, e zonës që edhe në republikën e varfër, ka mbetur jetime e një nëne që se di në ka nënë a ka lindur prej asgjëkundi. E rrotat e kamionit vijojnë e ecin, duke e pasur mendjen te ajo ndërtesë, tek ajo frikë, te ai mister, që nuk gjen zgjidhje, edhe kokën tel ta bësh.

Rruga vijon me lumin Mat, bukuria e madhe e një lumi të gjelbër, me kreshta shumë, që fatkeqësiosht ka mbetur në një zonë të varfër e të vakët, ku dhe shteti nuk ka bërë ndërhyrjet e duhura. Po këtu jo vetëm që s'ka gjë të përbashkët me shtete të Europës, po këtu nuk gjen as realitetin e Mirditës, as të Kukësit e ndoshta as atë të Pukës, që deri dje mbaheshin se ishin të varfëra. Kjo sepse në rrethet që lartpërmenda ka kaluar ndonjë projekt, si Rruga e Kombit, që me ato problemet e veta, sërish i ka sjellë ca hov zonës. Po këtu është lemeri.

Në kohën që e gjithë Shqipëria nuk vuan për rrugë të shtruara, në mes të Klosit, qyteza që vështirë se meriton të jetë e tillë, nën zhurmat bajate të këngëtarëve hip-hop të zonës, nën benzonatë të derdhur në udhë, makina nis e "kërcen" nëpër gropa të mëdha, që duket sikur kanë hapur gojën e të thonë se ne nuk mundëm t'i bëjmë ballë kushteve atmosferike, se ashtu i ka hapur dielli i fortë e se i ka shkatërruar njeriu, ky kafshë që brenda lëkurës ka shumë kafshë. Po habitesh me vete se këta politikanët i shohin gropat, kur kalojnë? A habiten se njerëzia dergjen rrugëve? Këta me helikopterë lëizivin kështu? E rëndë është ta thuash, e vështirë ta shpjegosh, por rrugë si në Afrikë mundesh me gjet në republikën, që Zoti për ata që besojnë e natyra për ata që nuk besojnë e ka bekuar me qenë në Europë, që ashtu me fat qëllon të jetë ndër kontinentët më të mirë të kësj bote që e jetojmë.

LASHTËSI E VDEKJE

Po më tej ka varre, po po janë varreza ku prehen njerëz që janë ose në rrugë kur i ka shtypur makina aty në mes të xhadesë ose janë pak metra më tutje, se janë varreza të fshatrave afër. Aty merr me mend se njeriu qenkërka një hiç, sidomos ai i këtyre zonave, që jeton për me pas trashëgimtar dhe atë pastaj me e lënë shëndetshëm se "kaq e ka kismetin" e të tilla shprehi arkaike përdoren në zonë. Po varret janë dëshmi lashtësie, janë fundi i një dhimbjeje që kalon përmes malesh vigane të zonës së quajtur Martanesh e zbret tëposhtë në Valikardhë. Po Valikarda çfarë është dhe ajo fushë ku afër gjendet Bulqiza e kromit me dy "qytetet" e saj? Valikardha është fusha ku ndër faqe të historisë na është mësuar se ka luftuar Skënderbeu, heroi ynë kombëtar, se këtu pikërisht i ka kryer betejat e veta më të mëdha, e kjo ndoshta edhe prej faktit se turqit vinin ndër këta anë se është terreni i përshtatshëm për këtë punë. Në atë fushë të Valikardhës, kishin vendosur edhe një statujë të Skëndërbeut, si dëshmi e kohës së tij, që mbahet si e lavdishme fort. E këtu më lind dyshimi. Të kisha jetuar në kohë të tij, a do ta kisha dashtë a do ta kisha urryer? A mundet me qenë një zonë edhe historike njëkohësisht edhe e varfër? A mundet që të ushqehesh prej historisë e të vdesësh prej realitetit? A mundet me qenë pa rrugë të premtuar e të jetosh, për bukë të përditshme, ndër male të qytetit të kromit të madh, që deng e varg shkon në Durrës, e prej andej kalon Oqeane e nuk dihet se ku përfundon? A mundet?...

BULQIZA, JETË E MORTJE

Një natë e kalova në Bulqizë, qytetin që ndahet më dysh si dy të afërm që kanë varret ngjit e ngjit, se kështu thuhet se janë më afër emocionalisht. Kur shkon nga Tirana, në të djathtë gjendet Qyteti i Vjetër, një mal me krom e punëtorët që disa punojnë me kushte dhe disa pa kushte. I vjetri qytet është i minatorëve. Së paku kështu thuhet se dhe këtu ka ngjarë ai fenomen që ngjan në tërë republikën e absurdit që jetojmë përditë, se minatorët e vërtetë kanë ikur prej aty e banorët e fshatrave përreth kanë ardhur e janë bërë minatorë. Këtu është një qendër e vogël, një ose dy klube e ku pinë cigare rëndë e bisedojnë minatorët me njëri – tjetrin, në mëngjes pa nisur punë, që në varësi të stinës shohin ose jo diellin dhe në darkë që prapë në varësi të stinës, mundet me e përcjell perëndimin e diellit me sytë e vet, në dalçin gjallë.

Aty afër ndodhet policia, se duhet sigurisht nëse thyejnë turinjtë minatorët, plagosen ose vriten, i marrin direkt, me ca autoambulanca, që ngjajnë sikur je në Irak a në Libi, të pluhurosura rëndë e me dyer nga mbrapa që ka raste hapen vetë ose i gjen edhe të shkatërruara. Po këta autoambulanca ose të tjera marrin me vete edhe në rastet kur përplasen banda të kromit me njëra – tjetrën, se policia a hyn a nuk hyn në punë kjo nuk është e sigurt. Në fakt, ndryshe nga autoambulancat në Irak për shembull këtyre iu mungon gjysmëhëna, edhe pse janë myslimanë kaq shumë, sa shumica e banorëve mbajnë Ramazan, në kontrast të thellë me historinë që e kanë, se kanë luftuar një armik që vinte vurishëm me flamuj gjigandë që ngrinin gjysmëhënat në qiell. Po Qyteti i Vjetër i tillë është, më shumë i ngjan mortjes, vdekjes për së gjalli. Mundesh me qenë pak më mirë në Qytet të Ri. Këtu për shembull me kushëririn luajtëm bilardino, bilardo, në një vend që ishte si bodrum, edhe lokale me muzikë gjeje dhe kjo është pjesa ku ky vend ka vërtetë jetë, në kontrast të thellë me Qytetin e Vjetër. Në Qytetin e Ri ka edhe loto, të gjitha që gjen kudo, tërë bajgat e kapitalizmit mbledhur aty, që përzier me llomin e Qytetit të Vjetër krijojnë një gjendjeje të fikti, që e mban vendin ashtu si njeriu në koma, që hera – herës i lëshon pak ujë e mundet të ngjallet.

RRUGË E PASHTRUAR

Po do ecja në pikë të diellit, në atë diell që mua atje verës më duket më i nxehtë se në Tiranë. Do hidhja hapat në një udhë pesë kilometra të gjatë, për të shkuar në vendin ku kanë origjinën të parët e mi, që këtu edhe kur banoja në Dibër, kështu vinja. Ti ke hapin e madh tani, por thuajse asgjë nuk ka ndryshuar. Ka vapë, ka qetësi, ka kanale anash me ujin e Gurrës, lumth ky që thonë se derdhet në Drinin e Zi, që është prezent në këtë zonë. Po ecën dhe sheh fabrika të vjetra të kohës së monizmit, që kanë funksionuar në atë kohë apo të tjera objekte, që janë shkatërruar, a thua se ka ndodhur ndonjë sulm nuklear. Në fakt, unë edhe nuk i njoh fort traditat e zonës, por se çdo makinë që kalonte, shumica më përshëndesnin me dorë, se kështu e kanë zakon, çdokënd që kalon në rrugë e që me siguri është nga ai vend, e përshëndesin. Në rregull, shumë përshëndeta. Po si mund ta përshëndesje një djalë të ri, sa unë ose më i ri, ndoshta 20 vjeç, që me dum dum, kishte hyrë në mes të pyllit, i kishte prerë pemët më të mira aty, lisa që sapo kishin çelur filiz dhe ecte pa pikë meraku?

A e dinte ai se ishte fill e për burg për atë krim që kishte kryer? Se ai krim që kishte kryer ishte njësoj sikur të vrasësh në djep foshnja të porsalindura? Epo e habitshme, thashë dhe dorën as që e ngrita fare. Vazhdova në atë udhë me pluhur plot, që ka këtu e vite e dekada që as nuk e ka shturar njeri e as ka ndërmend ta shtrojë askush. Dhe nga aty, në mes të rrugës pashë qytetin që mbahet si krenaria e zonës, atë që në zhargonin popullor njihet si Dibra e Madhe. Shtrihej ashtu në mes të malit të Deshatit sikur kishte zënë rrënjë buzë atij mali e mendoja thellë: Të duash historinë kaq shumë a ia vlen? A ia vlen historia të duhet e të përbuzësh gjendjen katastrofike, ku gjendet ai vend? E prapë në mes të madhështish në dukje, ngrihej varfëri e madhe, realitet maskaradë e një zone që e kam njohur si të tillë nga afër. E kam njohur aq nga afër, sa fytyra pa makiazh e saj është vërtetë e rëndë, por preferoj të mos gënjehem.

MAQELLARA, SA SHUMË PËR TË THËNË...

E kështu, e bëra udhëtimin dhe qëndrova edhe një natë në fshatin e të afërmve të mi, nga ku kam origjinën me pak fjalë. Por zemra s'më bëhej pa shkuar në Maqellarë, që është një qytezë që gjendet në mes Dibrës së Madhe dhe Peshkopisë e se jam rritur këtu dhe se njeriu ndoshta do më tepër atë vend ku ka më shumë kujtime. Duke qenë se është zonë kufitare, ka edhe doganën shumë pranë, ka një lloj gjallërie që rrallë e gjen në vende të tjera, së paku në Dibër. Nëse e quajta Dibrën një tokë të trandur, Maqellarën do ta quaja si vendin ku tronditja ka më pak magnitudë. Këtu kam dhe shokë shumë e takova disa prej tyre. Në fakt, nëse ke para në Maqellarë ia kalon mirë, nëse ke biznes ose punë për të qenë, pasi kështu kishin disa nga ata që kam arritur të takoj. Njerëzit janë vërtetë të mirë dhe punëtorë e jo më kot mbahet si zonë që thuhet se personat punojnë fuqishëm. Këtu thuajse nuk mungon asgjë nga Tirana, e ka edhe lokalin, edhe internetin, edhe freskinë, edhe shkollën. A po shkolla. Pasi bisedova me ca miq, u drejtova për nga shkolla që ka qenë e imja dikur, kështu e quaja. Sot është ndryshe. Shkolla 9-vjeçare ishte ndarë nga ajo e mesme.

Te e para luanin fëmijët në oborr, kurse te e dyta adoleshentët, që kanë ardhur shumë edhe nga fshatrat përreth mbanin veten thua se je në një vend të mirëqenë. Nuk është tërësisht e vërtetë se kanë këtë mirëqenie, por se ndjekin si të thuash modë a trend, që vënë re nëpër internet, që ka hyrë kudo. Afër shkollës kishte edhe një lokal, edhe ky kopjim total thuajse i atyre që gjenden në Tiranë. Në fakt, Maqellara në thelb duket tepër urbane disi, por se edhte ketë urbanizim e ka një kopje të shëmtuar të perëndimit e të qyteteve të mëdha të Shqipërisë. Pashë edhe pallatin tim, ku kam pasur shtëpinë, një zonë e qetë shumë, ku mundeshe të flije në drekë dhe të çoheshe për makiato pasdite. Po atë ditë rastësisht në Maqellarë u gjenda kur erdhi edhe kryeministri i vendit, që ishte sikur të jetë një ufo në mes të njerëzve, e se lëvizte duart duke mos iu dëgjuar zëri, a thua se ishte një i marrë në mes të turmës. Do të ndërtonin spital të ri më duket, edhe shkollë, diçka e tillë. Ishte së bashku me Ilir Beqajn që është edhe i pari në listë për të qenë deputet në Dibër. Se ç'lidhje ka Beqaj me Dibrën dhe me problemet e kësaj zone, unë për vete se di. Janë shumë gjëra për të thënë për Maqellarën që i kam më tepër në trajtën e kujtimeve të fëmijërisë, por se edhe i kam thënë e se janë gjëra që thuajse bëhen nga të gjithë fëmijët e botës e mbeten si hekur në bark në kujtesë e kanë lidhje me futbollin, shakatë, hidhërimet. Maqellara është pranë doganës, e besoj se kaq mjafton për të thënë se këtu ndodh çdo gjë që mundet të rrokë mendja njerëzore, por në sipërfaqe ka dritë, jetë, lumturi.

IKJE NGA SHKRETËTIRA

Në fakt, unë e dua vendin tim, por edhe kur kalon caqet bëhesh me një mendje, aq sa fillon e refuzon edhe vendet e tjera. Ç'është e vërteta nuk jam i tillë, por thjesht shpjegova udhëtimin në pak rreshta në vendlindjen time. E, metafora më e denjë është se ajo është shndërruar në shkretëtirë, si pasojë e politikave, të veglave të pushtetit, të lloj -lloj mënxyrash, që atë vend, si çdo vend të republikës absurde e kanë kthyer në një kufomë, duke shkatërruar, rrënuar e vjelë prej Shqipërisë edhe atë pasuri që kishte në bark, duke na lënë sot pa hiçgjësend, sa duket ndonjëherë se mirë është se njerëzve nuk iu ka ikur mendja akoma!

histori

ÇETA E SHPRESËS



Nga **XHEVAT JELLA***
ZABIT LLESHI

Politika e jashtme antikomtare e qeverisë së Zogut, marrëveshjet me Italinë e kishin shndrruar vendin tonë në një gjysëm koloni. Dalëngadalë po përgatitej agresioni i 7 prillit. Kudo në Shqipëri shpërthyen demostrata. Enjëjta situatë ishte në Dibër të Madhe e fshatrat rreth saj. Njerëzit kërkonin të organizoheshin, kërkonin armë. Jugosllavia përforcoi kufirin dhe as që bëhej fjalë për armë e ndihmë nga ana e saj.

Ditën e 7 prillit, për t'u shpëtuar ndjekjeve dhe persekutimeve, drejt kufirit shqiptaro jugosllav ishin nisur qindra njerëz, studentë, ushtarakë, intelektualë, përparimtarë e antifashistë. *"Midis tyre që kaluan kufirin ato ditë më kujtohet Xhevdet Doda, Hamid Shijaku, Abedin Çiçi, Dr. Nazmi Shehu, Jashar Bunguri, Xhemal Gumeni, Mustafa Gjinishi, Sadri Dini, Vasil Shanto, Gaqo Mosko, Abaz Kupi, etj."*[1]*(Haxhi Lleshi Vite njerëz ngjarje fq 29,Tiranë 1996)*

Emigrantët shqiptarë të grumbulluar në Gostivar filluan të demaskonin propogandën italjane në bisedat me njeri tjetrin, edhe me popullin e thjeshtë. Nga njera anë bëhej propogandë për të mirat e fashizmit, nga ana tjetër bëheshin bastisje, arrestime, burgosje e internime. Haxhi Lleshi bashkë me familjen e madhe të Lleshajve banonin në Banjisht, ku ishin njohur e kishin krijuar miqësi me Myslim Pezën, Kajo Karafilin e shumë patriotë të tjerë të internuar në Jugosllavi. Në Dibër të Madhe e fshatrat për rreth saj përgatiteshin dhe shpërndaheshin trakte nga Abedin Çiçi, etj.*"Me gjithëse kufiri ruhej qoftë nga jugosllavët apo italjanët, shokët tanë besnikë Nuz Majtara, Shefki Riza Lleshi, Kadri Demiri, Sul Muca, etj. ishin të pa kapshëm. Për shpërndarjen e trakteve na pat ndihmuar edhe Xhevdet Doda që ishte vendos përkohësisht në Elbasan. Në Tiranë shpërndarjen e bënte Thoma Kalefi me shokë. Ata i dërgonin në Durrës, Kavajë, Lushnje , Fier e deri në Gjirokastër. Traktet kishin karakter politik."*[2]*(Haxhi Lleshi Vite njerëz ngjarje fq 32,Tiranë 1996.)*

Nëpërmjet trakteve kërkohej të sabotoheshin veprimtaritë fashiste me rininë, të mos visheshim milicë, të mos paguhej taksë, të hiqej dorë nga hasmëritë, ngatresat e gjakmarrja. Informonin për luftën heroike të Spanjës, e popujve të tjerë kundër fashizmit.

Babë Myslimi erdhi nga Dibra në Pezë. Ai kish qenë 9 vite emigrant në Jugosllavi dhe këmbente informacione herë mbas here me patriotët e Dibrës, për gjendjen në Tiranë e Dibër të Madhe, kryesisht me Aqif Lleshin, Mustafa Gjinishin, Haxhi Lleshin, etj. Kjo veprimtari e gjthanëshme patriotike kish rënë në sy të pushtuesve,qeverisë italiane ku jo një herë i kishte bërë presion qeverisë jugosllave të ndalonte veprimtarinë e tyre.

Në fund të vitit 1939 Beogradi vendosi të shpërndajë emigrantët në thellësi të Jugosllavisë. Disa nga emigrantët politikë i dërgoi nga Gostivari në Vërshac, BellaCerko, Valevo, Sarajevë, etj. Haxhi Lleshin e dërguan në Stari Beçaj, afër kufirit me Hungarinë. Ke mbajtur lidhje me Shqipërinë i thanë, u ke dërguar ndihmë shqiptarëve që janë hedhur në luftë kundër Italisë. Qëllimi ishte t'i largonin sa më larg kufirirt për të mos patur kontakt me patriotët dhe Shqipërinë. Në mars 1941 Haxhi Lleshi mori leje nga internimi në Shkup dhe erdhi në Dibër të Madhe. Ai u bashkua me shqetësimet e njerëzve dhe u bëri thirrje të organizoheshin kundër pushtuesve italo- gjermanë që përgatiteshin të sulmonin Jugosllavinë. Shqetësim i madh ishte mungesa e armëve ; kërkuan disa herë nga autoritetet civile dhe ushtarake në Dibër të Madhe ; u dhanë disa armë italjane trofe. Thirrjes së patriotëve merrni armët tueja, bënë që të grumbulloheshin mjaft qytetarë të armatosur.

Në ditët e para të prillit italjanët shtrinë forcat e Divizionit "Firence" në vijën Maqellarë–Shupenzë-Miresh-Klenjë e deri në Librazhd. Në brezin e dytëqëfillonte nga Smolliku në Strikçan-Zerqan-Fush Bulqizë-Mali i Bllacës-Katër Grykët qe vendosur Bataljoni Alpin "Brenero".

Atdhetarët dibranë bënë planin për t'u nisur në dy drejtime. Haxhi Lleshi e Ymer Lleshi me 200 veta u nisën në krahun Sebetovë, Tërbaç, Çerenec, Viçisht. Aqif Lleshi me Hamdi Lleshin me 100 pushkatarë në Bllatë, Reshan e Maqellarë. Më 6 prill filluan veprimet luftarake dhe në befasi të plotë u morën postat kufitare të Ostrenit, Mireshit e Viçishtit dhe erdhën deri në kodrat e Gjoricës.

Forcat e komanduara nga Aqif Lleshi morën postën e Bllatës. Gjatë luftës u bashkuan shumë fshatarë me luftëtarët kundër pushtuesve. Armiku la shumë të vrarë e të plagosur, u zunë shumë armë, municione, veshmbathje, e ushqime që j'u shpërndanë luftëtarëve. Ranë dëshmorët e parë Abdurahim Lleshi e Vebi Jashari në Zonën e Maqellarës. Në kodrat e Çerenecit u vra mësuesi patriot Fasli Cami duke kryer detyrën e korjerit. Më vonë italjanët vranë Musa Camin, Ejup Camin e Mexhit Lezin.

Pas kapitulimit të Jugosllavisë, Italia fashiste dërgoi forca të mëdha në Dibër të Madhe. Ku filluan raprezaljet, internimet e masat e tjera shtypëse kundër luftëtarëve që përgjakën ushtritë pushtuese më 6 prill. Në këto kushte u bë e vështirë lëvizja prej 300 e ca vetësh, prandaj ato u shpërndanë pranë familjëve me qëllim që të vazhdonin veprimtarinë antifashiste në forma të ndryshme. , të gatshëm në kohën e rioganizimit, të kujdësëshëm edhe ndaj mashtrimeve. Në pabesi" burgosën Ahmet Camin, disa Came të tjerë, Murat Bashën, Sali Llanin, Jashar Lelën, etj. Pëllumb Lleshin, Lutfi Lleshin, Shaqir Skukën, Nuz Majtarën i zbuluan dhe i internuan në Peqin, Kavajë e gjer në Itali" Haxhi Lleshi ,Vite,Njerëz Ngjarje Tiranë,1996 fq 43.

Lëvizjet e para bashkë me luftëtarët i bënë midis fshatrave të Strugës ku shkuan Haxhi Lleshi në Misllobezhë, Novoselë, Dollogozhdë, në lagjen Toskë, etj.Kudo i pritën mirë, u premtuan se dotë shtonin rradhët e luftëtarëve, etj.

Në fund të prillit shkuan në Zhupë e Prapanik tek Haxhi Prapaniku, në Banjisht e malin e tij, në Dovolan tek Azis Spahiu, nëÇerenec tek Sibe Gjurra, në Sopot tek Cen Puca, në Bulqizë tek Dull Gjini, në Zogje tek Qamil Lleshi, në Bllacë tek Jashar Zeneli e Baba Zeneli, në Selishtë tek Taf Kaziu, nëKatër Grykët tek Rrahman Dervishi e Ali Pepa, në Lis, Patin e Macukull të Matit. Dy muaj me luftëtarët e tij Haxhi Lleshi kaloi fshat më fshat në Dibër e Mat. Takuan miqtë e vjetër e krijuan miqësi të reja duke zhvilluar një veprimtari të gjërë propogandistike në dobi të luftës për të tërhequr sa më shumë njerëz në rezistencën antifashiste.

Pushtuesit nëpërmjet veglave të tyre u përpoqën t'i largonin nga lufta Aqif dhe Haxhi Lleshin.Për kete Qazim Mulleti prefekt i Peshkopisë u takua ne shtepin e Lil Dedes ne Çernen(Maqellare).Përpjekje të tilla bënë edhe Osman Mema(ish-bashkëluftëtar i Halit Lleshit në levizjen e MARSIT 1922) dhe Irfan Ohri (Nip i Iliaz .P.Dibres).Nga këto takime ata dolën me të vendosur në luftën kundër fashizmit.

Formimi i Partisë Komuniste i dha impulse të reja rritjes e organizimit të luftës kundër pushtuesve fashistë. Në Dibër ajo kish nisur Nazmi Rushitin, për bashkimin luftarak të popullit, për punën me rininë, për lidhjet me fshatin, format e organizimit të luftës, etj. Bashkë me Nazmiun erdhën edhe Xhavit Hatibi, Irfan Hajrullai, Demir Gashi e Ahmet Jegeni. Në mars 1942 Haxhi Lleshi erdhi në Pezë, këtë e njofton edhe prefekti i Durrësit Tafë Naraçi për Ministrinë e Brendëshme: *"Më 6 mars 1942 një çetë me Haxhi Lleshin që vinte prej Dibre ka fjetur në katundin Shetele të Shijakut dhe u drejtue për në shtëpinë e Myslim Pezës"* [3]*(AQSh).*

Takimi me Enver Hoxhën rriti besimin për ngritjen e bashkimin e popullit në luftë pa dallim bindjesh politike e fetare, mjafton që njerëzit të hidheshin në luftë kundër pushtuesit. Ka ardhur koha për organizimin politik tëÇetës partizane si dhe nevoja për të organizuar një konferencë për bashkimin e popullit shqiptar në luftë kundër pushtuesve fashistë i tha Enver Hoxha Haxhi Lleshit. Gjatë kthimit nga Peza për në Dibër, Haxhi Lleshi shoqërohej nga Qazim Prishtina, Zoi Themeli, etj. u ndalën në Martanesh tek Baba Faja, në Tërnovë tek Bajram Zeneli, në Valikardhë tek Destan Zogu, në Sopot tek Cen Puca, në Allabejgi tek Kadri Demiri etj.Në Kërcisht tek Ali Maliqi,u takuan me Dali Ndreun, Esat Ndreun, Veli Devën, etj.

"Informova hollësisht shokët për takimet dhe qëndrimin tonë në Pezë. Të gjithë ishin në një mendje se pas një pune përgatitore prej më shumë se një viti për të ngritur popullin në luftë të armatosur tani kishte ardhur momenti që Dibra të kishte Çetën e saj Partizane."[4]*(Haxhi Lleshi, Vite njerëz ngjarje fq. 90)*

Të gjithë shokët u shpërndanë nëpër fshatra për t'u takuar më 20 qershor në Zogje. Kish ardhur edhe Ramadan Çitaku, anëtar i Komitetit Qëndror Provizor të Partisë Komuniste Shqiptare. Fillimisht u krijua celula e parë e Partisë ku bënin pjesë, Nazmi Rushiti, Qazim Prishtina, Zoi Themeli, Irfan Hajrullai e Veli Deva. U bisedua për të krijuar një celulë në Sllovë me Dali Ndreun, Esat Ndreun, Abedin Shehun dhe Ilmi Çaushollin.

Në çetë u rrjeshtuan 20 partizanë. Përveç anëtarëve të celulës, të pranishëm ishin Demir Gashi, Xhavit Hatipi, Beshir Laçi, Ilmi Çausholli, Musa Lala, Ali Pepa, Sulë Muça, Rrahman Dervishi, Bajram Buci, Nuz Majtara, Shefki Riza Lleshi, Ymer Lleshi, Hamdi Lleshi, Bajram Neziri, Sulë Lleshi, etj. Komisar u caktua Qazim Prishtina, ndërsa komandant Haxhi Lleshi. Çeta u krijua në Kodrën e Limume, përball "Vishkullit", një pemë shekullore dëshmitare e shumë ngjarjeve të mëdha historike të fshatit Zogje.

Natën e formimit tëÇetës u vendos të organizohej aksioni i parë tek Gurët e Skënderbeut afër Bulqizës. Pa gdhirë data e 27 qershorit njësiti i ndarë në grupe u nis nga shtëpia e Mustafa Çakallit e Dullë Gjinit dhe zunë pritë tek Gurët e Skënderbeut ku u godit nga partizanët kamjoni i Postës ushtarake ; Uvranë 3 italjanë e disa të tjerë u plagosën. Gazeta "Tomorri" që transpotonte posta u shpua nga plumbat u shpërnda në Dibër të Madhe, gjë që bëri jehonë të madhe dhe trondit mjaft autoritetet italjane.

Më 24 korrik u bë prerja e linjave telefonike që njihet si aksion kombëtar në shkallë vendi. Çeta e Dibrës rrëzoi 10 shtylla të linjës telefonike Maqellarë-Peshkopi-Sllovë e Dibër e Madhe-Zerqan-Bulqizë. Mungesa e lidhjeve telefonike vuri në alarm të madh garnizonet ushtarake dhe administratën e forcave pushtuese.

Përpjekja tek Ura e Topojanit ku u plagos komandanti i Çetës Haxhi Lleshi u bë duke u gdhirë më 24 gusht 1942. Kuestura e Dibrës më 24.08.1942 i raporton Drejtorisë së Përgjithëshme të Policisë: *"Në orën 01* [45] *të natës një grup banditësh tentuan të kalonin Urën e Topojanit mbi lumin Drin... Nga intensiteti i zjarrit mendohet që banditët të kene qenë në numër të konsiderueshëm dhe me sa duket kishin edhe armë automatike."*

Më 16-17 shtator u organizua aksioni në Minjerën e Bulqizës, ku u dëbuan punëtorët italjanë dhe u ndërpre prodhimi. Udhëheqës i aksionit ishte Nazmi Rushiti i cili bashkë me Demir Gashin u kthyen në Zerqan, ndërsa një pjesë e grupit shkoi në Martanesh në pritje të shokëve që ktheheshin nga Konferenca e Pezës.

Atentati ndaj Stavri Jahos kapitenit fashist ishte një aksion tjetër i Çetësmë 26 shtator. Autor ishte Nazmi Rushiti në bashkëpunim me Demir Gashin. Këtu Nazmiu kapet dhe pas torturave ç'njerzore vdes në Peshkopi, duke rënë dëshmor i parë i Çetës së Dibrës.

Më 30 shtator dështoi rrethimi i Çetës në Zogje. Dy kompani italjane të mirë armatosura rrethuan fshatin sepse Çeta ishte në dasëm të njerit prej luftëtarëve të saj, Qamil Lleshit. Pasi çau rrethim në të gdhirë të mëngjesit pjesëtarët e Çetës me në krye komandantin Haxhi Lleshi, u ngjitën në mal mbi Shtushaj dhe u larguan nga Bllaca për në Grykë të Madhe. Italjanët dogjën shtëpinë e Haxhi Lleshit (e pesta herë që digjet nga pushtuesit) kërkuan garanci deri tek Ura e Serbinit në rrugën nacionale duke u shoqëruar me pushkatarët të ftuar në dasëm

Më 18-19 tetor 1942 u organizua aksioni i Çetës në rrugën Dibër e Madhe-Strugë, afër Modriçit. Autokolona ushtarake u ndal pasi partizanët kishin vendosur në rrugë disa prita, ndërkohë u qëllua duke vrarë tre ushtarë italjanë e plagosur disa ,të tjerë si dhe u kap shumë municion ushtarak. Më 1-2 dhjetor një pjesë e Çetës preu linjën telefonikePeshkopi-Bicaj dhe pjesa tjetër preu linjën telefonike Peshkopi-Maqellarë-Tiranë.

Në shkurt 1943 Çeta e Dibrës shkoi në Mat e Martanesh për bashkërendim të aksioneve kundër pushtuesit, lidhje të cilat jo vetëm u zgjeruan por bashkëpunimi vazhdoi duke u focuar më shumë deri në çlirimin e vendit. Çeta e Dibrës u rrit në aksione kundër armiqve dhe fashistëve italjanë, pushtuesve të vendit. Ishte një tmerr për armikun dhe një faktor i madh shprese e besimi. Ajo u mbështet në popull, tek fshatarët e varfër e patriot, duke e çuar më përpara traditën e luftës për liri e pavarësi.

Populli e ruajti dhe mbështeti kudo e kurdoherë, fuqimisht, me bukë e pa bukë, me armë e pa armë. Mbështetja mbarë popullore e Çetës u tregua në vendosmërinë për zgjedhjen e Këshillave Nacionalclirimtare, zgjerimin e luftës, rregjistrimin vullnetar në rrjeshtat partizane duke e bërë të domosdoshme rritjen e njësive më të mëdha ushtarake si bataljonet e brigadat partizane. Për këtë arësye populli e kujton dhe feston me krenari 75 vjetorin e formimit të Çetës së parë partizane të Dibrës.

** Sekretar i Komuitetit të LANÇ Bulqizë*

FESTOHET 75-VJETORI I ÇETËS PARTIZANE TË DIBRËS

Më 20 qershor 2017 në Zogje u festua 75 Vjetori i çetës së parë partizane të Dibrës. Kishin ardhur në këtë festë pjesëtarë të familjeve të dëshmorëve, veteranë e pasardhës të tyre, banorë të fshatrave të Grykës Vogël , Grykës Madhe, Bulqizës, Matit etj. Pranë lapidarit u vendosën kurora me lule në emër të Prefekturës Qarkut Dibrës nga Ardit Kaja dhe Dan Meta (vëllai i dëshmorit Isak Metalia), Komiteti i Veteranëve të Luftës Antifashiste Na-ÇL. Ferit Sinani e Xhevat Jella.

Të pranishmit i përshëndetën Xhevat Jella – sekretar i Kom.Veteranëve të NANÇl të Bulqizës e prefekti Ardit Kaja. Ata folën për luftën heroike të Grykës Vogël e popullit të Dibrës kundër pushtuesve turq, serbë, austro-hungarezë e italo-gjermanë. Theksuan mbështetjen popullore që gëzonte Çeta e Dibrës e komandanti i saj Haxhi Lleshi gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, si dhe aksionet ushtarake të çetës te Gurët e Skënderbeut, në minierën e Kromit, Zerqan, për prerjen e linjave telefonike, në Rrugën Dibër - Strugë etj.

Nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Man Jella", nën kujdesin e Jeton Likës (Drejtor) dhe mësueses Fatmira Xhafa dhanë një koncert të bukur festiv, ku spikatën këngët partizane, patriotike, për dëshmorët etj, që u shoqëruan me duartrokitje.

Në fund u shtrua një koktel, me kontributin financiar të Lefter Allës (me origjinë nga Topojani), familja, bashkë me fshatin baza të Luftës Antifashiste Nac-çlirimtare. Ai u falënderua nga Komiteti i Veteranëve për kontributin që dha për në meremetimin e Lapidarit të Çetës së partizane në Zogje..

Me këtë rast u organizuan vizita në familje të dëshmorëve, si në familjen e Qerim Menës (vëllai i dëshmorit Elez Mena) dhe në familjen e Kadri Kajës, i afërt i dëshmorit Man Jella, që i dhanë gjallëri të veçantë festës së 75 Vjetorit të Çetës së Dibrës.

Kjo veprimtari e mirëoganizuar nga Komiteti i Veteranëve të Luftës Antifashiste Naçl, la mbresa e kujtime që do të ruhen për një kohë të gjatë nga të gjithë pjesëmarrësit. Prandaj ata u larguan me dëshirën që çdo vit të festohet kjo ngjarje, si pjesë e traditave tona patriotike.

Mehmet Koxha

Rruga e Arbërit nr. 134

fragment



Baba Faja me baballarë të Këshillit Botëror Betkashian pak ditë para se të vritej.

PESHA E MARSIT TË VRARË

Nga **LUTFI HANKU**

- "E vranë, mami?"
- Jo, shpirt... Ti ke mua. " *

Rëndon nëpër vite pesha e hidhur e marsit të vrarë. Një varg i gjatë njerëzish lëviz në rrugën e Elbasanit. Të heshtur, si kortezh. Mes tyre - Xixa . Mban për dore voglushin. Ai erdhi në këtë botë si dhuratë e shenjtë dashurie.

Në qafë te kodrës së Saukut kthejnë majtas për në selinë e shpirtrave, ku zbardhon qyteti i mermertë në heshtje të dhimbshme. Aty prehen të rënët, dëshmia e Atdheut. Gjaku dhe nderi i kombit. Në krye simboli i lirisë:përmendorja" Nëna Shqipëri". Vështron krenare bijtë e vet.

- Ja, këtu, - e drejtoi Xixa fëmijën.

- Babi im? - foli me ngashërim njomëzaku dhe vuri lulet e oborrit të shtëpisë pranë emrit të shkruar me ngjyrë ari në mermerin e bardhë.

Kishte rilindur Ai: Baba Faja! Emrin e përjetësisë, simbol mishërimi "Mustafa", e pagëzoi nëna Xixë. "Tuçi" e thirri ajo. "Tuçi"! - e thirrëm edhe ne me dashuri emrin përkëdhelës. Dy dashuri. Dy jetë në një emër. Të plazmuar.

- Të qofsha falë, o Zot! Nuk ma bëre shpirtin varr!- foli e përvajshme Xixa duke e parë të birin që po rregullonte lulet mbi mermer.

- E vranë, mami?

- "Jo, shpirt... Ti ke mua." - u përgjigj ajo, duke fshehur sytë e përlotur. Lëmshi i hidhur brenda fëmijës u shkri dhe u derdh me pika lotësh mbi mermer. Si nuk e shkrinë pllakën e gurtë?

Ngacmohej malli dhe instikti i fëmijës. Vetëm një herë ta shikonte, t'i dëgjonte zërin e magjishëm, të shijonte përkëdheljet e dorës, puthjet xinxiste të mjekrës, prehërin e ngrohtë, t'i merrte bekimin dhe "shuplakën" e ëmbël të Babait. Ah, sa ëndërr e lodhshme!

Ai e shuante paksa mallin me fotografitë dhe në shkronjat e emrit të babit në truallin e oborrit më një rriskë guri. E shkruante në portë e në murin e shtëpisë.

Bëhej nervoz fëmija. Xixa dhe miqtë ia dinin hallin e lëngatës së fshehtë. Ndaj ata nuk e linin në vetminë e plagës. Dëgjonte mijra episode të urta, hyjnore, episode të luftës, të ëmbla, të hidhura... Atëhere" zgjohej" shpirti i Baba Fajes. Zbriste nga universi i shpirtrave të botës mistike. Pesha e rëndë lehtësohet në shpirtin e heshtur të Tuçit. Kaltërsia e syve e humbet paksa urrejtjen e fshehur, diku në thelb të vetësisë. Por shija e hidhur e marsit të vrarë mbetet si plagë dhimbjeje e pambyllur, që i zgjon vetëdijen.

* * *

Hëna uli qerpikët. Flladi ndezi freskinë mëngjezore. Kaptina përzuri muzgun e hirtë. Sheshi Belik zbuloi gjelbërimin me lule delje dhe vjollca aromatike. Reja mbi Bardhetë u ça. Dielli, mbret i universit, fokusoi mbi shesh rrezet më të ëmbla e të këndshme, si ta dinte se aty pushonte një përmasë arti mbuluar me flamurin kombëtar. Pas pak Martaneshi zbriti monopateve nën ligjërimën e bilbilave, si në kuvendet e hershme.

Dy të rinj shpërveshën me kujdes flamurin kuq e zi. Burri me taxhë e mjekër në bronx u zbulua.

- Baba Faja!- dëgjoi turma zërin e njohur të Sali Fejzës. I mahnitur e mbërtheu bustin me krahët e gjatë. Jehonën e zërit të fortë epik të emrit të heroit e kthyen malet si të gjemonin.

Aty e solli historia, me taxhë e mjekër.

- Erdhi Baba Faja, heeeej! Ngritën zërin , sa u mori fyti Rahman Lena me Beshir Balën .

Rahmani e shprazi tri herë revolen. Pas tij Isuf Kënga dhe Cen Biçaku. Jehuan malet e grykat, sa zbriti në shesh Tuçi. Pas e ndoqën Fejzë Xhani me Lutfi Alinë. Ata hodhën lule nga oborri i shtëpisë së Babait. Mbi to vezullonin lotët e pathara. Dhimbja e lavdia pushtuan sheshin. Buzët e nxehta të Tuçit puthën bronxin e ftohtë. "Babi im!"- pëshpëriti. Zemra ngrohu zemrën. Loti u bë zjarr. Ai ndezi sheshin. Dëgjoi emrin e Babait dhe kokën e ngre lart.

- O Baba jonë! - foli Zenja. Ajo vuri dorën mbi bust duke gëlltitur gulshet e idhta.

Mblidhen lëngatat në shesh dhe dhëmbja bëhet sa Bardheta. Të reja e të rinj hodhën mbi bust lule. Tingujt e çiftelisë u derdhën si të vajtonin preludin e marsit të vrarë.

Drita e tij zgjoi shpirtrat krijues. Vargjeve të poetve rapsodi u dha gjuhën e tingujve. Tingujt u shpirtëzuan në zërin epik të artistëve popullorë.

"Ndizen brigje, ndizen maja,
gjëmon topi e mortaja,
thonë:trimi Baba Faja,
mbi armiq sulmon.
Ti gjëkundi nuk u ndale ,
as nder kreshta, as ndër male,
Shqipëris' zemrën ia fale,
Baba Faja Jonë"! [1)]

Ai mbi vdekjen. Rrjedh gjaku i tij, plazmohet te fëmijët e tij, në vargje, në këngë, përmendore. Në oda e kuvende burrash ai flet. Martaneshi, Çermenika, Zerqani, Mati, Katër Grykët e Dibrës këndojnë me shpirt:

"Hej bini trima, hasmit bini!
jep kushtrimin bir'i kavajës.
Përkrah trimit Babë Myslimit
Buçet zan'i Baba Fajes.
Hej gjëmon Dibra e Martaneshi,
Kur lufton Mustafa Xhani,
përkrah burrit Haxhi Lleshi
sulmon rreptë si luani. [2)]
Komandanti prin në ballë,
nëpër shkrepa, nëpër pllaja.
N'zemër rron përjetë i gjallë.
Trimi besnik Baba Faja"! [3)]

Koha ecën. Ai zgjohet. Rritet. Flet me intelektualët. Ata frymëzohen. Derdhin fjalë zemre për Heroin e tyre.

- "Jam Qerim Lila . A ban me m'i fut këto vargje në librin tënd?"- i drejtohet shkrimtarit.

- Pa merak – e mirëpriti ai.

"Nuk ia kam frikën zjarrit e rebeshit,
Çerdhe të liris' shtëpit e Martaneshit...
Kriste mitrolozi, gjëmonte mortaja,
Para partizan! - thërriste Baba Faja. "

Atë ditë Hajredin Demiri më dha vargjet e I Celës:

... "Në teqen bujare
ti na bashkove,
në rrugën e zotit
gjithnjë na drejtove...
Ti na bane thirrje:
do çlirue vatani!
Të gjithë pas teje:
Prina Baba Xhani! [4)]

Dhembje. Krenari. Burrat hedhin krahet në supet e njeri tjetrit. Si mal dhëmbja rëndon. Zgjohen kujtimet. Flasin. Malli ndez flakë dashurinë. Urrejtja lëviz. Mblidhet cifla- cifla dejeve të gjakut. Djeg vrasja e marsit për "Tribunin e lirisë Mustafa Xhani" [5)].

* * *

- Tuçi! - e përmendi një zë i gëzuar.

Rahman Hanku e pa. Bënte homazhe në varrezat e dëshmorve të Dibrës.

- Më thirrën të rënët, - u përgjegj dhe iu hodh në qafë Rahmanit.

- Në secilin dëshmor ndodhet babai yt - i tha Rahmani duke u puthur e përzierë lotët...

- Doktor me emër. Ka fituar grada shkencore – foli krenar Isa Kola.

- Sa i ngjet babait! – ia priti një veteran me dekorata në gjoks.

- Me forcën e shpirtit Babai shëronte njeriun, - tha veterani.

- I biri, me forcën e shkencës, - u përgjigj Rahmani.

...

Tuçin e deshi zoti dhe njeriu. Në arteriet e jetës së tij lëvrin gjaku i Baba Fajes. Edhe sot Faria e Kamber Shehut dëgjon atë zë mistik:

- "Xixa, kush ju tha se më kanë vrarë?

Eshtë e thinjur nga plaga e dhëmbjes së marsit të vrarë. Ajo tret sytë mbi Tuçin, Verën, Rezartin dhe Heljanën. Mediton... Lumturohet.

"I kam këtu, brenda meje" - i thotë vetes me zë pak.

* * *

Mengjeset vesojnë.

Shekulli njëzet u mplak me dhëmbje. Dëshmitë memece e mekatare përgjumen në turbullirën e shkronjave. Ato maisen në fjalët e rrahura si plagë dhëmbje. Politika vesh surratin me maska krimesh. Fabrikuan dhe grackën e hijeve të 18 marsit. E qëndisën me rrobën fetare. Denoncuan botërisht krimin në Institucionin e shenjtë. Faturuan gjakun. Gojët shoqëruan smogun zyrtar të gazetave duke e akuzuar kryegjyshin si vrasës"për të ruajtur ligjet e besimit bektashian"... . i lidhur me agjenturat e huaja". [6)] Apo tymnaja që gjoja jetën e tyre e mori revolja e Mestan Ujanikut i cili "ka organizuar komplotin kundër patriotëve Baba Faja e Baba Fejzo..."[7)]

Mestani, një ndër adhuruesit e Baba Fajes. Absurdi nuk u përcuall si pështyma. Vetëm mashtruesit e kulisave e besuan. M. Ujanikun e akuzuan"se kishte qenë bashkëpunëtor në vrasjen e Baba Fajes" dhe, pasi doli jo e vërtetë..., e varën në çengel [8)].

Guximi për të shkruar të vërtetën, burgosej. Formula e Pilatit u dogj, pasi hëngri shumë shpirtra guximtarë. Edhe pluhuri i harresës u shkund. Koha shumëzoi ngjyrat e politikës. Dhjetëvjecari i fundit i shekullit XX zjarreve pluraliste u fryni. U zgjuan dyshimet e krimit në gazeta, forume polike e rrethe shkencore:

"Baba Faja ishtë vrarë me urdhër, biles ai tregoi dhe njeriun që e kishte bërë. (Këtë

letërsi

ia kam shkruar me emër dhe Ramiz Alisë). Atëhere ai person tha se kam patur urdhër!"[9].

... _"Krisma dëgjova. Thanë se i vrau kryegjyshi. Nuk i besova... dhe më burgosën"- iu përgjegj Ibrahim Haznaj shkrimtarit.

- "Ju e keni deklaruar në gazetë:"Dede Abazi vrau veten"!

- "Nuk ma merr mendja. Jezitia i ka vrarë imamët në shtëpinë e Zotit dhe në Qerbela".

- "U burgosën që të heshtësh?

- "Eh hilet e kësaj bote. Të them një fjalë të urtë: gjarperinjtë edhe të cofët, nuk i tregojnë këmbët e veta", - tha duke psherëtirë Haznai i lodhur.

Media e shkruar rastis të veshë ndonjë informacion me trille vërbuese, sa të çoroditet njeriu. Dhunimi i të vërtetës me subjektivizma errëson dhe turbullon logjikën e ftohtë, por nuk mund ta varrosë. Një ditë drita e qiririt do ta ndriçojë errësirën. Agimet nuk thinjen. Baba Faja në 36 shkronjat do të zgjohet!Edhe si legjendë, por i vërtetë. Do të zgjohet sepse nga lisi madhështor i rrezuar me plumba, të gjithë nxjerrin shkarpa për zjarr...

Vrasja e vetëvrasja e marsit, në shtypin komunist të asaj kohe, janë komentuar si akte të kryegjyshit, por në deklarimet okulare, madje edhe të shkruara, thuhet se "Dede Abazi kishte marredhënie të mira me Baba Fajen dhe gjithmonë i sjellshëm me të".[10] Pra, "Baba Faja është vrarë thellësisht për arsye politike e jo fetare".[11]

Njeriu që kryen vrasje , humb ekujlibrin mendor duke përjetuar depresione të thella psikike e shpirterore. Kalon në allucinacion, shpërfytyrohet si qenje njerëzore. Në ato momente vret ose vetëvritet. Dede Abazi gëzonte qetësi temperamenti, qetësi psikike të shëndoshë. Dede Abazi u ul në poltronin e shenjte dhe të lartë hyjnore të kryegjyshatës. Ishte pikërisht dëshira dhe përkrahja e Baba Fajes që e uli në atë poltron, edhe pse Dedenë rregjimi i kohës e kishte klasifikuar"Bir reaksionari".[12]

Baba Faja persekutimin politik e quante amoralitet. Prandaj Dede nuk kishte pse të ushqehej me ndjenjën e hakmarrjes si hyjnor me filozofi mistike.

Ai nuk mund të ketë dalë jashtë vetësisë. "Më 16 mars 1947 Dede Abazi, Baba Fejza, Baba Faja, Baba Zeneli dhe Ibrahim Haznaj kishin ngrënë bashkë në shtëpinë e Baba Fajes!"[13]. Prandaj "vrasja nuk u bë për përplasje fetare"[14].

Krimi u realizua me gjakftohtësi djallëzore. Ai shfrytëzoi klimën e acartë të reformimit. Ndaj dhe fatura e vrasjeve mbeti nëpër labirinthet e thashethemeve, ndërsa krimi u fsheh nën vetullat e politikës. Kurthit i eleminimit politik të Baba Fajes nuk është kryer nga Abas Dedej"[15].

Personazhi okular ndez një tjetër dritë:"-Nuk besoj që ata t'i ketë vrarë kryegjyshi, pasi nuk kishte asnjë arsye... Ata i dhanë postin e kryegjyshit". [16]

Lexohet qartë skaneri i logjikës për marsin e vrarë...

"Bektashizmi, do të njohë ... mekje të frikshme të dritës së vet, por shuarje asnjëherë. "[17]

* * *

Avokatia e përjetësisë, historia, e ka gjykuar krimin e plagës së marsit. Heronjtë nuk i humbasin vlerat kombëtare e shpirtërore. Ata i ruan kombi si legjendë. Si dëshmi jeshilon dhe Baba Faja legjendar në botën nacionaliste atdhetare dhe në përjetësinë mistike.


Shekujt do t'i përcjellin njeri- tjetrit plagët e dhëmbjes të marsit të vrarë në dritë hijet e kohës së njeriut, të legjendës së ndritur, Heroit të Popullit, burrit të shtetit me taxhë e mjekër, Babait simbol të lirisë"Qytetarit të nderit", të mirësisë hyjnore: Baba Faje Martaneshi!

- Jeton legjenda?
- Sa jeta e Kombit!

...

Dhemb plaga e marsit të vrarë... Dëgjojeni! Ajo rënkon në misteret e shpirtit. Zëri i tij brenda nesh rron... Në 36 shkronja Burri i dheut na zgjon.

F U N D



SHKËPUTUR NGA LIBRI "MARSI I VRAVË"

* Dialog nënë e bir tek varret "Deshmorët e Kombit" 5 maj 1958.

1,2,3) Këngë të luftës Na.Cl. vëllimi 5 f.662

4-Gazeta.Martaneshi.Qershor 2004.nr.8

5) Sali Berisha në përkujtimin e Ballëm Sulltanit në Martanesh më 26 qershor 2006.

6) Gazeta Bashkimi. Mars 1947

7) E. Hoxha –vepra v.4 f 281.

8) T. Lubonja –Nën peshën e dhunës f.21 botim 1993

9) Alternativa SD. Maj 1992.

10) I Haznaj.Gazeta 55 19 mars 2008

11) A. Kotani – Libri "Mustafa Xhani".

12) S.Ahmetaj. Bektashizmi nën smogun e një libri.f.111

13,16)I .Haznaj. Gazeta 55. 19 mars 2005

14,15,) A. Kotani – Monografi "Mustafa Xhani", + "Tirana Observer" 18.04.2006

17) E cituar nga S. Ahmataj: "Bektashizmi nën smogun e një libri", f. 37).

Tregim nga Alban Tufa

Dasma

Në ditë kur dielli ia bënte me sy fshatit Rreng, u kthye Thartin Shtaza nga Kanadaja. I gjithë fshati u gëzua madje sa nuk pëlcitën nga qejfi sepse kish ardh prej kurbeti i biri i Bevramit, e fill të nesërmen do martohej. Kërciti dodrra e surleja dhe krejt fshatin e përpiu një aheng i paparë e i padëgjuar në anët tona.

Para se të ikte andej, në anën tjetër të tokës, fshati, e mbante mend për një djalë që i kishte shokët e rrallë. Ishte punëtor, me sedër, e ma së shumti i besës. Biles, të gjitha cucat e fshatit e kishin si vëlla. Për tu habit qe fakti se dhe ai, i donte si motra. Shkurt: lum ajo që do ish nafaka e këtij djali.

Thartini kishte punuar me vite të tana edhe e kishte bà, si i thonë: paren grumbull. Kishte marrë letrat e tashmë do shkonte e vinte prej kurbeti sa herë ti tekej apo ta merrte malli për të ëmën. Para një viti, i ati, njëmendje me të shoqen e vet, prej nevoje, e aq më pak prej qejfit, i kishin gjet një nuse, nga ato të motit e të zakonit: e hijshme e punëtore, babë e nanë të ndershmëm dhe ata po ashtu shumë punëtorë. Kishin fol e ishin njoft pastajmi në skajp, e tashmë kishte ardh koha me u bà të dashtunit dhe hasmit e njëri-tjetrit (kanë thonë të parët se me hasmin ndan shtratin).

Larg vendit, para se të kthehej, Thartini kishte qenë një hamshor i vërtetë. Ai djali i ndrojtur e i ndershëm kishte marrë udhën e djallit: s'ishte më në këtë qenie burrërore. Nuk mbahej mend sa kurmet e vajzave kishte shqyer. Nuk i vëmë faj, larg atdheut, larg njerëzve që donte, ai do e shfrynte mallin diku, dhe kjo kishte qenë menyra me e natyrshme që i vinte një malësori në pikun e moshës. Biles vitin e fundit, kur fliste me të fejuarën e tij, e kapte një trazim në bark, diç e përzier mes mallit dhe dashurisë, e dëng pas mbarimit të bisedës shkonte e shkarkohej mbi kurmin e Kanadezes dhjetë vjet më të madhe. Kjo ishte si me thënë…grua për letra.

Buzët e Thartinit vetëm qeshën gjithë dasmën. Qeshën e nënqeshën. U zgërdhinë, u kënaqën. Kjo qe hera e dytë që e vishte këtë kostum të zi, dhe për dreq, sa herë lëshonte sytë në veten e vet, parasysh iu shfaqte e shoqja e vjetër, e huaja, ose më troç, ajo që i sistemoi jetën dhe që bëri njeri. Se nuk thonë kot: kush të jep letrat, është me të dhënë jetën. Herë e gjitha kjo i dukej dasëm, e herë-herë dukej një lojë e bukur që po e luante për së dyti. Ishte nata e parë qe do flinte me një shqiptare, me të drejta të plota si nga ana ligjore ashtu dhe fetare. Ndërgjegja e tij sapo fillonte të pastrohej. Ia kishte premtuar vetes këtë, madje edhe Zotit. Ai do ti përkushtohej kësaj vajze të bukur dhe të njomë ngjashëm përpikmërisht me pranëverën. Do i dedikonte jetën, madje do jepte atë nëse do të qe e nevojshme, sepse e kishte tashmë shpirt. I ishte betuar Zotit se do e donte me palcë trupit të tij, por kurrherë ajo s'do e merrte vesh për asnjërën nga kanadezet.

Pare e madhe u hodh në dasëm, saqë Thartini, sa si shlyu të gjitha shpenzimet dhe harxhet e dasmës me paret që hodhën dasmorët.

Mbrëmja u derdh përmbi fshat e pllakosi gjithë horizontin. Hëna përtace u shfaq përmes qiellit, e gjatë gjithë mbrëmjes nuk reshti duke e parë nusen e re mu në kokërr të syrit. Nusja, kur kërcente mundohej ta shmangte atë, e si pa të keq, i kthente shpinën vazhdimisht. Sa herë shikimi zgjaste mbi disa sekonda, nusja ulte kokën. Askush nuk e vu re, se ajo ish nuse, e koka ulur duhej mbajt. Hëna i trazonte diç në stomak nuses së re. Mosbesim? Tradhëti? Veç një Zot mundet me i zbërthy këto komplekset e nuseve, aq më shumë të nuseve të reja.

Edhe në dhomën e saj të gjumit, tek priste dhëndërrin Thartin, hëna nuk iu shqit. Përmes dritares lëshnote sytë e saj të hirtë e nuses veç i ngjethej mishi çdo çast e më fort.

Për nji grimëkohë e imagjinoi veten kapërthyer në shtrat me Thartin Shtazën, mbërthyer në krahët e tij gjithë qime e muskuj, duke u kafshuar në buzë e qafë me të, deri në çastin kur kujtoi kokërdhokët e hënës mbi jorganin e shtratit ku gjendej ulur gati-gati kacipupthi. U çua, afroi perden dhe sytë e hënës njëkohshëm ngelën jashtë dritares.

Prapa derës u dëgjuan zëra. Thartin Shtaza u fut me vrull në dhomën e gjumit duke marrë shqelma e shpulla nga kushërinj e farefis.

U ul mbi krevat. Sytë i shëndritnin. Hoqi kollaren ndërkohë nga prapa derës sërish zëra, por këtë herë në formë kënge:

Fryny era, u hap dera / hym m'zati te mushqerra /Or muzat, or kreje-shnejk / Veç kadal e mos u mbejt.

Kjo u këndua dy herë në një ritëm të çrregullt dhe nën zëra burrash e grashë, që thuajse i dinin fort mirë këto punë. E pastajmi vijuan:

Dy bilbila në një trinë / një n'gjunjë e tjetri n'shpinë.

Thartini u cua, fiku dritën dhe të dy nuse e dhëndërr bënë ato që sugjeronin këngët.

-Nënë, lëri ato petulla dhe hajde brenda- urdhëroi dhëndërri pa i thënë as mirëmëngjes të ëmës.

-Urdhno mor bir- u afrua ajo me një mashë që pikonte vaj të nxehtë.

-Thuaj babës që kjo nuse nuk bën për mua- foli ai. Bëhuni gati e çojeni andej nga erdh.

-Pse mor bir- pyeti ajo e shtangur.

-Nuk ishte vajzë nënë- sosi ai.

Peshkopi 2016

Rruga e Arbërit nr. 134

kulturë


Sulejman Borova, artisti që i dhuroi vlera këngës dibrane

Nga **ARSIM KOLARI**

Pavarësish se vitet ikin, duket se vlerat e këngëve të tij vazhdojnë rrugën duke anashkaluar kufijtë e "Shqipërisë londineze" dhe aq më tepër qytetin e Dibrës, ku ai u lind. Me këngëtarin gjeni, me karrierë mbi 50 vjeçare, i cili prej tre dekadash jeton në Amerikë, në ditët e qëndrimit në vendlindje, kemi bërë një bisedë të lirë, i cili kujton dhe vlerëson kohën e krijimeve të tij artistike. Sulejman Borova u lind në vitin 1938 në Dibër, dhe është njëri nga ata artistë të këngës epiko-lirike dibrane i cili këngën e trashëgoi nga xhaxhai Ramadani që ka kënduar me çifteli, i ati Muharemi, dy motrat, e më në fund për ta pasuar këtë rrugë edhe djali, Muharemi. Shkollën fillore e ka kryer në Dibër, në ish Sh.F. "Skënderbeu", ku këndonte kohë pas kohe nëpër programe për fëmijë. Pastaj, gjatë shkollës së mesme, në vitin 1954 mësuesi i fiskulturës Abedin Shehu (Dervishi), që ishte edhe përgjegjës për jetën kulturore-zbavitëse në shkollë dhe në qytet, organizoni një koncert ku ftoi të gjithë talentët e këngës dibrane, mes të cilëve edhe Sulejmanin. Në këtë eveniment u dalluan tre solistë: Emijane Baholli, Sulejman Borova dhe Niko Strashevski, e orkestrina përbëhej nga përcjellësi Sllave Mitrevski, në paterica Abdul Kërçishta, në prim Muhamed Çutra dhe klarinetist ishte Ramo Kurtishi. Pas këtij suksesi, i vjen ftesa nga Sh.K.A. "Liman Kaba", ku në vitin 1955 fillon punën zyrtarisht si këngëtar i kësaj shoqërie, por siç rrëfen artisti, fillimet nuk i ka pasur të lehta, e përkrahjen më të madhe në këtë periudhë e pat nga muzikanti Atli Qormemeti, e kështu filloi t'i përshtatet orkestrës e ambientit. Klarinetisti i shoqërisë, një mjeshtër i vërtetë, i vetëmësuar i këtij instrumenti, Eshtref Çutra, ishte i antarësuar që nga viti 1945, ardhjen e Sulejmanit si solist nuk e pa me sy pozitiv, deri kur ia njohu talentin, për t'u bërë njëri nga përkrahësit dhe miqtë më të afërt të tij. Koncertet e para i realizoi nëpër disa fshatra: Sollokiç, Banjisht, Gajre e Llazaropole, për t'ia hapur rrugën koncertit madhështor në stadiumin e lojërave me dorë në Gjakovë, ku në maj të viti 1968 Sh.K.A. "Liman Kaba" performoi para më shumë se 10 mijë njerëzve. "Skënderbeu te guri i vashës" e komponuar nga mjeshtri i madh dibran Musa Piperku, dhe "Elez Isufi, arusha e maleve" ishin dy këngët e kënduara nga Sulejmani që u duartrokitën aq shumë, sa që në fund të koncertit një grup prej 30 të rinjsh brohoritën "Dibra, Gjakova; Sulejman Borova!", kujtime të cilat kanë ngelur thellë në zemrën e artistit dhe i kujton me nostalgji të madhe.

Pas disa vitesh, erdhi ftesa për pjesëmarrje në Festivalin "Akordet e Kosovës", e në edicionin e parë u paraqit me këngën "Vasha dibrane" të punuar nga Nazim Kaba dhe e kënduar duet me artisten e madhe pejane Shahindere Bërlajolli-Stafaj, duke u nderuar me çmimin e tretë si komponimi më i mirë. Në gjashtë edicione të tjera të këtij festivali, Sulejman Borova mori pjesë me këngët e punuara nga mjeshtrit e komponimeve muzikore qytetare Musa Piperku e Nazim Kaba: "Mikpritja", "Dasma në Malësi", "Seç festonte Dibra, ditën e çlirimit" (në bashkëpunim me artisten dibrane Violeta Turkeshin), ku fituan vendin e parë nga publiku, etj.

Gjatë organizimit të 25 vjetorit të themelimit të Radio Televizionit të Shkupit, Sulejmani merr pjesë si i ftuar special bashkë me Nexhmije Pagarushën, dhe organizatori i këtij eventi Zhivko Firov, e prezanton me këngëtarët Aleksandër Sarievskin, nga Galeçniku i Dibrës dhe Jonçe Kristovskin nga Manastiri, i cili e fton atë në koncertin e organizuar në vitin 1971 në Manastir, ku fiton çmimin "Fyelli i artë", ndërkaq klarinetisti dibran Sabri Meçe, e fitoi çmimin "Klarineti i artë".



Ne foto: *Sulejman Borova dhe Arsim Kolari*

Viti 1972 solli sukseset e reja si për Shoqërinë "Liman Kaba", poashtu edhe ndritjen artistike të Sulejman Borovës, duke u lejuar që koncertet të mbaheshin në Shqipërinë "komuniste". Koncertet nisën nga Tirana, ku në Pallatin e Kongreseve u dogjën këmisha e njerëzit vërshuan në skenë teksa këndonte Sulejmani e Violeta, poashtu me luajtjen e valles dyshe dibrane nga koreografët e shekullit dibran: Abedin Kolari dhe Refik Papraniku. Emocionet qenë të mëdha, sa që lotë, këngë e përqafime u derdhën nën këtë godinë nga publiku që shihej për herë të parë ndoshta me njeriun e gjakut të tij. Pas Tiranës, radha i erdhi Durrësit me një koncert madhështor, pastaj në Laç, Kavajë, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Burrel e deri në Peshkopi. Me këtë rrugë që e përshkoi ky ansambël, e theu "murin e shekullit", veçanërisht kur kumbonte zëri i Sulejmanit me "Këngën e Bajram Currit", për të ngelur sot si një emblemë e kohës.

Shoqata "Përpjekja" e themeluar nga studentët shqiptarë të Beogradit, që funksiononte në Beograd, në mesin e viteve '70 e ftoi edhe ansamblin "Liman Kaba" të performonte nëpër ish Jugosllavinë, me çrast nami i shoqërisë u rrit edhe më gjerë. E themi kështu sepse, vërshuan vlerësimet pozitive nga kritikë të mëdhenj të Ballkanit, ishin mbi 10 koncerte vetëm në Zagreb, ndërsa në Festivalin Ndërkombëtar të Zagrebit, në sallën madhështore "Vatosllav Lisinski" shoqëria "Liman Kaba"u dallua nga më të mirat, sidomos me artisten Lejla Basha që kishte rol të trefishtë, ndaj mori "Medaljen e artë". Publiku u ngrit në këmbë me duartrokitje frenetike kur Sulejmani mbaroi së kënduari këngët e repertuarit të tij. Emocione të magjishme kishte edhe kur anëtari i ansamblit, Muhamed Vërzivolli interpretoi me tekst origjinal "Këngën e Dedë Gjo Lulit" në mes të Beogradit. Në mbarim të këtij turneu, Remzi Kërluku përcjell se emri i Shoqërisë "Liman Kaba" është shkruar me shkronja të arta në kujtesën e gjithë atyre që qenë prezent në performimet e kësaj Shoqërie gjatë këtij turneu.

Gjatë bisedës, artisti ynë kujton edhe Gllogovcin, ku koncerti është mbajtur nën tytat e automatëve dhe për reagim, edhe pse kishte ulëse, publiku e përcolli koncertin në këmbë. Sulejmani rrëfen: -"Këtu publiku triumfoi teksa u këndua kënga "Mahmut Dac Kalisi", e në këto momente policia sërbe nisi ta ndalojë koncertin, por me ndëryhrjen e kryetarit të sindikatës së zonës, koncerti vazhdoi. Kur mbaroi koncerti, kryetari i sindikatës më tha: -Sulejman, keni kujdes kur të ktheheni, sepse dyshohet se autobusin e kanë minuar!. Në autobus ishim rreth 50 anëtarë të ansamblit, e pa i treguar askujt, u nisëm dhe fatmirësisht nuk ndodhi ajo që parashihej".

Inçizimet e para i realizoi në Radio Prishtinën e atëherëshme me ndihmën e të madhit Lorenc Andoni, ku ndër të parat qenë këngët "Moj e mirë e re" (punuar nga Rexhep Mynishi, me violinë Isak Muçolli), "Kosova" (punuar nga shahiri Demir Krasniqi), duke bashkëpunuar njëkohësisht me produksionin "Lyra" dhe Estradën Profesionale të Prishtinës, ku bënin pjesë violinisti i madh Qazim Uruçi, këngëtaret e mirënjohura Safete Rugova e Nexhmije Pagarusha, me të cilët punoi disa këngë. Po përmendim bashkëpunimin me ikonën e muzikës shqiptare, Nexhmije Pagarushën me këngën "Ma ke gishitin për unazë", pas së cilës Nexhmija i dha vlerësime të mëdha Sulejmanit, si një artist me vlera kombëtare.

"Dasma në Malësi" apo "Shtatë palë lodra" lindi si ide e kompozitorit Musa Piperku, i cili këtë këngë e punoi enkas për Sulejmanin, që rezultoi të jetë njëra nga këngët më të pëlqyera që pasqyron në mënyrën më origjinale emocionet e një martese mes dy malësorësh. Sulejmani, veçanërisht kur zihet në gojë Kosova dhe populli kosovar, flet me një zë të flaktë që i buron nga shpirti, e thotë: "Vëllezërit tanë të Kosovës, kanë vuajtur e luftuar me jetën, sa s'ka ku shkon më. Me nderime u përkulem dhe gjithë ato koncerte që i realizuam bashkë, qenë –me Kosovën, për Kosovën-".

Në Amerikë fillimisht shkon si i ftuar për të kënduar, ku ndeshet me mikpritjen e mërgimtarëve. Atje këndonte nëpër ahengje familjare, e fundjavave në Kriveland, te një lokal i një pronari strugan, mblidhte mërgimtarët për t'i disponuar me muzikën dhe zërin e tij magjik. Jo vetëm këtu, por edhe në shumë vende të tjera, nga ku u vendos përfundimisht si banor i Amerikës.

Plot 247 koncerte e festivale të mbushura me suksese e mirënjohje nga më të ndryshmet, nëpër të gjithë Evropën, e kur e pyesim artistin tonë se si erdhën gjithë këto arritje, ai thotë se sistemi atëhershëm i përkrahu vlerat tona kombëtare, të cilat gjetën vend në talentin e kolegëve të tij dibranë, artistë si: Bukurie Shemsiu, Lumturie Kuriu, Muhamed Vërzivolli, Bukurie Mezelxhiu, Violeta Turkeshi, Bukurie Kasapi, Bashkim Paçuku, Haxhi Maqellara, Bukurie Uruçi, etj. Të cilët madhështonin çdo manifestim në Dibër me prezencën e tyre. Veçanërsisht pjesëmarrja e ansamblit nëpër dasmat dibrane, që përbën një art të vërtetë, që nga dasma e parë, martesa e Gazmend Ajdaragës, e deri në vitet më të fundit, u dha motiveve të dasmës dibrane një ripërtrirje, për të cilën artisti na thotë se ndoshta mund të përsëritet pas nja 100 vjetësh. Projekti që e risolli sërish në skenë, është kënga më e re duet me djalin, Muharem Borovën, që i kushtohet qytetit të Dibrës dhe titullohet "Dibra ime, Dibra nanë". Aktualisht jeton në Amerikë bashkë me familjen e djalit, por malli për vendlindjen dhe historinë e saj, e sjell gati çdo vit ku miqtë e vjetër e presin me padurim të kujtojnë rininë kur i dhanë Dibrës imazhin e qytetit të artit dhe kulturës.

Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit

<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

Ne nuk jemi gazetë e pavarur, ne jemi gazetë e lirë dhe pavarësia jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

HOMAZH



E mira Mirandë, ti u dorëzove...

Nga **MUSA HOXHA**

Ç uditshme që shirat në këtë stinë në Toronto nuk po kanë fund. Bien dhe nuk mbahen mend kur filluan. Edhe dje njësoj. Ndërsa pikat e avashta të shiut rrëshqisnin në xhamin e dritares, një gjendje jo e mirë më pushtoi. Ti pret të ndrisin rrezet e diellit por fillojnë pikat e shiut duke krijuar imazhe të ngjashme me fytyra të njohura...disa herë më duken si fytyra të ëmbla fëmijësh që lotojnë. Këto momente meditimi pranë fytyrave prej shiu m'i ndërpreu një telefonate që nuk e di pse më shkaktoi një trishtim. Fytyra ime dhe e gruas u bëëne njësh me fytyrat prej shiu në xham. Mikja jonë e lashtë dhe e mirë na kishte lënë. Natyrshëm në këtë moment të shfaqen kujtimet më të bukura dhe aq më shumë neve. Për ne ajo, Miranda dhe Mumtazi ishin mikpritësat e parë në jetën e re që nisem në Toronto. Çdo emigrant e di se çdo të thotë ditë e parë në një vend të panjohur. Por kur fati i mirë të sjell pranë njerëzve zemërbardhë e bujarë si ato, ndjehesh i qetë , i respektuar dhe pse jo edhe i fortë. Edhe ato, pak kohë para nesh, kishin shkelur në Toronto. Ishim me të njëjtat halle. Bisedonim pa fund, por gjithnjë humori shoqëronte bisedat tona duke u harruar deri në mesnatë. Miranda ishte e pastër e sinqertë dhe ishte ajo që na mbante gjallë shpresat për një jetë më të mirë. Ajo e donte jetën dhe si e tillë ajo i dha jetës jetë. Pikërisht në Toronto lindi djalin e saj të dytë, e shtoi familjen, shtoi gëzimin. Miranda ishte e thjeshtë edhe pse në vendin që lamë pati punuar në pozicione drejtuese të sektorit të ekonomisë. Disa herë me shaka thoshte. Sa isha e vogël me thoshin goca e mësuese Ramies (një ndër mësueset më të nderuara në rreth Ramie Rama (Disha), kur u martova me thoshin gruaja e Mumtazit (një ndër financierët më të mirë ish drejtor Banke). Dhe vazhdonte po me shaka... edhe unë kam qenë shefe ha ha. Me çiltërsinë që e karakterizonte na jepte edhe humorin e saj.

Jeta që ajo e vlerësonte aq shumë nuk iu përgjigj me të njëjtën dashuri. Atë që ndjemë sot pothuajse njësoj e ndjemë vite më parë kur ajo u diagnostikua me sëmundjen e pashërueshme. Filloi një luftë mes jetës dhe armikut të saj. Lufta formon karaktere. Jeta në luftë nxjerr në pah vlerat e karaktereve. Këtu mikja jone e mire triumfoi disa herë duke e sfiduar vdekjen deri në tallje. Po, po, e vërtetë.

Vetëm një vit më parë familja ime po përgatitej për një eveniment. Ndërsa po bënim listën për miqtë që do të ftonim ku natyrisht familja e Mirandës dhe Mumtazit radhiteshin të parët si mikpritësit tanë të parë në Toronto. Po na mundonte mendimi se si mund t'i ftonim kur Miranda ishte në luftë, për të fituar jetën. I ftuam dhe ato erdhën korrekt, dhe plot fisnikëri në paraqitje. Për në ishte jo vetëm gëzim por edhe surprizë që na emocionoi pa masë. Filloi evenimenti. Mes gëzimit dhe haresë dhe kërcimeve pa u ndalur të të ftuarve ngrihet edhe e mira Mirandë duke kërcyer dhe udhëhequr vallen. U emocionova pa masë. Ajo jo vetëm na nderoi, për të cilën e përqafova me plot zemër, por edhe na tregoi si sfidohet e keqja si fitohet kundër saj. Fitohet vetëm me dashuri për jetën. Për mua ajo atë ditë ishte në triumf. Për mua ajo atë ditë ishte heroina që injoroi vdekjen dhe besova që ajo fitoi.

Nga ajo ditë nuk e pamë më...vetëm që lajmet që merrnim nuk ishin të mira... Prandaj mendoj që bëme mirë. Nuk do ta qajmë edhe pse zemra na tradhton. Do ta kujtojmë gjithnjë për humorin e saj për nxitjen e shpresave. Do ta kujtojmë duke hequr vallen e të paktëve të kësaj bote të përkohshme.

Jam i sigurt që po të ishe sot midis nesh Mirandë e dashur do të qeshje dhe vetëm fjalën "u dorëzove" nuk do ta pranoje...

Se ti ishe me të vërtetë e fortë.

Se ti u tregove me të vërtetë e fortë deri në fund.

Të qoftë i lehtë dheu mikja jonë e mirë Miranda Daci Rama.

(Marrë nga FB i autorit, 22 qershor 2017)

DO TË ELIMINOHESHIN NË KAMPE SHFAROSËSE...

Nga **DEDË DOÇI**

Duke lexuar ngjarjet e qershorit 1948 tronditemi nga torturat dhe nga reprezaljet që ka bërë regjimi komunist në fillimet e vendosjes së pushtetit komunist në Shqipëri. Dihet se regjimi komunist ishte i egër, i pamëshirë dhe kishte në planet e tij shfarosjen e njerëzve gjoja "tradhtarë", "kundërshtarë" të tij. Si në gjithë Shqipërinë edhe në Dibër u bënë arrestime të mëdha dhe të shumta për të eliminuar të gjithë njerëzit që mendohej se ishin të rrezikshëm, dhe që origjina dhe mendimi i tyre ishte e kundërt me regjimin.

Nga zona e Lurës, u vranë trimat nga shtëpia e Bajraktarit të Lurës (Menës) dhe jo pak, por edhe ai që mbeti gjallë dhe u burgos, Mexhiti, u vu në listën e vdekjes që një ditë të afërt regjimi i asaj kohe do ta eliminonte si kundërshtar i regjimit. Po kështu dhe pas eliminimit të Preng Gjergj Rajtës, ishte vënë në listë për shfarosje dhe Martin Prengë Rajta nga Krej-Lura. Lista e vdekjes, që u mbush me emra të atyre që u ishin vrarë apo burgosur baballarët. Në këto lista ishte Baftjar Hajredin Buci nga Vlashaj Lurë. Sikur nuk mjaftoi vdekja në burg e Hajredin Bucit dhe Baftjar Buci vendoset në listat e vdekjes, që do të eliminoheshin në një moment të volitshëm për regjimin. Krahas fshatrave të Lurës edhe në Lurë të Vjetër vdekjet dhe reprezaljet nuk kanë pas fund. Ishte operacioni i qershorit që burgosi të nderuarin, të mençurin, trimin dhe njeriun shembull, Sulë Gjoçin, i cili vuajti dhe u izolua nga regjimi, por me gjithë vuajtjet ai shkëlqeu si drita e diellit dhe mbylli jetën në moshë të madhe duke lënë kujtime e mbresa te të gjithë. Mençuria e tij, trimëria dhe lufta që i bënte regjimi, lanë pasoja dhe për djalin e tij, Daliun i cili për moshën që pati gjatë regjimit komunist vuajti aq shumë sa kur e shikojmë sot mund të pyesni: Sa forcë qëndrueshmërie tregoi Daliu për të përballuar atë regjim shumë të egër. Edhe Daliu për të përballuar atë regjim shumë të egër. Edhe Daliu u vendos nga ish-regjimi që një ditë të bukur sipas komunistëve, do të arrestohej dhe do të eliminohej në Selishtë të Dibrës dhe së basku me 136 dibranë do të shfaroseshin si kundërshtarë të regjimit komunist, dhe në malet e Selishtës do të bëhej një varr masiv si i bënë në vende të tjera, por dhe Daliu ishte në listat e vdekjes. Në këtë grup lurasish siç ishin Mexhit Mena, Martin Rajta, Baftjar Buci, Dali Gjoçi që ishin regjistruar nga regjimi komunist si kundërshtarë, ishte dhe Lekë Doçi, i cili nuk u përkul para luftës klasore që u bëhej për hir të babës, Llesh Doçi që u arrestua në qershor 1946 dhe për disa ditë tortura në kampin famëkeq të Pollozhanit, duke treguar trimëri të lartë, vendosmëri të veçantë për luftën kundër komunizmit, Llesh Bibë Doçi edhe në momentin e fundit të jetës së tij la këtë amanet:

" Kush të rrojë torturat e komunizmit të mos i harrojë. Përfitojë nga momenti i kujtesës të kujtojë me respekt aktin e të gjithë të burgosurve politike në atë kamp, për ndihmën që i thanë Llesh Bibë Doçit në momentin e fundit të jetës dhe për respektin që i bënë, duke e nderuar me ngritjen në këmbë në momentin e marrjes së trupit nga salla që për këtë veprim ata u torturuan. Sikur të mos mjaftonte ekzekutimi i Llesh Bibë Doçit, regjimi komunist kishte vendos që dhe Lekën ta ekzekutonte një ditë bashkë me shokët e lartëpërmendur si "Kundërshtarë" të regjimit komunist.

Ishin përgatitur mënyra e arrestimit, mënyra e grumbullimit, mënyra e dërgimit në Selishtë dhe atje në prezencë të forcave të ndryshme t'i ekzekutonin dhe t'i futnin në një varr masiv si armiq. Pra të bën përshtypje se regjimi të bënte armik dhe të luftonte brez pas brezi (d.m.th.) nuk mjaftohej vetëm me babain por dhe me djalin.

Por lind pyetja: Kush ishin Mexhit Mena, Martin Rajta, Baftjar buci, Dali Gjoçi, lekë Doçi? Në përgjithësi ishin në kohën e partisë së punës, njerëz të rinj, punëtorë, të urtë, të ndershëm, djem të familjeve të mira, të veçanta për të cilat krenohej dhe Lura. Kudo që punonin lanë përshtypje të mira, por kurrë nuk u mposhtën, nuk u gjunjëzuar. Nga këta 4 nuk jetojnë, por vetëm Dali Gjoçi jeton dhe gëzon respektin e popullit të Lurës, njerëzve që e njohin shokët e miqve të tij që i ka të shumtë kudo.

Këta persona do të eliminoheshin në kampe shfarosje, një ishte në Selishtë të Dibrës që e kishte planifikuar regjimi komunist. I përmenda këta emra, për të kujtuar veprën e nderuar të baballarëve që u dënuan dhe u ekzekutuan në burgjet e komunizmit, pro përmenden dhe djemtë e tyre të cilët vetëm se erdhi demokracia se dhe këta do të burgoseshin dhe do të eliminoheshin bashkë me dibranë të tjerë që ishin jo më pak se 136 vetë.

I kujtojmë me respekt të veçantë qëndrimet e këtyre burave të vërtetë që s'i trembi burgu, as plumbi për lirinë dhe demokracinë. Këto lloj veprash do t'i kujtojmë gjithmonë me respekt dhe përulemi para qëndrimit të këtyre burrave.

Duke folur për torturat e ushtruar ndaj njerëzve "kundërshtarë", të regjimit në kohën e diktaturës, autori i nderuar Ramadan Sulë Ajazi në librin e tij.

Lura, kështjellë lavdie, shkruan:

Po torturave në qelitë e errëta,
Cili burrë u përball?
Llesh Bib Doçi, kapedani,
Komunizmi jetën ia mori.

Diktatura komuniste vriste e priste vazhdimisht familjet e mira, ajo i eliminonte brez pas brezi, babë e bir.

Ja çfarë shkruan Ramadan Ajazi për babain e tij Sulë Ajazi:

Mulliri i kafes ngjyrë ari
Pronari i tij, Sul Ajazi
Diktatura, armik e shpalli
Babë e bir në burg i futi.


Nga familjet më kundërshtarë ndaj regjimit të diktaturës komuniste në Lurë, në Dibër dhe në Shqipëri, është familja e nderuar e Menës në Fushë-Lurë. Diktatura i vrau familjarisht, qëndrimi i tyre burrëror do mbetet i paharruar në shekuj. Me të drejtë Ramadan Ajazi shkruan për njërin nga trimat e Meneve:

Trim me fletë
Ish Isa Mena
Djalë petrit
E kish lindur nana.

Nga shembujt e shumtë të eliminimit dhe të shfarosjes së kundërshtarëve të regjimit komunist del se Lura e pagoi shumë shtrenjtë, 34 viktima të pafajshme vetëm se ishin trima, familje të nderuar, të shkolluar dhe donin një regjim ndryshe e mendonin ndryshe të ardhmen, mendimet e të cilëve, dolën në ditët tona që ata kërkonin liri e demokraci.


I kujtojmë me respekt këta të nderuar që s'e trembnin për të drejtën dhe lirinë. Të mos i harrojmë asnjëherë kampet e shfarosjes dhe listat e vdekjes, por të mos marrim hak. Historia të shpalosi të vërtetat dhe ato që u flijuan të nderohen dhe të respektohen.

Libra



1500 lekë

...dhe mbi 100 tituj të tjerë të autorëve dibranë...



1500 lekë



500 lekë



1000 lekë



1000 lekë




700 lekë




3000 lekë

3 vëllime



700 lekë

Të gjithë këto tituj te libraria M&B në Tiranë i gjeni me 10% zbritje nga 1 korriku deri më 31 gusht 2017




1500 lekë




700 lekë



700 lekë



700 lekë



1000 lekë

Të gjitha këto botime i gjeni pranë rrjetit të librarive **Adrion** në Tiranë, **librarisë M&B** në Tiranë (pranë kryqëzimit te Selvia në Rrugën e Dibrës ose në librari **"Fleta XXI"** në Peshkopi.
Email: **mbbotime@gmail.com** Tel: **+355 69 20 68 603** (Viber) **+355 68 65 08 441** (Whats App):



www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**
Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**
Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Website është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.